



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Cërrik”

RAPORT

(Auditim Financiar dhe Përputhshmërie)

BASHKIA CËRRIK

Tiranë 2024

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4 - 9
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit	
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
II. HYRJA	9 - 14
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit	
2. Identifikimi i çështjes	
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4. Përgjegjësitë e audituesve	
5. Kriteret e vlerësimit	
6. Standardet e auditimit	
7. Metodologjia e auditimit	
8. Dokumentimi i auditimit	
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14 - 155
1. Informacion i përgjithshëm	14 - 14
2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	14 - 155
2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	15 - 30
2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit	30 - 50
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2023	50 - 70
2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	70 - 124
2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike	124 - 129
2.5 Mbi organizimin, funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit	129 - 132
2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtës së Territorit	132 - 135
2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	135 - 155
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME	155 - 170
V. ANEKSET	170 - 193

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

Bashkia e Cërrik është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 5 njësi administrative si vijon: Njësia Administrative Cërrik (qyteti), Njësitë Administrative Mollas, Gostimë, Shalës dhe Klos.

Misioni i Bashkisë Cërrik është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Cërrik si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. *Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.* 2. *Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Cërrik si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Cërrik. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.
- mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit, Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të

likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 47 gjetje dhe ka dhënë 69 rekomandime, nga e cila: masa organizative me 19 gjetje dhe 30 rekomandime, 5 gjetje-rekomandime shpërblim dëmi në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve në vlerën **70,398,346 lekë**, 1 (një) gjetje-rekomandim si efekt negativ në vlerën **770,116,227 lekë** në fushën e prokurimit të fondeve publike dhe 22 gjetje dhe 33 rekomandime në fushën e të ardhurave.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

a. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikatat e konstatuara lidhen me:

▪ ***Procedurat e zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit***

- Në **5 raste** janë konstatuar punime të pakryera me një **dëm ekonomik në vlerën 701,585 lekë** projektet e investimit me objekt:

- “Rikonstruksion i rrugës së Çapallarëve dhe Veshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, fshati Licaj”

- “Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar.”;

- “Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej.”;

- “Rikonstruksion rrugësh në Njësinë Administrative Gostime.”;

- “Rikonstruksion i rrugës së Delijve dhe Xhamisë së fshatit Selvijas.”.

Procedurat e prokurimit publik për punë publike, mallra dhe shërbime:

- Në **8 raste** u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.

- Në **7 raste** kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së të gjitha kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DT.

▪ ***Procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit***

- Në **8 praktika** personat përgjegjës që administrojnë procesin në *e-leje*, i kanë miratuar ato në mos përmbushje të dokumentacionit të rregullt sektorial për ndërtimin.

- Në **6 praktika** mungon mendimi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit që lidhet me miratimin e VNM-ve.

- Në **2 praktika** preventivat janë të pa plotë duke mos përfshirë zërat e prishjes së objekteve ekzistues.

- Në **1 praktikë** leja e ndërtimit nuk është shoqëruar me lejen e zhvillimit.

- Në **1 praktikë** mungojnë projektet e ngrohje – ftohjes.

- Në **1 praktikë** kemi shkelje të intensitetit duke e tejkalluar atë.

- Në **1 praktikë** konstatohet polica e sigurimit për projektuesit jashtë afatit të vlefshmërisë.

▪ ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

- Për mos pagesën e detyrimeve tatimore më datën 31.12.2023 janë debitorë abonentët familjar në vlerën 53,752,516 lekë.

- Për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe institucionet shtetërore në vlerën 13,871,855 lekë.

- Për mos pagimin e taksës së infrasktrukturës janë debitorë subjektet në vlerën 19,650,367 lekë.

- Për mos pagimin e detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënproduktëve të tyre janë debitorë subjektet në vlerën 2,000,000 lekë.
- Për mos pagimin e detyrimit për taksën e tokës bujqësore janë debitorë në vlerën 70,954,642 lekë.
- Për mos pagimin e detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë, 478 persona me vlerë 19,650,367 lekë.

- ***Për vlerësimin e raportimit financiar***

- Referuar analizës të gjendjes së llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” rezulton se, nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësjellës, që duhej të transferoheshin tek “Ujësjellës Kanalizime Cërrik” Sha, për 33 objekte në vlerën 974,489,659 lekë.
- Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 43,500,252 lekë; 211 “*Pyje, Plantacione*” në vlerën 11,169,913 lekë, 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 1,065,772,500 lekë; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 1,841,815,935 lekë; 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 72,046,780 lekë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2023 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Mungon regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite.

- ***Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve***

Nga auditimi rezultoi se, janë 4475 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Cërrik (Qendër), listat përfundimtare të të cilave janë të miratuara me VKM-ët përkatëse, ndërsa për 2469 prona të 4 Njësi Administrative si **Mollas, Gostimë, Shalës** janë në fazën e miratimit të listave paraprake dhe **Klos** në fazën fillestare. Nga këto prona janë hipotekuar 7 prona dhe janë në proces hipotekimi 38 prona të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë përditësimi i të dhënave të inventarit të këtyre pronave..

Nga Bashkia Cërrik nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura.

b. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Cërrik në lidhje me ***zbatimin e kontratave të punimeve të ndërtimit*** të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, nga sipërmarrësit e punimeve arkëtimin e vlerës prej **701,585 lekë** të faturuara dhe të paguara nga AK, të konstatuar dëm ekonomik nga mos kryerja e punimeve.

- Bashkia Cërrik ***në lidhje me të ardhurat*** të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për:

- Arkëtimin e detyrimeve nga abonentët familjar në vlerën 53,752,516 lekë.
- Arkëtimin e detyrimeve nga subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe institucionet shtetërore në vlerën 13,871,855 lekë.
- Arkëtimin e detyrimeve nga taksë e infrastrukturës në vlerën 19,650,367 lekë.
- Arkëtimin e detyrimeve për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën 2,000,000 lekë.
- Arkëtimin e detyrimeve për taksën e tokës bujqësore në vlerën 70,954,642 lekë.
- Arkëtimin e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, 478 persona me vlerë 19,650,367 lekë.

- Bashkia Cërrik në lidhje ***me hartimin e pasqyrave financiare*** të kryejë procedurat ligjore për transferimin tek Ujësjellës Kanalizime Elbasan të AAGJM që i përkasin gjendjes së llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” të ish-Ujësjellës Kanalizime Sha Cërrik, dhe më pas të kryhen veprimet sistemuese kontabël , duke i reflektuar ato në pasqyra financiare të mbylljes

së vitit 2024.

- Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

- Bashkia Cërrik në lidhje *me procedurat e prokurimeve publike* të marrë masat e nevojshme, që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, *në lidhje me lejet ndërtimit*, të marrë të gjitha masat për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin sektorial për projektet ndërtimore, në të kundërt të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk plotëson të gjitha kondicionet urbane.

- Të mos vijohet miratimi me leje ndërtimi i objekteve për të cilat është e nevojshme miratimi i VNM-ve, pa bashkëvepruar me Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

- Në lidhje me *inventarizimin, përditësimin dhe regjistrimin e asetëve në ASHK* Bashkia Cërrik nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim të pa hipotekuar të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan.

3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

a- Opinioni i auditimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduar të Bashkisë Cërrik për vitin ushtrimor 2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një *opinion të pa modifikuar me theksim të çështjes* për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Cërrik, duke arritur në përfundimin se, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “*Bazës për Opinionin e Pakualifikuar*”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të njësisë vendore më 31 dhjetor 2023, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes, janë adresuar disa çështje (jo thelbësore), të cilat paraqiten te paragrafi “*Theksimi i Çështjes*” dhe duhet të jenë në vëmendje të njësisë vendore për sistemimin e tyre.

Baza për opinion të pa modifikuar me theksim të çështjes:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik, apo edhe

çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej **6.6 milion** lekë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

“Theksimi i çështjes”

-Vlera e mbetur në llog. 202 “Studime dhe Kërkime” në fund të vitit 2023 në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto prej 9,542,342 lekë dhe me kosto historike në vlerën 43,082,009 lekë. Referuar analizës së gjendjes në vlerë bruto prej 43,082,009 lekë i përket 48 projekteve, për të cilat nuk ka detajim të saktë, nuk ka të dhëna kontabël të sakta për secilin si për vlerën e mbetur dhe nuk janë bashkëlidhur investimit përkatës.

- Gjendjes së llogarisë 213“Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezulton se, nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësjellës, që duhej të transferoheshin tek Ujësjellës Kanalizime Sha Cërrik, për 33 objekte në vlerën 974,489,659 lekë (përfshirë investime në ujësjellës e rrjetin shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji).

- Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 43,500,252 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 11,169,913 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksiione” në vlerën 1,065,772,500 lekë; 213“Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,841,815,935 lekë; 214“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 72,046,780 lekë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2023 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv

- Në Gjendjen e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 79,366,846 lekë, në të cilën nuk janë kryer sistemimet kontabël për investimet kapitale në ish-Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Sha Cërrik në vlerën 79,086,846 lekë dhe në Shoqërinë “Sport Klubit të Futbollit “T.” Sha në vlerën 100,000 lekë.

b. Opinionin mbi përputhshmërinë.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Cërrik, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Cërrik, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar për përputhshmërinë.

Baza për dhënien e opinionit të modifikuar:

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

- Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 8 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e

kritereve për kualifikim dhe në 7 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DT;

- Nga auditimi i zbatimit të kontratave në 5 objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën 701,585 lekë pa TVSh, si rezultat i diferencave në volume pune;
- Detyrimi për mos pagesën e detyrimeve tatimore më datën 31.12.2023 janë debitorë abonentët familjar në vlerën 53,752,516 lekë.
- Detyrimi për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe institucionet shtetërore në vlerën 16,921,095 lekë.
- Detyrimi për mos pagimin e taksës së infrastrukturës janë debitorë subjektet në vlerën 19,650,367 lekë.
- Detyrimi për mos pagimin e detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre janë debitorë subjektet në vlerën 2,000,000 lekë.
- Detyrimi për mos pagimin e detyrimit për taksën e tokës bujqësore janë debitorë në vlerën 70,954,642 lekë.
- Detyrimi për mos pagimin e detyrimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë, 478 persona me vlerë 19,650,367 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit të auditimit nr. 190/1 Prot., datë 20.02.2024 (i ndryshuar me nr. 190/2 prot., datë 28.03.2024), miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 15.02.2024, deri më 23.02.2024, në institucionin Bashkia Cërrik u krye auditimi “Financiar dhe i Përputhshmërisë”. Auditimi mbuloi periudhën prej datës 01.01.2023 deri me datën 31.12.2023.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. G. K. (Përgjegjës grupi)
2. I. Sh. anëtare
3. K. F. anëtare
4. Sh. H. anëtar

Objektivat dhe qëllimi i auditimit. Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Cërrik kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315);

- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

- **Qëllimi i auditimit.** Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Cërrik është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

Identifikimi i çështjes. Projekt Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Cërrik, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2023.
- Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.
- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
- Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Bashkinë Cërrik.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Strukturat drejtuese të Bashkisë Cërrik, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin e grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).

Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave

administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Çërrik, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- *Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:* Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm publik*”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “*Për miratimin e manualit të MFK*”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”.

- *Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:* Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; Ligji nr. 137/2020 “*Për buxhetin e vitit 2021*” dhe Ligji nr. 115/2021 “*Për buxhetin e vitit 2022*”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “*Për përgatitjen e buxhetit vendor*”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “*Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021*”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “*Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022*”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*”.

- *Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:* VKM nr. 248, date 10.4.1998 “*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre*” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr.

3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”; Ligji Nr. 107-2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar”; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Standardet e auditimit. ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

Metodologjia e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*¹. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

¹ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve, u përgatit Projektraporti i Auditimi i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr. 190/3 prot, datë 29.4.2024. Nga ana e Bashkisë Cërrrik me shkresën nr. 1138/1 prot, datë 20.5.2024 (*prot KLSH nr. 190/4, datë 23.5.2024*) është dërguar konfirmimi i marrjes së projektraportit dhe observacionet përkatëse. Në përfundim nga audituesit u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Bashkia Cërrrik kufizohet në veri me bashkitë Elbasan dhe Peqin, në jug-lindje me bashkinë Gramsh, në jug me bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me bashkinë Belsh. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Cërrrikut. Bashkia Cërrrik përbëhet nga 5 Njësi Administrative që janë, Cërrrik, Shalës, Mollas, Gostimë dhe Klos. Burimet e financimit në Bashkinë Cërrrik përbëhen nga, të ardhura nga burime të veta vendore; transferta e pakushtëzuar; taksa të ndara; transferta të kushtëzuara.

Sipas Censusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 27,445 banorë me densitet prej 144.71 banorë për km², ndërsa që sipas Regjistrit Civil numëron një popullsi prej 46,652 vetë, me dendësi prej 189.65 banorë për km². Bashkia Cërrrik ka një sipërfaqe prej 189.65 km².

Bashkia e Cërrrikut shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore në përgjithësi mes dy lumenjve, Shkumbin dhe Devoll dhe ka si qendër qytetin e Cërrrikut, një ish qytezë industriale, i shpallur si qytet më 1952 me ndërtimin e Uzinës së Përpunimit të Naftës dhe një Termocentrali, të cilat iu shtuan qendrës së shërbimeve për bujqësinë.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemet e drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Cërrik si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

- Bashkia Cërrik ka Kod të Etikës Nr. 50/1, datë 27.01.2023 Nr. 297/1 Prot , ku janë përfshirë rregulla të etikës, në të cilat përcaktohen parimet që duhet të respektojë çdo punonjës në punën e tij, si dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste.

- Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, janë hartuar rregulle, ku një rregullorë me nr.prot.217/1, datë 31.08.2022 “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Cërrik” dhe me nr. 217, datë 31.08.2022 “Rregullorë për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Cërrik” Për çdo vit është hartuar raporti i njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Për vitin 2023 raporti është nisur me shkresën nr.prot. 96, datë 12.01.2024 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të interesave (ILDKPKI). Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljeve të kodit etik. Nuk ka programe të trajnimit nga ana e Bashkisë Cërrik për integritetin dhe sjelljen, por në vitin 2023, punonjës të Bashkisë Cërrik kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e marrëdhënieve me publikun), duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë dhe përgjigja kthehet nga zyrat përkatëse. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 16 të Rregullores së Brendshme.

- Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkryetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë. Për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

- Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësive publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

- Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”

- Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Cërrik me Vendimin e Kryetarit nr.50 datë 27.01.2023.

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimet e menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e PBA-së, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të takimeve me grupet e interesit, si dhe për dëgjesa me publikun.

- Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike, por nuk ka urdhër të veçantë të Kryetarit së Bashkisë.

- Rregullorja e brendshme në përgjithësi i përgjigjet dhe përputhet strukturave organike, por nuk janë bërë ndryshimet për ndonjë funksion të ndryshuar apo të shtuar pranë Drejtorive.

- Është hartuar plan i veprimit për menaxhimin financiar për periudhën e auditimit 2023 për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilin përfshihen, aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative e Bashkisë Cërrik me nr. 499, datë 17.11.2022 përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë.

Organograma e Bashkisë Cërrik është e ndërtuar në mënyrë të tillë që, 2 Nënkryetarët Sekretari i Përgjithshëm kanë varësinë direkte nga Kryetari i Bashkisë dhe 5 drejtuesit e Drejtorive kryesore bashkë me sektorët që rregullohen me ligj të veçantë kanë varësinë direkte nga Sekretari i Përgjithshëm, 4 Administratorët e NJA varen direkt nga Kryetari, ku dhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë në linjë horizontale, ndërsa nga niveli më i ulët specialist, përgjegjës sektori e specialistët llogaridhënia është në linjë vertikale. Strukturat organike sipas viteve janë:

Për vitin 2023 me Vendim të Kryetarit nr. 499, datë 17.11.2022 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Cërrrik ” me 293 punonjës të miratuar dhe strukturë: Kabineti, 7 Drejtori, 25 Sektorë dhe NJA.

- Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel sekretar i përgjithshëm drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Po kështu edhe në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, kurse objektivat për secilin punonjës janë të pasqyruara në vlerësimet e punës.

- Bashkia Cërrrik ka likun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse në periudhe 6 mujore.

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit. Në bashkinë Cërrrik është miratuar Plani vjetor i pranimit në Shërbimin Civil me Vendim nr. 95, datë 27.12.2022. Në Bashkinë Cërrrik për vitin e auditimit nuk janë kryer rekrutime për pozicionet me status të Nëpunësit Civil.

Ka një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë ka një buxhet të planifikuar për trajnime, dhe është 0.3% të buxhetit të Bashkisë.

Bashkia Cërrrik nuk ka hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve, e cila ti dërgohej Shkollës Shqiptare të Administratës Publike apo në institucione të tjera jashtë bashkisë (Organizata, Agjenci sipas fushave të ndryshme) për trajnimin e stafit me qëllim ngritjen profesionale sipas nevojave. (mungojnë të dhënat për trajnime jashtë institucionit) por ka pasur një korrespondencë zyrtare me DAP kur ka pasur nevojë për trajnim të stafit.

- Për Bashkinë Cërrrik Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. Në datë 27.12.2022 është miratuar nga Këshilli Bashkiak “Buxheti për vitin 2023” me vendim nr. 98 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr.prot 1570/1, datë 10.01.2023 dhe Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025. NA për vitin 2023 ka nxjerrë Urdhrin e ngritjes së GMS dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve datë 10.01.2023.

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”

Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar “Funksionet/detyrat që delegohen” në zbatim të ligjit 44/2015 “Kodi i procedurave administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit

të dalë nga protokollin e institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi ka patur Urdhëresat për delegime detyrash.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësisë të qeverisjes vendore” Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2023 për hartimin e PBA 2023-2025 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me 19 anëtarë dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve për 6 programe buxhetore me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.17, datë 20.01.2020.

Në rregulloren e Brendshme në nenin 30 janë përcaktuar fushat e veprimit dhe detyrat e GMS, ku nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si:

- Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar
- Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

Në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike’, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se “GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike”. Për sa më sipër, për periudhën 2021 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Bashkia Cërrrik në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva ashtu dhe në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë të përcaktuara në Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Cërrrik. Këto objektiva bëhen të njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtuara Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjesa me publikun.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘*Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.*’ Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Cërrrik nuk ka hartuar një strategji plotë risku, duke e unifikuar atë me regjistrin e

riskut , pasi mungojnë objektivat dhe planet e veprimit janë të mangëta, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘*Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësisë të tij, nëpunësi autorizues mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës.*’ Ka Urdhër të Titullarit për përcaktimin e koordinatorit të riskut, nr. 01, datë 18.01.2023 dhe Urdhri 1/1, datë 18.01.2023 për përcaktimin e grupit e menaxhimit të riskut. Është hartuar regjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi i risqeve për drejtoritë përkatëse. janë identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Çërrik në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2; me Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 “Titullari i njësisë publike” pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të MR” dhe -“Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr. 8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.2, Kapitulli V, Aneksët.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Nëpunësi Zbatues/ Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA). Struktura e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit përbëhet nga 11 punonjës, 1 drejtor, 2 përgjegjës Sektori.
 - Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Detyrat dhe përgjegjësit e NjHDT dhe KVO janë parashikuar edhe Kapitullin V të Rregullores së Brendshme.
 - Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurma e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga Dega e Thesarit, e cila konfirmohet me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.
 - Në Rregulloren e Brendshme neni 57/1“ Sektori i burimeve njerëzore protokoll arkive dhe informimit” përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.
 - Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrove dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.
- Në lidhje me parimin 11:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”
- Bashkia Cërrik nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Ruajtja e të dhënave bëhet në mënyrë shkresore dhe elektronike.
- Faqja Zyrtare e bashkisë Cërrik në internet ka një sistem back-up.
- Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.
- Në lidhje me parimin 12:** “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”
- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuara në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, nuk ka plan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, pavarësisht se është bërë identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.
 - Në nenin 59 të rregullores së brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.
 - Për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi merret Drejtorja e Planifikimit të Territorit, Bujqësisë, Veterinarisë

dhe Administrimit të Pyjeve. Këto funksione janë përfshirë në detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre drejtorive në 60 të rregullores së Brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. Pasqyrat Financiare konfirmohen nga NA dhe NZ.

Nga AB nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare kryhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar përcaktohet se ‘*Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi*’. Për sa më sipër, rezulton se Titullari i Bashkisë Çërrik për vitin 2021 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”, me “Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësitë Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Drejtesit në Bashkinë Çërrik kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacionale, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe dërgohen në MFE. Ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Raportet për detyrimet e konstatuara, por të papaguara hartohen çdo muaj dhe paraqiten në degën e thesarit dhe çdo katër muaj në MFE. Stoku i detyrimeve të prapambetura për vitin 2023 është në vlerën 135.064.466 lekë. Bashkia Çërrik ka dhe detyrime, të cilat duhet të përmbushen nga Ministritë në vlerën 36.236.536 lekë. Detyrimet dhe të drejtat janë paraqitur në llog. e klasës 4 në aktiv dhe pasiv të bilancit të PF.

- Drejtorja e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Çërrik për mbajtjen e kontabilitetit operon me program Excel, pa e dubluar programin SIFQ. Regjistrimet apo evidentimi në SIFQ i transaksioneve financiare së bashku me dokumentet shoqërues kryhet nga Specialistet e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtorja e Financës dhe Buxhetit

dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program Excel që e menaxhon Drejtoria e Tatim-Taksave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet. Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankës. Për lëvizjet AAGJM mbahen dokumente financiarë dhe për çdo vit kryhet inventarizimi i tyre. Për aktivet e amortizuara dhe pa vlerë përdorimi kryhen procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm. Ka faqen e saj zyrtare.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet 15 “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të administratës së Bashkisë”, neni 9 “Marrëdhëniet me Këshillin bashkiak”, neni 11 “Marrëdhëniet me institucionet e tjera”, neni 13 “Marrëdhëniet me publikun”. Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit herë pas here, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar. Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe të menaxherëve me këshillin Bashkiak janë mbajtur procesverbale. Në faqen e Bashkisë Cërrik janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura, planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e Bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

- Ka raporte periodike dhe publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

-Nga Bashkia Cërrik kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Cërrik ka një faqe zyrtare Web në të cilën paraqiten informacione për publikun.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

- Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave,

- Për **vitin 2023** me shkresën datë 28.02.2023 janë dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Cërrik dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë në këto drejtime kryesore:

1. Vlerësimi i performancës së Aparatit të Bashkisë nëpërmjet monitorimit.
2. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përshkrimit në pyetëtorin e vetëvlerësimit. Veprimtaria e sektorit të Auditit të Brendshëm në investigimin e drejtorive të Aparatit të Bashkisë dhe njësive vartëse.
3. Rekomandimet të metat dhe mangësitë e gjetura.
4. Hartimi i plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe sidomos për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që përshkruhen në aktivitete e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në përshkrimin e komponentëve të MFK.

Pjesë e Deklaratës është edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës. Kjo realizohet nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

- Në Bashkinë Cërrik mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, por është hartuar plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të KBFP për vitin 2021, gjithashtu ka rekomandime edhe nga Auditi i brendshëm.

- Në Bashkinë Cërrik aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave të përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

- Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm, ku për vitin 2023 janë audituar nga Auditi i Brendshëm Drejtoria e Tatim-Taksave, IKMT, Drejtoria sociale dhe projekteve, Klubi Sportiv.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe

mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

- Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditimi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet planveprimit për zbatimin e rekomandimeve, por nuk ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, “Monitorimi” pika 1, me Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi strukturat drejtuese dhe pjesë e GMS z. T. Z. me detyrë nën/Kryetar i Bashkisë, z. F. D. me detyrë ish-Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë dhe në cilësinë e Koordinatorit të Rrishtit (për periudhën 01.01.2023-01.10.2023) dhe zj. A.B. me detyrë Drejtore e Kabinetit e në cilësinë e koordinatorës së MFK.

2. Mbi vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

Organizimi dhe funksionimi: Bashkia Cërrik ka ngritur NJAB, struktura e së cilës për vitin 2023 është pjesë e strukturës organike të Bashkisë të miratuar me VKB nr. 223, datë 17.11.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Cërrik për vitin 2022” dhe Urdhër të Titullarit nr. 499, datë 17.11.2022. Njësi e auditimit në organikë është përcaktuar me 2 punonjës dhe në fakt përbëhet nga 2 specialistë auditues, kur duhen të paktën 3 auditues në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3 e cila përcakton se: “Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Në strukturën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.”

Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të Administratës së Bashkisë Cërrik të miratuar me VKB nr. 297, date 27.01.2023 mbi bazën e të cilës funksionojnë të gjitha strukturat e Bashkisë.

Struktura e NJAB, niveli i arsimit, çertifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

N r	Periudha 2023	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme	
1	D. M.	Auditues	Ekonomi Plan	35	6	2019	PO	
2	A. H.	Auditues	Ekonomi Finance	12	2	Pa certifikuar	Jo	larguar
3	S. Sh.	Auditues	Juridik	3	1/2	Pa certifikuar	jo	vazhdon

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes të punonjësit të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se, një punonjës është certifikuar dhe ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnime për kualifikimin profesional, ndërsa punonjësja tjetër e rekrutuar në vitin 2021 zotëron eksperiencë të gjatë në profesion, ndërsa në fushën e auditimit nuk ka eksperiencë dhe nuk ka ndjekur trajnime në mospërputhje me në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenet 11, “Punësimi i Auditit të Brendshëm” neni 19 “Certifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm”.

Komiteti i Auditit të Brendshëm: Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në Bashkinë Çërrik nr. 386prot., datë 04.02.2023, e cila është miratuar nga titullari me urdhrin nr. 40, datë 04.02.2023.

Planet Strategjike dhe Vjetore:

Ne mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Për vitin 2023 me shkresën nr. 2871 prot., datë 10.10.2022 është miratuar plani strategjik për vitet 2023 - 2025 dhe me shkresën nr.prot. 8270 është miratuar plani vjetor i auditimeve për vitin 2023. Këto plane nuk janë dërguar zyrtarisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Konkluzion: Nga vlerësimi i kryer rezultoi se NJAB nuk i është përmbajtur plotësisht kërkesave metodologjike për hartimin strategjik dhe vjetor, të përcaktuara në Manualin e AB, pasi: në Planin Strategjik, tek rubrika “*Identifikimi i subjekteve*” nuk ka përcaktuar në numër dhe emërtesë subjektet për auditim. Tek kolona nr. 2 “*Identifikimi i fushave/sistemeve prioritare*” e pasqyrës nr.3 “*Plani i angazhimeve për vitin*”, janë vendosur strukturat për tu audituar në vend që, të paraqiten fushat që do të auditohen. Në planin strategjik dhe vjetor nuk është programuar auditimi mbi verifikimin zbatimit të rekomandimeve në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 42, datë 27.10.2020 “*Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditi i brendshëm në sektorin publik*”. NJAB nuk administron të plotësuar formatet nr.1 “*Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit*” dhe nr.2 “*Pyetësor për planin strategjik*” si pjesë e procesit të planifikimit fillestar dhe për të kuptuar e vlerësuar riskun. Në këto plane nuk janë përfshirë dhe programuar për auditim për çdo vit subjektet, ku sistemet e kontrollit të brendshëm janë vlerësuar me risk të lartë. NJAB në hartimin e këtyre planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuara, por nuk ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve.

NAB në Bashkinë Çërrik mbulon me auditim: Bashkia Çërrik (Aparati) me drejtoritë: Drejtoria e Projekteve dhe IMT, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Drejtoria e Financës dhe Pronave publike, Drejtoria e Juridike, Burimet Njerëzore e Informimit me Publikun, Drejtoria e Arkivave, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Njësia Administrative Çërrik, Njësia Administrative Gostimë, Njësia Administrative Mollas, Njësia Administrative Klos, Njësia Administrative Shalës, Klubi Sportiv “T.”.

NJAB në hartimin e këtyre planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuara, dhe ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve.

Realizimi i Planeve Vjetore:

- **Për vitin 2023** janë parashikuar gjithsej 7 auditime në Bashki, ku sipas llojit janë 4 të përputhshmërisë dhe 1 financiar, 1 performace dhe 1 i kombinuar. Sipas faktit janë realizuar 5 auditime, ose në masën 71% të planit të auditimeve. Plani i angazhimeve nuk ka patur ndryshime. Për mosrealizimin e 2 auditimeve të planifikuara nuk është bërë rishikimi i planit dhe konfirmimi nga titullari i tij në kundërshtim me MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë

25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” të ndryshuar me urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë (hyrë në fuqi në datën 1 shtator 2020), Kapitulli III “Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm” pika 3.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetor të auditimit të brendshëm “e cila përcakton: “Ndryshimet në planin vjetor të Auditimit të Brendshëm duhet të arsyetohen me shkrim nga drejtuesi i NjAB, ndryshime të cilat miratohen nga titullari i njësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Komitetit të Auditimit, (atje ku krijohet)”. Planifikimi dhe realizimi e auditimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financë	Kombinuar	Performancë	Tjera
4	Viti 2023	6	5	4	1			

Raportimi: Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkinë Cërrrik për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB. Me shkresën nr. 247/1 prot., datë 10.02.2023, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Cërrrik për vitin 2023. Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Nr	Subjektet e Audituar	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
		Gjit hsej planifikuar	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbi me Këshillimi	Angazhi me me kërkesë të titullarit	Angazhi me të përfunduar	Angazhime në proces
			A. të përpuths hmërisë	A. të performancë	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara				
1	Bashkia Cërrrik, Drejtoria e Projekteve	1	1						1		
2	Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit	1	1						1		
3	Nj.A Gostime Taksat vendore.	1	1		1				1		
4	Bashkia Cërrrik Klubi Sportiv “T.”	1					1		1		
5	Bashkia Cërrrik Arkiva.	11	1						1		
6	Spektori i Aplikimit të Projekteve dhe Zyra e Europës (për Fondet e BE)	1		1							
7	Spektori juridik dhe i prokurimeve (Prokurimet)	1									
	Shuma	7	4				1		5		

Konkluzion: Për periudhën objekt auditimi nga shqyrtimi i dokumentacionit të planifikimit dhe raportimit rezultoi se, në Planet Strategjike në përmbajtjen e tyre 2023 mungojnë objektivat strategjike, nuk është bërë përshkrimi i numrit të subjekteve që NJAB ka detyrimin për auditim si dhe identifikimin e fushave dhe sistemeve prioritare. Ndërsa në Planin vjetor mungonin rubrikat: zhvillimet aktuale të NjAB, prioritetet e auditimit për vitin, objektivat kryesore për vitin dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë. Realizimi i planit për vitin 2023 paraqitet në masën 71%, ku për mosrealizimin e auditimeve të planifikuara nuk është bërë rishikimi i planit dhe konfirmimi i tij nga titullari.

Gjetje-Rekomandimet

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i aktivitetit auditues është dhënia e rekomandimeve në përfundim të auditimeve, ku:

Për vitin 2023 nga auditimet janë evidentuar 26 gjetje, për të cilat janë dhënë 26 rekomandime, nga të cilat 26 janë rekomandime të karakterit organizativ, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				Sipas Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dem)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pa zbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
4	Viti 2023	26	14	12					
TOTALI		26	14	12					

Të dhënat e gjetjeve sipas fushave të auditimit dhe subjekteve të auditimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	SUBJEKTI AUDITUAR	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE NE NUMER										
		Sistemi i prokurimeve,	Sistemi i pagesave, shpërblime,	Fondet e sig. Shoq. sig.shendetesore, përkuqdesje	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e	Sistemet e privatizimit,	Sistemet e koncesioneve,	Sistemet e legalizimeve,urba nistikes, kthim	Sistemet e kreditimit,	Të tjera	Audituesi mbuluar me auditim
1	Bashkia Cërrik Drejtoria e Projekteve										2	
2	Inspektoriati i mbrojtjes territorit										5	“
3	Bashkia Cërrik Klubi Sportiv.			1							4	“
4	Nja Gostime taksat vendore.				11							“
5	Bashkia Arkiva										3	
	Shuma			1	11						14	

Ndjekja e zbatimi i rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të AB. NJAB u ka dërguar shkresa njësjive të audituara për informim mbi nivelin e zbatimit të tyre dhe në auditimin e radhës është çështja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore. Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2023	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT			
			Rekomandimi i dhënë	Rekomandimi i pranuar	Rekomandimi i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandimi me të përmirësimi	Rekomandimi me të përmirësimi	Rekomandimi me të përmirësimi	Rekomandimi me të përmirësimi
1.	Bashkia Cërrik Drejtoria e Projekteve.	2	2	2	2			2		
2.	Inspektoriati i Mbrojtjes se Territorit.	5	5	5	1	4		5		
3	Bashkia Cërrik Klubi Sportiv. “T.”	5	5	5	3	2		5		
4	Nja Gostime taksat vendore.	11	11	11	6	5		11		
5	Bashkia Cërrik Arkiva.	3	3	3	2	1		3		
	Shuma	26	26	26	14			26		

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se nga 26 masa të rekomanduara, janë pranuar 26 rekomandime, nga këto 14 rekomandime janë zbatuar, 12 rekomandime janë proces zbatimi, ndërsa rekomandime të pa zbatuara nuk ka.

Konkluzion: Në raportimin e progresit të rekomandimeve të adresuara në auditimet e kryera në vitin 2023 NJAB nëpërmjet raporteve vjetore të dërguara zyrtarisht në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm ka dhe në statusin e rekomandimeve, pa shpjeguar mënyrën se si administroi dhe përpunoi informacionin që mbështet përfundimin mbi nivelin e

pranimit të rekomandimeve nga subjektet e audituara në masën 100% dhe nivelit të zbatimit të tyre në masën 54% në vitin 2023, të dhëna këto që në dosjet e shqyrtuara dhe raportet e auditimeve nuk dalin të qarta këto të dhëna. Gjithashtu nga auditimi i dosjeve, rezultoi se zbatimi i rekomandimeve nuk ishte drejtim i programeve të auditimit dhe pjesë e trajtimit në raportet e auditimit. Mungonte plan veprimi i plotësuar dhe i nënshkruar nga struktura e audituar. Kështu që mungonin të dhënat nëse menaxhimi i strukturës së audituar i ka pranuar apo jo rekomandimet e lëna nga NJAB dhe statusi i tyre.

- Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm.

Nga auditimi i detajuar i dosjeve të auditimeve në vitin 2023 të kryera në subjektet apo strukturat e Bashkisë Cërrik: Drejtoria e Projekteve, Inspektorati i Mbrojtjes Territorit, Klubi Sportiv “T.”, taksat vendore në NJA Gostimë, Arkiva e Bashkisë Cërrik.

Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:

a- Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit ;

b- Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit dhe Raportit Final nga audituesit ;

c- Besueshmërinë ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standardet e auditimit, rezultoi se nuk janë respektuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, neni 12, shkronja “d”, neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”, Kapitulli II 2.4.1 “Auditimi i përputhshmërisë” dhe 2.4.2 “Auditimi financiar”; Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1 “planifikimi i një angazhimi auditimi”, pikës 4.1.11 dhe 4.1.12; kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”; Kapitulli VII “Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm” pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm”, kështu:

- Në të gjitha dosjet e auditimit mungon “Memo e planifikimit”, pra projektdrafti i programit të auditimit në fazën përgatitore të hartimit të programit të angazhimit, në të cilën duhet të përfshihet:

- Madhësia dhe kompleksiteti i njësisë, pra të kuptuarit dhe përshkrimi i mjedisit (universit) të auditimit, duke plotësuar edhe;

- Kompleksitetin dhe riskun e sistemit/fushës që auditohet, duke plotësuar edhe “Formatin e përgjithshëm të riskut”;

- Plotësimi i Formatit të vlerësimit të riskut për sistemin/fushën që auditohet, përlllogaritja e koeficientit të riskut për sistemin që auditohet. Vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, duke plotësuar edhe Formatet 4 e 5.

- Përcaktimi i objektivave në bazë të rezultateve të vlerësimit të riskut.

- Eksperienca dhe numri i audituesve;

- Përgjegjësitë individuale të çdo audituesi;

- Kohëzgjatja(ose afatet kohore);

- Buxheti dhe afati kohor për angazhimin e auditimit;

- Masat për sigurimin e cilësisë;

- Në dosje mungojnë testet dhe formati i rezultateve të vlerësimit të përgjithshëm të riskut si dhe pyetësorët për auditimin e sistemeve të plotësuara rast pas rasti.

- Mungojnë Formatin nr.4 “Vlerësimi i riskut të mjedisit të përgjithshëm të kontrollit” dhe Formatin nr. 5 “Vlerësimi i riskut për sistemin/fushën që do të auditohet” si dhe “Formatin i vlerësimit të përgjithshëm të riskut.”, formate të cilat standard të vlerësimit të riskut që plotësohen në fazën përgatitore për çdo angazhim auditimi.

- Programet e angazhimit nuk janë hartuar sipas “Formatit 8” të paraqitur në MAB. Në programin e auditimit nuk është i qartë lloji i auditimit (financiar apo përputhshmërie) nuk është përcaktuar ku bazohet auditimi (dispozitat ligjore), mungon objektivi specifik si vlerësimi i efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit, që është planifikuar të auditohet, mungon qëllimi i auditimit si dhe nuk janë përcaktuar metodat dhe teknikat që do të përdoren. Drejtimit e auditimit në program nuk janë të sakta dhe të qarta, por përshkruajnë disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorisë që po auditohet, si dhe nuk është nënshkruar nga anëtarët e grupit të auditimit. Në programin e auditimit evidentohet si pikë e veçantë “*Dokumentimi i rezultateve të auditimit*”, e cila nuk është pjesë e strukturës së programit sipas përcaktimeve në MAB.

- Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “Vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm”, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Audituesit e brendshëm nuk ka dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi funksionimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për çdo sistem të audituar, vlerësimin dhe analizën e riskut, përcaktimin e faktorëve kryesorë në rezultatet e vlerësimit të riskut, si dhe kriteret për vlerësimin e nivelit të riskut (i lartë, i mesëm dhe i ulët). Opinioni i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të jetë prezent si në përmbledhësen ekzekutive dhe në memorandumun e çdo raporti angazhimi.

- Nuk dokumentohet procesi i ndarjes së detyrave/sistemeve për tu vlerësuar, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës në kundërshtim me pikën 4.1.1.2 të MAB, dokument ky i nevojshëm për vlerësimin e punës për secilin auditues.

- Projekt raporti i përcjellë subjektit të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të Plan-Veprimit për zbatimin e rekomandimeve në kundërshtim me në kundërshtim me seksionin të 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësisë së audituar” të MAB.

- Në të gjitha dosjet nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e dërgimit nga NJAB dhe kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim).

- Nga shqyrtimi i raporteve evidentohet se, raportet për vitin 2023 nuk janë në përputhje me formatin e ri të raportimit, sipas Urdhrit të Ministrit të MFE nr. 4, datë 10.01.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB” miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016. Raportet nuk janë koncize dhe të sakta në përmbajtjen e tyre, ka rubrika dhe përshkrime jo korrekte dhe ndonjëherë nuk kanë lidhje me drejtimit e auditimit, ka përshkrime të gjata, të panevojshme, dhe të parëndësishme, që nuk mbështesin dhënien e ndonjë opinionit apo vlerësim përfundimtar. Përmbledhja ekzekutive nuk ka informacion të plotë për mangësitë e evidentuara, përmirësimet e adresuara, opinionin e përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontroleve të brendshme të vendosura dhe nivelin e riskut të subjektit në përfundim të auditimit. Metodatat e auditimit e evidentuara nuk i referohen Kap. V të MAB. Në gjetjet dhe rekomandimet përkatëse nuk janë reflektuar lidhjet organike gjetje-konkluzion dhe rekomandime.

- Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi nuk përcaktohet subjekti i audituar dhe subjektet e interesuara nga gjetja, në të shumtën e rasteve situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë, hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kuj viti i referohet, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar për problematikën e konstatuar, mungon vlerësimi i nivelit të riskut, konkluzioni dhe rekomandimi në kundërshtim me pikën 2.4.1 “Auditimi i përputhshmërisë” dhe 2.4.2 “Auditimi financiar”.

- Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirëpërcaktuara, nuk pasqyrojnë përmirësimin e duhur, pra nuk janë të qarta dhe të sakta, duke mos orientuar drejt strukturën e audituar në ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem. Për rekomandimet e adresuara nuk është përcaktuar afati i zbatimit të tyre si dhe nuk është përcaktuar niveli i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët);

- Në dosje mungon “Memo” drejtuar Titullarit të Bashkisë mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, për informimin e tij me rezultatet pas vlerësimit të sistemeve të audituar, ku misioni dhe roli i auditimit të brendshëm në kundërshtim me pikën 4.1.12 të MAB.

- Në të gjitha dosjet mungon hartimi, miratimi dhe ndjekja e plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga struktura audituese në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12/d.

- Nuk është kryer auditim me program të veçantë tematik apo nuk është përfshirë në si drejtim auditimi “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e NJAB të mëparshme apo nga auditi i jashtëm” dhe si rezultat nuk është dokumentuar verifikimi i kryer dhe raportimi në lidhje me rekomandimet dhe zbatimin e tyre, duke mos u dhënë asnjë opinion apo analizë mbi arsyet e mos realizimit të rekomandimeve të mëparshme si dhe mungon konkluzioni nga audituesit për masat që duhet të marrë menaxhimi i subjektit të audituar për realizimin e tyre.

- Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Sektori i Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 nuk janë realizuar në formë të thelluar sistemet objekt auditimi, ku shfaqen problematika me prioritet të lartë risku si: i planifikimit, zhvillimit dhe kontrollit të territorit, në sistemin e shërbimeve publike, në sistemin e të ardhurave etj. Mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve, në sistemin e pagesave, transaksioneve financiare dhe raportimit të pasqyrave financiare etj

- Mungon Programi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të NJAB i miratuar nga titullari, i cili ka të përcaktuar “Indikatorët e matjes së performancës”, gjë që ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë. Procesi i vetëvlerësimit periodik, sipas MAB përfshin:

- Mbikëqyrjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm
- Përfundimin e listës së kontroleve të përshkruara;
- Përpilimin e feedback-ut nga subjekti i audituar dhe palët e tjera të interesuara përmes intervistave dhe sondazheve;
- Përzgjedhjen e dokumenteve të punës për t’u rishikuar nga auditues të brendshëm që nuk kanë qenë përfshirë në atë angazhim auditimi;
- Rishikimin e projekt buxhetit, e afateve kohore dhe përfundimin e planit të auditimit;
- Analiza e performancës (për shembull; afati kohor dhe rekomandimet e dhëna dhe të pranuar);
- Referimi i praktikave aktuale të NjAB me praktikat më të mira të auditimit të brendshëm.

- Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, që kryhet nga vetë NjAB konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “Vetëvlerësimin periodik” nuk janë plotësuar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 7.1.1 në Kapitullin VII të MAB, të cilat nuk mbulojnë të gjitha fazat e auditimit, si dhe i mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”, duke bërë që procedura e vlerësimit të brendshëm për çdo program angazhimi të mos kryhej, pasi pyetësori i reagimit ndaj angazhimit nuk i dërgohej zyrtarisht subjekteve të audituara me dërgimin e Raportit Përfundimtar, por edhe nuk kthehej i plotësuar dhe nuk gjendej si pjesë e çdo dosjeje.

- Dosjet e auditimit janë të mangëta, pasi nuk janë të plotësuar sipas standardeve si dhe nuk janë të arkivuara në kundërshtim me ligjin nr. 9154/2003 datë 02.12.2003 “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Përsa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi: zj. D. M. dhe z. S. Sh. me detyrë auditues në Sektorin e Auditit të Brendshëm, Bashkia Cërrik.

2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

- Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2023.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mall e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Është hartuar dhe Miratuar Udhëzimi i brendshëm nr. 1, datë 19.03.2022 për përgatitjen e Programit Buxhetor afat mesëm 2023-2025. Ku janë përcaktuar: Ekipet e menaxhimit të programeve, vendimmarrjet dhe përgjegjësit.

Me Urdhrin nr. 11/3, datë 12.01.2022, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025.

Me vendimin nr. 31, datë 29.04.2022, janë miratuar tavanet përgatitore të PBA 2023-2025. Konfirmuar me aktin nr. 571/1, datë 11.05.2022 të Prefektit të Qarkut Elbasan.

Me shkresën nr. 2902, datë 12.10.2022 është dërguar në Ministrinë e Financave PBA 2023-2025.

Programi buxhetor afatmesëm 2023- 2025 është miratuar me VKB, me nr. 98, datë 27.12.2022, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Për vitin 2023, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 98, datë 27.12.2022, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1570/1, datë 10.01.2023. Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2023 kanë vlerën 462,540,000 lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 178,016,000 lekë, transferta specifike ka vlerën 110,173,000 lekë. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore planifikuar 165,351,000 lekë. Bashkia ka planifikuar në total shpenzimet në vlerën 409,440,700lekë. Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.

Gjatë hartimit të PBA, 2023-2025 janë përcaktuar “Përshkrimi i çdo programi”; “Politikat e programit”; “Qëllimi politikës së programit”; “Objektivat e politikës së programit”.

PBA	Urdhëra të GMS		Urdhëra të EMP		VKB			Nr.	shënime
	Nr.	Datë	Nr.	Datë	Objekti	Nr.	Datë		
2023-2025	11.3	12/1/2022	extra	10.01.23	Miratim kalendari	11.1	19.03.2022	17	
					Miratim tavaneve të shpenzimeve	31	29/4/2022	17	në afat
					Miratimi i tabelave të PBA	31	29/04/2022	17	në afat

Burimi: Drejtoria Ekonomike.

Miratimi i tavaneve të buxhetit afatmesëm 2023-2025 VKB nr. 31, datë 04.05.2022, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37. VKB me nr. 31, datë 29.04.2022, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Cërrik për vitet 2023-2025”, jo më vonë se 31 Janar, brenda afatit të kërkesave të

Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34. Për vitin 2023, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 98 datë 27.12.2022, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1590/1, datë 10.01.2023. Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2023 kanë vlerën 462,540,000 lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 178,016,000 lekë, transferta specifike ka vlerën 110,173,000 lekë. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore planifikuar 165,351,000 lekë.

Bashkia planifikoj në total të shpenzimet në vlerën 462,540,000 lekë.

Gjatë vitit 2023, janë marrë gjithashtu edhe disa VKB të tjera të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2022).

Me VKB nr. 10, datë 30.01.2023 është miratuar shtesë në buxhetin 2023. Kjo shtesë është bërë nga alokimi i fondeve të trashëguara nga viti 2022, duke shtuar planin e të ardhurave me vlerën 31,753,067.84 lekë. Po kështu u shtua dhe plani i shpenzimeve për vitin 2023 në shumën 31,753,067.84 lekë.

Në total buxheti i Bashkisë Cërrrik për vitin 2023 paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023 ne leke	
		Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara viti 2022/2023	11,091,834.24	
2	Plani i të ardhurave viti 2022	165,351,000.00	
3	Trashëguar nga transferta viti 2022	29,661,233.60	
4	Transferta e pakushtëzuar viti 2023	178,015,628.00	
5	Transferta e specifike viti 2023	110,173,296.00	
1	Paga (600)		171,075,969.00
2	Sigurime shoqërore (601)		27,709,628.00
3	Shpenzime operative (602)		115,372,327.00
4	Transferta (603+604+605+606+609)		13,726,747.00
5	Investime (230 +231) nga buxheti i Bashkisë		166,408,320.84
	Totali i buxhetit	494,292,991.84	494,292,991.84

Burimi: Drejtoria Ekonomike.

Buxheti i miratuar për vitin 2023 është 494.292.991,84 lekë, me burime financimi si më poshtë:

1. -Plani i të Ardhurave për vitin 2023, gjithsej në vlerën 494.292.992 lekë.

Nga të cilat:

- Transferta e pakushtëzuar 2023 178,015,628 lekë;
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale 110,173,296 lekë;
- Të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore 165,351,000 lekë;
- Të ardhura nga trashgimia me destinacion 40,753,069 lekë;

Në Buxhetin e Bashkisë së Cërrikut për vitin 2023, peshën specifike më të madhe e zënë të ardhurat nga fondet e deleguara nga pushteti qendror në formën e transfertave të pakushtëzuara të përgjithëshme dhe sektoriale në shumën prej 288,188,924 lekë ose 58% të totalit të burimeve. Pjesa tjetër prej 42% e zënë të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore dhe të trashëguarat e vitit 2022.

Gjatë vitit 2023 janë bërë edhe shtesa të tjera në buxhetin e vitit 2023 në vlerën 42,588 mijë lekë , si edhe ndryshime të miratuara me VKB. Këto ndryshime paraqiten si vijon:

Me VKB nr. 34, datë 30.05.2023 është marrë për miratimin e shtesës së buxhetit me fondet e transfertës së pakushtëzuar sektoriale 3,281,318 lekë, nga e cila për paga 2,886,800 lekë dhe sigurime shoqërore 394,518 lekë.

- Me VKB nr. 55, datë 31.07.2023 është marrë për shtesë të buxhetit në shumën 7,730,208 lekë. Nga i cili 6530,208 lekë për paga dhe 1,200,000 lekë për sigurimet shoqërore. Fondi i është akorduar Bashkisë Çërrik nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nr. 6975/1, datë 27.04.2023 “Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të VKB nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”.

- Me VKB nr. 71, datë 25.10.2023 për shtesë të buxhetit në shumën 10,000,000 lekë. Fondi i është akorduar bashkisë Çërrik me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22656/6, datë 20.12.2023 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 6, datë 14.12.2023”, Në zbatim të Aktit Normativ nr. 6 datë 14.12.2023 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar.

- Me VKB nr. 81. datë 27.12.2023 është marrë vendim për shtesë të buxhetit në shumën 21,576,767 lekë. Fondi i është akorduar bashkisë Çërrik me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22656/6, datë 20.12.2023 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr. 6 datë 14.12.2023”, Në zbatim të Aktit Normativ nr. 6 datë 14.12.2023 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 84/2022 “Për Buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar.

Shënim: Ndryshimet e tjera në buxhetin e Bashkisë Çërrik për vitin 2023 janë kryer brenda programeve buxhetore, midis artikujve, dhe nuk ka qenë nevoja për Vendim Këshilli Bashkiak, kjo në mbështetje të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c, ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore. Pra shtesat dhe paksimet janë bërë me urdhër të nëpunësit autorizues dhe janë miratuar në Degën e Thesarit Elbasan. Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2023, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Akt-Rakordim mbi Trashgimin me 31/12/2023								
Nr.	Emertimi I Shpenzimit	Gr	Kap	Art	N/Art	Plan	Fakt	Trashgimia
1	Paga	0	1	600-601	6002999	181997123.00	181302061.00	695062.00
2	Shpenzime Operative	0	1	602-609	6029999	68705259.59	61030426.00	7674833.59
3	Investime	0	1	230-231	2319999	109736068.00	102360652.00	7375416.00
	Shuma Kap.1					360438450.6	344693139	15745311.59
1	Paga	0	5	600-601	6002999	30500000.00	30500000.00	0
2	Shpenzime Operative	0	5	602-609	6029999	60250290.00	59280742.00	969548.00
3	Investime	0	5	230-231	2319999	27659535.60	24746182.00	2913353.60
	Shuma Kap.5					118409825.60	114526924	3882901.60
1	Paga	0	6	600-601	6002999	600000.00	14282.00	585718.00
2	Shpenzime Operative	0	6	602-609	6029999	558930.00	272900.00	286030.00
3	Investime	0	6	230-231	2319999	9135520.64	100000.00	9035520.64
	Shuma Kap.6					10294450.64	387182	9907268.64
	TOTALI					489142726.83	459607245.00	29535481.83

Burimi: Drejtoria Ekonomike.

-Buxheti i miratuar është dërguar në Degën e Thesarit brenda afatit ligjor. Më të detajuar burimet dhe shpenzimet e planifikuara paraqiten në tabelën si vijon:

	Emërtimi	Plani i vitit 2023 në leke	
		Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara viti 2022/2023	11,091,834.24	
2	Plani i të ardhurave viti 2023	117,612,442.00	
3	Trashëguar nga transfertat viti 2022	29,661,233.60	

	Emërtimi	Plani i vitit 2023 ne leke	
		Ardhurat	Shpenzimet
4	Transfertë e pakushtëzuar viti 2023	217,322,603.00	
5	Transfertë e specifikë viti 2023	113,454,614.00	
1	Paga (600)		181,102,977.00
2	Sigurime shoqërore (601)		31,994,146.00
3	Shpenzime operative (602)		117,263,480.00
4	Transferta (603+604+605+606+609)		12,251,000.00
5	Investime (230 +231) nga buxheti i Bashkisë		146,531,123.80
	Totali i buxhetit	489,142,726.84	489,142,726.80

Burimi: Drejtoria Ekonomike.

Konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën **489,143 mijë lekë** i barabartë me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga këshilli bashkiak që ka vlerën 489,143 mijë lekë. Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferta e pakushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën 489,143 mijë lekë, ndërsa realizimi 459,607 mijë lekë, ose në masën 93.96%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 181,103 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 180,607 mijë lekë, ose në masën 99.72%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 97.54%.

Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 117,264 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 114,581 mijë lekë, ose në masën 97.7%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 146,531 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 127,207 mijë lekë, ose në masën 86.8 %.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) nga fondet e deleguara është planifikuar në vlerën 81,265 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 81,265 mijë lekë, ose në masën 100 %.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar) të Bashkisë Çërrik ka planifikuar shpenzime në vlerën 129,254 mijë lekë, ndërsa realizimi 114,936 mijë lekë, ose në masën 88.92%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 146,531 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 127,207 mijë lekë, ose në masën 86.8 %.

Në formë tabele paraqitet planifikimi bazë i buxhetit për vitin 2023 dhe ndryshimet në tabelën vijuese:

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2022	Faza e I PBA 2023	Faza e II PBA 2023	Projekt Buxhet 2023 fillestar	Projekt Buxhet 2023 me ndryshime
600	Paga	152,982	164,580	164,580	171,076	171,076
601	Sigurime Shoqërore	26,061	29,180	29,180	27,710	27,710
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	110,424	115,370	115,370	115,373	115,373
603	Subvencione					
604	Transferta Korente të brendshme	2,123	1,277	1,277	1,277	1,277
606	Transf. për Buxh. Fam. & Individë	7,750	7,135	7,135	7,950	7,950
609	Fonde Rezerve	2,000	3,500	3,500	4,500	4,500
I	Shpenzime Korrente	301,340	321,042	321,042	327,886	327,886
230	Kapitale të Patrupëzuara	6,228	4865	4,865	8864	8,977
231	Kapitale të Trupëzuara	103,731	99,818	117,920	125,790	157,430
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	109,959	104,683	122,785	134,654	166,407
230	Kapitale të Patrupëzuara					
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0		0	
II	Shpenzime Kapitale	109,959	104,683	122,785	134,654	166,407
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti	2335	0		0	

Emërtimi	Buxheti Faktik 2022	Faza e I PBA 2023	Faza e II PBA 2023	Projekt Buxhet 2023 fillestar	Projekt Buxhet 2023 me ndryshime
I+II +III Totali I Shpenzimeve	413,634	425,725	443,827	462,540	494,293

Burimi: Drejtoria Ekonomike..

Gjatë vitit 2023 është bërë analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujore, raportet e monitorimit janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe janë dërguar në Ministrin e Financave brenda afateve ligjore.

Konkretisht për vitin 2023 është hartuar raporti i monitorimit dhe i performancës për vitin 2022 dhe është dërguar në Ministrin e Financave me shkresë nr. 725, datë 10.03.2023.

Është hartuar raporti i monitorimit për 4-mujorin e parë 2023 dhe me shkresë nr.1327, datë 27.05.2023 është dërguar Ministrisë së Financave.

Është hartuar raporti i monitorimit të 8-mujorit 2023 dhe me shkresë nr. 2107, datë 25.09.2023 është dërguar Ministrisë së Financave.

Ministria e Financave me shkresë nr. 5775 prot., datë 23.03.2023 ka dërguar vlerësimet dhe komentet rreth raportit të monitorimit 2022.

Është hartuar raporti i monitorimit të vitit 2023 dhe me shkresë nr. 619, datë 29.02.2024 është dërguar Ministrisë së Financave.

- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

- Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2023, paraqitet në tabelën e më poshtme:

Tab.krahesuar me PBA				
Nr.	Emërtimi	Plan përfundim 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakush e spec)	213,097,123.00	198,786,000.00	14,311,123.00
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	129,514,480.00	129,100,000.00	414,480.00
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	146,531,123.80	134,654,000.00	11,877,123.80
4	466 Investime (5% garanci punimesh)	21,998,257.00	0	21,998,257.00
A	Total I planit fillestar	511,140,983.80	462,540,000.00	48,600,983.80
B	Shtesat nga Pushteti Qendror	437,746,369.00		437,746,369.00
5	Shpenzime për pagat (600+601)	6,570,000.00	0	6,570,000.00
6	Shpenzime (602.604.609)	349,910,929.00	0	349,910,929.00
7	Grant i kushtëzuar (230-231)	81,265,440.00	0	81,265,440.00
XXX	Gjithsej	948,887,352.80	0	948,887,352.80

Burimi: Drejtoria Ekonomike.

Nga auditimi konstatohet se nga krahasimi i planit përfundimtar të vitit 2023 me atë të PBA-së 2023-2025, do shikojmë se ka rritje të planit përfundimtar në vlerën 437,746,369 ë lekë respektivisht: vlera në rritje 6,570,000 lekë i përket shpenzimeve për paga; vlera në rritje 349,910,929 lekë i përket shpenzimeve operative dhe trasfertat, ndërsa vlera në rritje 81,265,440 lekë i përket shpenzimeve për investime.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/ pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit në mbështetje të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Shënim: Ndryshimet e tjera në buxhetin e Bashkisë Cërrik për vitin 2023 janë kryer brenda programeve buxhetore, midis artikujve, dhe nuk ka qenë nevoja për Vendim Këshilli Bashkiak kjo në mbështetje të Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018”Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore. Pra shtesat dhe pakësimet janë bërë me urdhër të nëpunësit autorizues dhe janë miratuar në Degën e Thesarit Cërrik. Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2023, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga Granti Qeveritar			
						Nga transfera e pakushtëzuar	Nga transfera e kushtëzuar specifike	Nga transfera e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transfera e kushtëzuar për investimet
Paga600	187,662	187,048	99.67	28,814	100.00	77,675	74,118	6,441	
Sigurime shogërore 601	32,611	31,825	97.59	1,700	100.00	17,245	12,264	616	
ShP. Operat602+ F. Rezervë	123,777	115,095	92.99	58,903	98.37	29,607	26,072	513	
K. Q Emergj Civile 604	4,883	4,883	100.00	1	100.00			4,882	

Nd/Ekonom invalid 606	350,159	341,224	97.45	650	100.00	5,351		335,223	
Mjete ne ruajtje 466	21449	21,449	100.00	21,449	100.00				
Investime 230-231	227,796	208,472	91.52	24,846	89.46	102,361			81,265
Takse pulle 466	550	550	100.00	550					
Totali	948,887	910,546	95.96	136,913	89.28	232,239	112,454	347,675	81,265

Burimi: Drejtoria Ekonomike.

Konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën 948,887 mijë lekë i barabartë me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga Këshilli Bashkiak që ka vlerën 948,887 mijë lekë. Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën 489,143 mijë lekë, ndërsa realizimi 459,607 mijë lekë, ose në masën 93.96%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 187,662 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 187,048 mijë lekë, ose në masën 99.67%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 97.59%. Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 123,777 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 115,095 mijë lekë, ose në masën 92.99%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 227,796 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 208,472 mijë lekë, ose në masën 91.52 %.

Konkluzion: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Cërrik ka diferenca me vlerën e planifikuar.

Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 165,351 mijë lekë, ndërsa realizimi 114,914 mijë lekë, ose në masën 69.50%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara , i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është realizuar më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 227,796 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 208,472 mijë lekë, ose në masën 91.52 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Cërrik në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2023 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2023. Veprimet e mësipërme janë në përputhje me neni 46 - Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë

Konstatohet se për vitin 2023 vlerat e llogaritura për këtë qëllim janë kontigjencë 2,000,000 lekë, rezervë 4,500,000 lekë dhe emergjencë 5,000,000 lekë, mënyrën e llogaritjes të kësaj vlere, bazën ligjore për këtë; Fondi i emergjencës është llogaritur në vlerën 1.7% të buxhetit të vitit 2023 (në mbështetje të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”).

Vlera e përdorur në fakte nga Bashkia Cërrrik, Fondit Emergjencave dhe ai i kontigjencës janë përdorur në masën 47.82%

2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)

Në mënyrë të përmbledhur paraqitet fondet e trashëguara për vitin 2023.

Fondet e trashëguara në 31.12.2022 për përdorim në vitin 2023 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)	Fondet e trashëguara në 31.12.2023 për përdorim në vitin 2024 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)
40,753,067.84	38,220,263.71

Detyrimet e prapambetura viti 2023

Në 000 lekë

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapambetur	Detyrimi i prapambetur progresiv deri në datën e miratimit të buxhetit vjetor 2022 12/01/2023	Likujduar me buxhetin 2023	Shtesa e detyrimeve gjate 2023	Gjendja ne 31 Dhjetor 2023
4864200	D.P.per sherbime	1590280	1590280	1304824	1304824
4864300	D.P.per mirembajtje	417936	0	0	417936
4864400	D.P.per investime	116117576	24945393	40098070	131270253
4865600	D.P për mallra	3431220	1613224	253457	2071453
	Totali	121557012	28148897	41656351	135064466

Burimi: Drejtoria Ekonomike.

Detyrime nga Ministritë e Linjës (Ministria 20)

Kodi i detyrimit te prapamb.	Ministria e Linjës	Detyrimet deri 31/12/2023	Gjendja ne 31 Dhjetor 2023
4,864,400	26	D.P.per investime	36,236,536
Totali			171,301,002

Burimi: Drejtoria Ekonomike.

1-Detyrime e krijuara sipas vjetërsisë se tyre renditen si me poshtë:

Zhvillimi I Detyrimeve		Struktura detyrimeve	Detyrime	Ndryshimi
Nr.	Përshkrimi	31/12/2022	31/12/2023	
1	Detyrim 31/12/2015	15072622	14018369	-1054253
2	Detyrim 31/12/2016	300000	300000	0
3	Detyrim 31/12/2017	354166	354166	0
4	Detyrim 31/12/2018	1929736	1929736	0
5	Detyrim 31/12/2019	10921336	4720136	-6201200
6	Detyrim 31/12/2020	29795015	21843395	-7951620
7	Detyrim 31/12/2021	8196892	7605192	-591700
8	Detyrim 31/12/2022	54987245	42637125	-12350120
9	Detyrim 31/12/2023	0	41656347	41656347
	Detyrime Progresiv	121557012	135064466	13507454

Burimi: Drejtoria Ekonomike.

Vlera e raportuar nga Bashkia Cërrrik në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2023 është 135,064,466 lekë konfirmuar me shkresën nr. 437 datë 9.02.2024 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore, e cila kuadron me detyrimet e paraqitura në pasqyrat financiare. Raportet e degës së Thesarit Elbasan.

Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	459
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	135,064,466		29.39%
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqesore			
4864200	Det.Prap. Sherbime	1,304,824		
4864201	D.P.EneriElektrike			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	417,936		
4864400	Det.Prap. Investime	131,270,253		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	2,071,453		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronësime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	135,064,466	459,607,245	29.39%

Në planin e buxhetit vjetor 2023 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 49,788 mijë lekë, nga e cila është likuiduar vlera 28,149 mijë lekë, ose 56.5% e vlerës së planifikuar.

Po për efekte të shtimit të detyrimeve gjate vitit 2023 , kjo ulje e detyrimeve nga pagesat nuk reflektohet në gjendjen e detyrimeve në datën 31.12.2023 .

Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2023), është rritur (135,064-121,557), me 13,507 mijë lekë, ose në masën prej 11.1%.

Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2022, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Çërrik z. A. S., si dhe z. H. K., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës.

- Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR)

Njësitë vendore përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR). Ky fond përfitohet për financimin e projekteve për të cilat aplikojnë njësitë e qeverisjes vendore në fushat e infrastrukturës rrugore, arsimit, shëndetësisë etj.

Fondi total i pa alokuar, deri më 31.12.2023 për investimet, kap vlerën 36,236,536 lekë dhe i përket periudhës së investimeve të kontraktuara në vitin 2013.

Të detajuara, investimet e financuara nga FZHR nga viti 2015, të cilat nuk janë likuiduar deri më datën 31.12.2022 jepen në tabelat në vijim:

Tabela nr. 11: Investimet e financuara nga FZHR

Nr.	Data/ Afati Kontratës	Emri i kontratës	Situacion përfundimtar	Likuidim total	Total vlera e pa likuiduar
-----	-----------------------	------------------	------------------------	----------------	----------------------------

			Shuma e kontratës bazë		FZHR	Bashki	FZHR	Bashki
1	05/07/2013-5/12/2014	Pyllëzim me fidana shege ne ekonomine Pyjore Mollas	48,934,419	48,934,419	12,697,883	0	36,236,536	0
		Shuma investime	48,934,419	48,934,419	12,697,883	0	36,236,536	0

Vlera 36,236,536 lekë është detyrim nga FZHR, vlerë e përfshirë në Pasqyrat Financiare, megjithatë vazhdon që nga viti 2014 të mos likuidohet.

Në dosje gjenden:

- Urdhër prokurimi nr. 3, datë 16.05.2013, miratim procedure dhe shpallje fituesi në datën 04.07.2013, kontrata e lidhur në datën 05.07.2013, akt-kolaudimi për punimet e kryera, situacioni përfundimtar. Nga subjekti janë paraqitur si më poshtë:

-Fatura tatimore nr.21, datë 11.02.2014, Pyllëzim me fidan shege në ekonominë pyjore Mollas, me vlerë 22,239,427 lekë (me TVSh) e firmosur nga subjekti E. ShPK dhe Komuna Mollas

-Fatura tatimore nr.35, datë 30.12.2014, Pyllëzim me fidan shege në ekonominë pyjore Mollas, me vlerë 13,997,109 lekë (me TVSh) e firmosur nga subjekti E. ShPK dhe Komuna Mollas

- Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i tyre.

- *Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*

Për vitin 2023

Me Vendimin nr. 499, datë 17.11.2022, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Cërrik dhe listës emërore të punonjësve të Bashkisë Cërrik”, është miratuar numri i përgjithshëm i punonjësve për Bashkinë Cërrik. Në këtë vendim përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, në përbërje të së cilës janë 2 (dy) sektorë:

- *Sektori i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore*

Ky sektor ka në përbërje të tij 1 (një) përgjegjës/ 3 (tre) specialistë të taksave për biznesin dhe familjare për Njësitë Administrative Shalës, Mollas dhe Klos/ 5 (pesë) specialistë terreni për vjeljen e të ardhurave (biznes, familjare) në Njësitë Administrative Cërrik, Gostime, Mollas, Shalës / 2 (dy) specialist i taksave për familjarë në Njësitë Administrative Cërrik dhe Gostime / 2 (dy) specialist i taksave për biznesin në Njësitë Administrative Cërrik dhe Gostime.

-*sektori i të ardhurave nga pronat me qira, tregjeve, transportit dhe të tjera tatime*

Ky sektor ka në përbërje të tij 1 (një) përgjegjës/ 5 (pese) agentë terreni për pronat me qira, tregjeve, transportit e të tjera tatime për Njësitë Administrative Cërrik, Gostime, Mollas dhe Shalës 1 (një) kujdestar tregu Cërrik.

Konstatohet se: Nisur nga vetë ana funksionale e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, përbërja e strukturës së Bashkisë Cërrik ka probleme dhe nuk është në funksion të realizimit e të ardhurave konform ligjeve në fuqi, pasi evidentohen këto mungesa në strukturë:

-Drejtor i Drejtorisë të të Ardhurave Vendore, mungesë e cila sjell mosfunksionim organizativ të drejtorisë për mundësitë e mënyrat për rritjen e të ardhurave të planifikuar, për hartimin e programeve për realizimin e të ardhurave dhe objektivat e vetë institucionit, hartimin e politikave dhe informim të vazhdueshëm të publikut, minimizim të debitorëve (biznese e familjare) nëpërmjet masave shtrënguese etj.

- specialist për mbledhjen dhe monitorimin e borxhit, për zbatimin e masave shtrënguese ndaj bizneseve dhe familjarëve (debitorë), sipas ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar

Mos krijimi i Sektorit të Masave Shtrenguese si një nga sektorët më të rëndësishëm të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, Bashkia Cërrrik, sjell detyrime të paarkëtuara (debitorë) në vlerë 51,399,055 lekë, me konkretisht:

3322 debitorë familjare në vlerë 37,527,200 lekë.

103 debitorë subjekte fizik/juridik dhe institucione shtetërorë në vlerë 16,921,095 lekë.

Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin Autorizues si dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve.**

Për vitin 2023

Bashkia Cërrrik ka miratuar me VKB nr.27, datë 27.12.2022, "Nivelin e taksave e tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrrik për vitin 2023", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me nr. 1568/1, datë 09.01.2023.

Në tabelën nr. 2, ku është pasqyruar pesha specifike kundrejt planifikimit të të ardhurave që zënë drejtoritë përkatëse të Bashkisë Cërrrik, në % dhe në vlerë, shohim që peshën më të madhe e ka Drejtoria e të Ardhurave Vendore. Për vitin 2023 të ardhurat e planifikuara në vlerën 143,262 lekë janë realizuar në vlerë 126,298 lekë.

Tabela nr.2: Drejtoritë përgjegjëse dhe pesha e tyre specifike në planifikimin e të ardhurave.

Nr.	Strukturat përgjegjëse	Në %	Plani në 000/lekë
1	Agjentët Tatimore	16%	23,009
2	Drejtoria e të Ardhurave Vendore	68.6%	98,222
3	Drejtoria E Planifikimit Urban	7%	10,040
4	Drejtoria Bujqësisë Administrimit të Pyjeve	1,2%	1,700
5	Të ardhura nga MZSH	0%	350
16	Të tjera	7,2%	9,941
	TOTAL	100%	143,262

Burimi: Bashkia Cërrrik

Për vitin 2023, ka pasur mos realizim në vlerën 16,964 mijë lekë, ky mosrealizim vihet re kryesisht në taksat e popullatës: si taksa mbi tokën bujqësore, taksa e ndërtesës, taksa e truallit, taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, tarifa e menaxhimit të mbetjeve, tarifa e ndriçim-gjelbërimit.

Ky mosrealizim nga taksat e popullatës lidhet me këta faktorë:

- Emigrimi dhe migrimi i popullatës, gjë që sjell krahas mosrealizimit dhe pengesë për vazhdimin e masave shtrenguese sipas ligjit nr. 9920, ne bllokimin e llogarive bankare, sekuestro etj.

- Niveli i ulët ekonomik-financiar i familjeve të Bashkisë Cërrrik sjell mosarkëtim në kohë të këtyre taksave. Nga ana e specialistëve të taksave dhe specialistëve të kontrollit ne terren është kontaktuar me familjarët debitorë ekzistues në territorin e bashkisë si dhe është bërë dërgimi me postë i detyrimit ndaj taksave dhe tarifave vendore. Në përgjithësi komuniteti nuk është i ndërgjegjësuar për pagesën e detyrimit me vullnet të lirë të detyrimeve tatimore.

- Një faktor tepër i rëndësishëm janë problemet me pronësinë, ku ka mungesë të tapive të tokës dhe ndërtesave, ku pronësia është në pjesën më dërmuese nga kryefamiljarë madhorë që kanë ndërruar jetë. Për periudhën e audituar, evidencat e rakordimeve me thesarin janë nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Z. A. S.; Drejtori i Finances Z. H. K.; Përfaqësues të Degës së Thesarit Znj. S. H. dhe E. D..

Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt akordimeve me Degën e Thesarit Cërrrik, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2022-2023 janë paraqitur të detajuara në:

Tabela nr.3: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2022-2023.

Në 000/lekë

Nr.	Emertimi i të Ardhurave Tatimore	Viti 2022 Plan	Viti 2022 Fakt	Viti 2022 %	Viti 2023 Plan	Viti 2023 Fakt	Viti 2023 %
a	b	7	8	9	7	8	9
A	Të ardhura nga Taksa Lokale	95,610	60,101	63.00%	64,412	41,794	64.89%
I	Tatim I thjeshtuar mbi fitimin	915	313	34.00%	920	118	13%
II	Taksa mbi pasurinë e paluajtëshme	66,645	32,870	49.00%	50,900	36,634	72%
1	Taksa mbi Ndërtësat	20,500	17,324	85.00%	27,990	18,931	68%
1.1	Taksa mbi ndërtesën për familjarë				17,350	11,174	64%
1.2	Taksa mbi ndërtesën për biznesin				10,500	7,645	73%
1.3	Taksa mbi ndërtesën për institucionet				140	112	80%
2	Taksa mbi token bujqësore	14,000	10,465	75.00%	16,300	12,077	74%
3	Takse Trualli	32,145	5,081	16.00%	6,600	5,626	85%
3.1	Taksa mbi truallin mbi familjarë				255	195	76%
3.2	Taksa mbi truallin mbi biznesin				6,340	5,427	86%
3.3	Taksa mbi truallin mbi institucionet				5	4	80%
4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë				10		
III.	Taksa vendore për shërbim hotelier	10	26		25	25	100%
IV.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	9,000	4,428	49.00%	5,780	2,956	51%
V	Taksa e tabelës	500	223	45.00%	2,020	444	22%
VI	T.vend.mbi ardh.krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llotaritë vendore				3,000		
VII	Taks Reklame	650	100	15.00%			
VIII	Taksa e përkohshme 1 (Taksa e regjistrimit)	150					
IX	Taksa e përkohshme 2(Taksa e Pullës)	10	53	35.00%	67	30	45%
X	Taks e Përkohshme e Infrastrukturës Arsimore				1,700	1,587	93%
XI	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	17,740	22,088	125.00%	22089	25,065	113%
1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë pasuritë e paluajtshme						
2	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	12,500	12,943	104.00%	13500	13,357	99%
3	Taksa e rentës minerare	30	40	133.00%	40	41	103%
4	Taks mbi të ardhurat personale	5,200	9,097	175.00%	8533	11,660	137%
5	Të tjera taksa kombëtare	10	8	80.00%	16	7	44%
B	Të ardhura nga tarifat Vendore	36,687	32,743	86.00%	38,100	35,165	92%
I	Tarifa nga menaxhimi I mbetjeve	16,700	16,433	98.00%	22,408	16,568	74%
1	Tarifa e pastrimit për familjet				8,928	5,678	64%
2	Tarifa e pastrimit për institucionet				2,730	2,130	78%
3	Tarifa e pastrimit për biznesin				10,750	8,760	81%
II	Tarif për ndriçimin publik	2,500	1,595	64.00%	2,545	1,722	68%
1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet				1,432	868	61%
2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet				87	79	91%
3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi				1,026	775	76%
III.	Tarif për Gjelbërimin	1,750	1,436	82.00%	1,249	1,501	120%
1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet				625	480	77%
2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet				263	200	76%
3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset				361	821	227%
IV.	Tarifa për shërbimet Administrative të bashkisë	13,600	10,034	74.00%	9,998	13,886	139%
1	Tarifa shërbimi administrative	80	97	121.00%	100		
2	Tarifa për dhënie licencave lejeve Autorizimeve	1,500	1,040	69.00%	1,500	3,000	200%
3	Tarifa të kontrollit e zhvillimit territorit	4,800	400	8.00%	3,000		
4	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura						
	Tarifa e licencimit të të transportit	1,100	958	87.00%	395	1,154	292%
	Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe vendparkime publike	1,200	1,392	116.00%	473	1,333	282%
	Tarifa për dhënie licenze për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj						
	Tarifa për pyjet dhe kullotat						
	Tarif për shërbimet zjarfikës	300	145	48.00%	350	126	36%
	Tarifa për zënie e fasadave e hapësira publike	3,800	2,397	63.00%	3,850	2,168	56%

Nr.	Emertimi i të Ardhurave Tatimore	Viti 2022 Plan	Viti 2022 Fakt	Viti 2022 %	Viti 2023 Plan	Viti 2023 Fakt	Viti 2023 %
	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inertë në landfillë						
	Tarifa vendore Urbanistika	820	3,508	428.00%	300	6,045	2015%
	Tarife për shërbime të tjera administrative(me v.k.b)		97		30	60	200%
V	Tarifa të institucioneve sportive e kulturore	150	0		0	0	
1	Tarifa për Bileta sporti	150	0				
2	Tarifa të tjera Transporti urban						
3	Tarifa për kopshtet çerdhet						
VI	Tarifa të shërbimit të Ujitjes e Kullimit	1,600	1,954	122.00%	1700	1,488	88%
VII	Tarifa të përkohshme	387	1,291	334.00%	200	0	
C	Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera	10,423	9,596	92.00%	40,750	24,274	60%
1	Qira nga Ndërtesat	1,220	668	55.00%	1,670	634	38%
2	Qira toke bujqësore	8,324	6,009	72.00%	8,320	4,688	56%
3	Qira fondi pyjor kullosor					6,020	
4	Të tjera të ardhura nga pronësia	279	346	124.00%	350	300	86%
5	Të tjera gjoba dhe kamatëvonesa	600	2,573	429.00%	1,060	2,511	237%
6	Sekuestrime dhe zhdëmtime				960		0%
7	Të ardhura nga detyrime të pamblëdhura nga viti i kaluar						
8	Të ardhura të tjera				28,390	10,121	36%
xxx	Totali i të ardhurave të veta (A+B+C+D+E)	142,720	102,440	72.00%	143,262	126,298	88%

Burimi: Bashkia Cërrik

Referuar pasqyrës më sipër, konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta. Kjo duket kryesisht në taksat që mbliidhen nga agjentë tatimore si tatimi i thjeshtuar i fitimit, taksa e pullës. Kurse në taksat e planifikuara nga vetë strukturat e bashkisë janë taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, taksa e tabelës, tarifa për shërbimin zjarrfikës, tarifa për zënien e hapësirave publike, qira ndërtesë. Për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, si taksa mbi të ardhurat personale, tarifa e gjelbërimit për bizneset, tarifa për dhënien e lejeve dhe autorizimeve, tarifa e parkimit të mjeteve të licencuara etj. Kjo tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, pasi ka zëra në planifikim që nuk varen nga vetë strukturat e drejtorisë së taksave dhe tarifave, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Cërrik, që në procesin e planifikimit, menaxhimit nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale (duke bashkëpunuar të gjitha strukturat që zënë peshë specifike të konsiderueshme në planifikimin e të ardhurave), për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut.

➤ Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:

Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt rakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Cërrik, në lidhje me Tatimin e Thjeshtuar të Fitimit; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Cërrik, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të bashkisë Cërrik dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Cërrik. Nisur nga ky fakt, Bashkia Cërrik duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë

mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas nenit 117²të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

- Taksa mbi ndërtesat paraqitet me realizim në nivelet 64% për ndërtesa familjare, 73% për ndërtesa biznesi dhe 80% për ndërtesa të institucioneve. Për planifikimin e kësaj takse DTTV iu referohet të dhënave që disponon si dhe përditësimeve që vijnë si rezultat i finalizimit të procesit të legalizimit apo verifikimeve në terren nga specialistët e taksave. Për planifikimin e kësaj takse DTTV duhet të marrë informacion periodik nga ASHK, bazuar nga përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 24-vertëtimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave. Në kushtet e mosmarrjes informacion nga ASHK, DTTV e kryen planifikimin e kësaj takse bazuar në nivelet e realizimit të viteve paraardhës si dhe të verifikimeve sporadike në terren. Për sa më sipër, Bashkia Cërrik duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

-Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

-Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare”.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë paraqitur në:

Tabelën nr. 4: Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë.

000/lekë

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	2023
Drejtoria Rajonale e Tatimeve	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	118
Drejtoria Rajonale e Tatimeve	Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale	11,660
Drejtoria Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor	Taksa e mjeteve të përdorura të transportit	13,357
Dega e Doganës	Taksa e rentës minerare	41
Totali		25,176

Burimi: Bashkia Cërrik

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

- Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve

Në Bashkinë Cërrik familjaret ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, taksën e truallit, tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe të gjelbërimit. Tarifa e shërbimit për familjarët parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidentë aktive të bashkisë dhe tarifës për familje të vendosur me VKB Cërrik. Bashkia Cërrik nuk ka një akt-marrëveshje me OE “Ujësjetllës. Cërrik” Sha, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të rolit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore të përfshira në faturën e ujit të pijshëm.

Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrit të taksës që ka çdo njësi administrative, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh (në pjesën dërmuese nga agjentët e terrenit të strukturës së drejtorisë).

- *Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese*

Shërbimi për familjarët ofrohet nga zyra me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative, nga specialistët e taksave të ngarkuar për taksat dhe tarifave vendore (biznes dhe familjare).

Pas miratimit nga Prefektura Elbasan, Paketa Fiskale e Bashkisë Cërrrik publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifave vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e njoftimeve për detyrimet vendore familjare, bëhet kryesisht nga specialistët e taksave nga çdo njësi administrative, si në mënyrë verbale ashtu dhe në mënyrë shkresore me postë.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023, debia për mos pagesën e detyrimeve tatimore nga familjarët është në vlerën 53,752,516 lekë. Vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Cërrrik, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjar deri në datën 31.12.2023.

Tabela nr.5: Detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifave vendore si vijon:

Nr.	PER ABONENTËT FAMILJAR	Viti 2022		Viti 2023	
		Nr. Familje	Vlera	Nr. Familje	Vlera
1	Taksa e tokës bujqësore	2,961	10,217,000	2,989	11,496,290
2	Taksa e pastrimit	3,441	6,245,370	3322	7,900,350
3	Taks ndërtesë (objekt banimi)	2,926	13,004,059	3,059	15,148,411
4	Taksa gjelbërimi	2,822	564,120	2,090	345,610
5	Taksa ndriçimi	3,031	1,261,710	3,285	1,900,706
6	Taksa e truallit	2,926	198,124	3,059	216,234
7	Taksa e arsimit	2,986	307,500	3,322	516,602
8	Qira toke	139	3,202,581	219	3,699,113
9	Qira fondi pyjor kullisor	1	16,500	4	275,500
10	Qira objekti	6	403,236	2	132,388
11	Kamatë	146	12,327,158	225	12,121,312
	SHUMA		47,747,358	21,576	53,752,516

Burimi: Bashkia Cërrrik

Tabela nr.6: Detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifave vendore të ndara sipas Njësie administrative si vijon:

Nr.	Njësitë Administrative	Truall	Ndërtese	Toka	Pastrim	Ndriçim	Gjelbërim	T. Arsimi	Kamatë	Qira toke	Qira fondi pyjor	Qira objekti	Totali
1	Njësia Cërrrik	43,517	3,725,341	405,000	3,207,609	1,402,046	261,270	164,100	1,989,622	64,683			11,263,188
2	Njësia Gostime	49,040	2,942,601	2,629,986	1,410,440	382,250	71,100	93,800	2,854,016	0		65,068	10,498,301
3	Njësia Mollas	23,401	1,626,587	2,265,998	817,501	1,180	820	62,902	3,240,185	3,203,207	275,500	67,320	11,517,281
4	Njësia Shales	51,610	3,673,213	3,581,910	1,256,300	9,910	1,290	118,000	2,104,439	405,233			11,201,905
5	Njësia Klos	48,666	3,180,669	2,613,395	1,208,500	105,320	11,130	77,800	1,933,050	25,990			9,204,520
	Bashki Cërrrik	216,234	15,148,411	11,496,289	7,900,350	1,900,706	345,610	516,602	12,121,312	3,699,113	275,500	132,388	53,752,515

Burimi: Bashkia Cërrrik

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizike/juridike dhe familjare, ku përfshihen regjistrat sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, etj, në Bashkinë Cërrik kryhet në programin Excel. DTTV kryen regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizike), çdo informacion që grumbullon nga NJA dhe nga vetë strukturat e bashkisë i administron në Excel, në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të shtuar ndaj defekteve të ndryshme kompjuterike (humbjen e të dhënave). Funksonimi i një sistemi të mirëfilltë për taksat dhe tarifat vendore është detyrim ligjor sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 i ndryshuar, ku citohet që në çdo bashki krijohet regjistri i taksave dhe tarifave vendore (pika nr. 7). Mungesa e një sistemi të mirëfilltë sjell që kamatëvonesat të llogariten në momentin e pagesës së detyrimit nga debitorët (biznes apo familjare).

Tabela nr.7: Situata e lëvizjes së subjekteve paraqitët si më poshtë:

Emërtimi	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrimet e reja (hyrje)	Mbyllur aktiviteti (dalje)	Gjendja në fund të vitit
Biznesi i vogël	2023	515	28	77	466
Biznesi i madh	2023	100	7	5	102
Ambulant	2023	12	0	0	12
OJF	2023	0	0	0	0
Institucione	2023	12	0	0	12
Total		639	35	82	592

Burimi: Bashkia Cërrik

➤ **Të ardhura dhe vlera debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit, Bashkia Cërrik në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, janë dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve të destinuar për regjistrimi pranë ASHK Elbasan. Konkretisht për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2023, sipas listave të vëna në dispozicion dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se detyrimi për këtë taksë është me vlerë 55,018,957 lekë për 1200 persona, kanë paguar detyrimin 722 persona me vlerë 35,368,590 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri më datë 31.12.2023 gjithsej 478 persona me vlerë 19,650,367 lekë.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit, Bashkia Cërrik për personat e ndodhur në listat debitorë për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë i është ridrejtuar me shkresën nr. 2771 prot., datë 29.12.2023, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, kërkesë për bashkëpunim për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Po ashtu, Drejtorisë së të Ardhurave Vendore dhe Drejtorisë së Financave të ndodhura në Bashkinë Cërrik i ka dërguar kërkesë bashkëpunimi dhe informacioni me shkresën nr. 2772 prot. datë 29.12.2023 për personat e ndodhur në listat debitorë për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Tabela Nr. 8: Taksa e ndikimit në infrastrukturë.

TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË						
Viti	Persona në total	Persona që kanë arkëtuar	Persona debitor	Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë	Vlera e arkëtuar	Vlera e detyrimit
Deri më datë 31.12.2023	1200	722	478	55,018,957	35,368,590	19,650,367

Burimi: Bashkia Cërrik

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifat vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për subjektet fizik/juridik/institucione shtetërore që operojnë në Bashkinë Cërrik dhe janë debitorë ndaj bashkisë në vlerën 16,921,095 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Cërrik.

Tabela nr.9: Gjendja e debitorëve:

Nr.	PER SUBJEKTËT FIZIK/JURIDIK/SHTËTROR	Viti 2022		Viti 2023	
		Nr.sub	Vlera	Nr.sub	Vlera
		1	Tarife Arsimi	142	206,250
2	Tarife Gjelbërimi	68	194,630	78	298,120
3	Tarife Ndriçimi	103	363,940	98	358,290
4	Tarife Pastrimi	136	4,314,690	101	5,088,150
5	Takse Ndërtese	123	1,899,040	96	3,633,547
6	Takse Trualli	123	315,382	96	1,583,108
7	Takse Tabele	1	29,565	3	378,240
8	Tarife dhënie Autorizime	1	400,000	2	2,000,000
9	Tarife Parkimi	7	35,400	9	45,600
10	Tatimi i Biznesit të Vogël	27	602,000	31	802,000
11	Taksë hoteli	1	25,550	1	25,550
12	Gjore dhe kamatë	142	1,738,125	103	2,247,240
13	Leje veprimtarie	11	70,000	16	107,000
14	Hapësirë Publike Ambulantët	2	82,200	1	34,000
	SHUMA		10,276,772	738	16,921,095

Burimi: Bashkia Cërrik

Strukturat tatimore të Bashkisë Cërrik në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kanë njoftuar bizneset debitorë për kalimin e afateve të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore. Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet ndaj bashkisë, janë nxjerrë shkresat përkatëse për të ndërmarrë hapa të tjera në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Komisaratin e Policisë së Cërrikut, bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor. Janë zbatuar një pjesë e procedurave sipas ligjit nr. 9920, si bllokimin e llogarive bankare, duke filluar me nr.490 prot., deri nr. 545 prot., datë 21.04.2022 (gjithsej 56 subjekte), me nr. 443 prot., datë 02.03.22 (1 subjekt), me nr. 464 prot., datë 07.03.22 (1 subjekt) me nr. 466 prot., datë 07.03.22, 9 (1 subjekt) me nr. 571 prot., datë 26.05.22 (1 subjekt) me nr. 1133 prot., datë 13.10.22 (1 subjekt) me nr. 1136 prot., datë 13.10.22 (1 subjekt). me nr.1138-1139 prot., datë 13.10.22 (2 subjekte) me nr.1141-1143 prot., datë 13.10.22 (3 subjekte) me nr. 860, datë 19.06.23 (1subjekt) me nr. 861prot., datë 19.06.23 (1 subjekt), gjithsej 69 subjekte. Për subjektet debitorë nuk është zbatuar masa e sigurimit të detyrimit tatimor/sekuestrimi i pasurisë.

Sipas të dhënave për strukturën organike të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Bashkia Cërrik konstatohet se nuk ka një të ngritur një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit (debitorëve nga taksat/ tarifat vendore).

Referuar të dhënave të paraqitura nga kjo drejtori, detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për abonentët familjarë dhe subjektet fizik/juridik. -Nga auditimi i të dhënave, rezulton se: a) më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familjar në vlerën 53,752,516 lekë. Vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Cërrik, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjar deri në datën 31.12.2023. b) Për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe institucionet shtetërore në vlerën 13,871,855 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Cërrik. c) Për mos pagimin e taksës së

infrastrukturës 19,650,367 lekë. d) mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën 2,000,000 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit, Bashkia Cërrik në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, janë dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve të destinuar për regjistrimi pranë ASHK Elbasan. Konkretisht për periudhën 01.01.2017 deri me 31.12.2023, sipas listave të vëna në dispozicion dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se detyrimi për këtë taksë është me vlerë 55,018,957 lekë për 1200 persona, kanë paguar detyrimin 722 persona me vlerë 35,368,590 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri me datë 31.12.2023 gjithsej 478 persona me vlerë 19,650,367 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Cërrik

Tabela nr.8: Taksa e ndikimit në infrastrukturë.

TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË						
Viti	Persona në total	Persona që kanë arkëtuar	Persona debitor	Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë	Vlera e arkëtuar	Vlera e detyrimit
Deri më datë 31.12.2023	1200	722	478	55,018,957	35,368,590	19,650,367

Burimi: Bashkia Cërrik

Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Cërrik dhe në NjA Gostime, Mollas, Shales, Klos, ushtrojnë aktivitetin 16 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, si vijon:

Tabela nr.10: Hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	“G. C.”sh.p.k. Malasej	K.....T	25.11.2020	25.11.2025	1,000,000	1,000,000	0
2	“G. C.”sh.p.k. Kanrjer	K.....T	28.12.2018	18.12.2023	1,000,000	1,000,000	0
3	“K.” sh.p.k.	J.....P	03.02.2022	03.02.2027	1,000,000	1,000,000	0
4	“G. O.”sh.p.k.Gostim	L.....N	16.12.2020	16.12.2025	1,000,000	600,000	400,000
5	“G. O.”sh.p.k. Kamuna	L.....N	11.12.2020	11.12.2025	1,000,000	400,000	600,000
6	“F.” sh.p.k.	L.....T	18.06.2020	18.06.2025	1,000,000	0	1,000,000
7	“D. O.”sh.p.k	L.....O	22.09.2019	22.09.2024	1,000,000	600,000	400,000
8	“X. O.”sh.p.k.	L.....G	16.09.2019	16.09.2024	1,000,000	600,000	400,000
9	“L. O.”sh.p.k	L.....U	06.03.2022	06.03.2027	1,000,000	600,000	400,000
10	“D.”sh.p.k.	M.....S	06.08.2020	06.08.2025	1,000,000	1,000,000	0
11	“S.”sh.p.k.	K.....P	12.03.2019	12.03.2024	1,000,000	1,000,000	0
12	“I. O.”sh.p.k.	M.....P	12.12.2020	12.12.2025	1,000,000	1,000,000	0
13	“A.”sh.p.k.	L.....C	10.11.2023	10.11.2028	1,000,000	1,000,000	0
14	“Z. F.” sh.p.k.	L.....B	18.10.2022	18.10.2027	1,000,000	0	1,000,000
15	H. B. pike gazi fundore	L.....G	23.09.2021	23.09.2023	100,000	40,000	60,000
16	“Sh. O.”sh.p.k.	L.....G	21.11.2021	Pezulluar 2022	0	0	0
SHUMA					14,100,000	9,840,000	4,260,000

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Cërrik për vitin 01.10.2019 deri në 17.01.2024 ushtrojnë aktivitetin 15 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 11 subjekte janë pajisur me liçencë të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre nga të cilat si vijon:

Tabela nr. 11: Subjektet e pajisura me licenca që tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	"G. C."sh.p.k. Malasej	K.....T	25.11.2020	25.11.2025	1,000,000	1,000,000	0
2.	"G. C."sh.p.k. Kanrjer	K.....T	28.12.2018	18.12.2023	1,000,000	1,000,000	0
3.	"K." sh.p.k.	J.....P	03.02.2022	03.02.2027	1,000,000	1,000,000	0
4	"D. O."sh.p.k.	L.....O	22.09.2019	22.09.2024	1,000,000	600,000	400,000
5	"X. O."sh.p.k.	L.....G	16.09.2019	16.09.2024	1,000,000	600,000	400,000
6	"L. O."sh.p.k.	L.....U	06.03.2022	06.03.2027	1,000,000	600,000	400,000
7	"D."sh.p.k.	M.....S	06.08.2020	06.08.2025	1,000,000	1,000,000	0
8	"S."sh.p.k.	K.....P	12.03.2019	12.03.2024	1,000,000	1,000,000	0
9	"I. O."sh.p.k.	M.....P	12.12.2020	12.12.2025	1,000,000	1,000,000	0
10	"A."sh.p.k.	L.....C	10.11.2023	10.11.2028	1,000,000	1,000,000	0
11	"H. B." pike gazi fundore	L.....G	23.09.2021	23.09.2023	100,000	40,000	60,000
SHUMA					10,100,000	8,840,000	1,260,000

Burimi: Bashkia Cërrik

Kanë pezulluar aktivitetin e tyre 1 subjekt, i cili nuk ushtron më aktivitetin në tregtimin me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre si vijon:

Tabela nr.12: Subjektet e mbyllura dhe të pezulluara, hidrokarbure.

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	"Sh. O."sh.p.k.	L.....G	21.11.2021	pezulluar	0	0	0
SHUMA					0	0	0

Burimi: Bashkia Cërrik

Për sa më sipër konstatohet se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas) dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Kështu, nga verifikimi në faqen e internetit të QKB-së, u konstatua se në Bashkinë Cërrik, figurojnë 16 subjekte gjithsej, 11 të pajisura me liçencë si dhe 2 subjekte të pa liçencuara të cilët ushtrojnë aktivitet dhe kanë detyrimin fiskal në vlerën 2,000,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Cërrik. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar neni 35.
- 2) VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4.
- 3) VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9 dhe.

Tabela nr.13: Subjektet e pa pajisura me licenca/autorizime në tregimin me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	"Z. F."sh.p.k.	L.....B	Pa autorizim		1,000,000	0	1,000,000
2	"F."sh.p.k.	L.....T	Pa autorizim		1,000,000	0	1,000,000
SHUMA					2,000,000	0	2,000,000

Burimi: Bashkia Cërrik

Gjatë vitit 2023 nga shkresat e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore kanë shlyer detyrimet e prapambetura: OE "G. C." ShPK, Malasen ka shlyer këstin prej 600.000 lekë, OE "G. C." ShPK, Kantjer ka shlyer 200,000 lekë, OE "D." ShPK, ka shlyer 600,000 lekë, OE "I." ShPK, ka shlyer 600,000 lekë. Gjithsej në vitin 2023 janë mbledhur 2,000,000 lekë. Për detyrimet e prapambetura është bashkëpunuar me grupe pune me Policinë Bashkiake Cërrik, shkresë nr. 884 datë 18.09.2023.

Konkluzion:

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Cërrik në vlerën totale 160,229,380 lekë.

1. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve në vlerën 53,752,516 lekë.
2. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së tokës bujqësore në vlerën 70,954,642 lekë.
3. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit në vlerën 16,921,095 lekë.
4. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 19,650,367 lekë
5. Të ardhura të munguara nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën 2,000,000 lekë.

Për periudhën objekt auditimi, përgjegjësi mbajnë punonjësit e mëposhtëm:

z. K. B., me pozicion Përgjegjës sektori i të ardhurave nga pronat me qira, tregjeve, transportit dhe të tjera tatime.

Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 42 "Administrimi i mjeteve monetare", pika 2.

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar për vitin 2023.

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2023 nga njësia shpenzuese "Aparati i Bashkisë Cërrik" për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël".

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduar.**

Bashkia Cërrik për vitin 2023 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduar, pasi nuk ka në varësi njësi shpenzuese me nipt më vete, pasi Agjencia e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsim Kulturës i janë bashkuar Aparatit të Bashkisë.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare.**

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Cërrik për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr. extra prot., datë 21.03.2024. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është nënkryetari i Bashkisë Cërrik dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është drejtori i Financës. Pra në këtë rast kemi delegime të këtyre detyrave.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë.**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2023.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat nuk janë regjistruar në momentin e çeljes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar, detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, dhe janë të paraqitura të plota në bilanc. por janë pa regjistruar faturat e muajit dhjetor 2023 pasi janë brenda afatit 30 ditor.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivët, pasivët dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumën përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura .

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe pronave Publike.

Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në me formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2023”.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 55,705,879.21 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “ Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Floë) sipas metodës direkte”.

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”**, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 55,705,879.21 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr. 5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2023”.

- **Gjendja e llogarisë 465 “Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë”** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 414,350 lekë. Kjo gjendje përfaqëson vlerën e letrave me vlerë gjendje në arkë apo Sektorin e Tatimeve, ku përfshihen biletat e tregjeve. Letrat me vlerë janë bërë hyrje në arkë me çmim shitje dhe janë kryer veprimet kontabël për hyrjet në arkë dhe daljen nga arka. Gjendja e letrave me vlerë në datë 31.12.2023 është 414,350 lekë si më poshtë:

Emërtimi	Nr. blloqesh	Nr.fletesh/bllok	Cmimi/flete	Vlera ne leke
Bileta tregu	28	100	100	280,000
Bileta tregu	21	100	50	105,050
Bileta tregu	6.56	100	30	19,680
Bileta tregu	4.8	100	20	9,620
Shuma				414,350

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 20,720,608.45 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 19,436,709.00

lekë, ku diferenca e tyre në zbritje në vlerën prej -1,283,899.00 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 4,346,113.45 lekë dhënë mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,462,338.00 lekë, me një diferencë në zbritje për vitin ushtrimor prej -1,883,775.45 lekë, e cila përfaqëson shtim të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 16,374,495 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 16,974,371 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 599,876 lekë, e cila përfaqëson rritje të inventarit të imët për vitin 2023.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 128,251,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 151,669,598 lekë, ku kemi shtim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i kryerjes së pagesave ndaj kreditorëve të ndryshëm në lidhje me investimet dhe shërbimet e ndryshme.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 101,175,979 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 119,911,530 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një ulje prej 1,544,543 lekë. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të taksave në vlerën 51,395,960 lekë, që zënë 42,8% të vlerës debitorë. Pjesa tjetër janë detyrimet e lindura nga rekomandimet “shpërblim dëmi” të lëna nga KLSH në vite, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërimit. Analiza e gjendjes së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në Aneks bashkëlidhur RPA:

Gjendja e llogarisë 468“Debitorë të ndryshëm” me date 31.12.2023

NR	DEBITORET LLOGARIA 468	GJENDJA ME 01.01.2022	Shtesa për vitin 2023	Paksime për vitin 2023	Gjendja me 31.12.2023
	BASHKIA CERRIK				0
1	Taksa vendore familjar(Lista)	31,798,332	5,725,773		37,524,105
2	Taksa vendore biznesi (Lista)	7,936,647	5,935,208		13,871,855
3	Qira Toke	15,546,239	274,186		15,820,425
4	Qira objekti	403,236		270,848	132,388
5	Qira fondi Pyjor	0	275,500		275,500
6	Taksa e ndikimit në Infrastrukturë	15,537,274	4,154,883		19,692,157
7	Gjoha IKMT	13,770,000	1,550,000		15,320,000
8	B. U. (B. shpk)	524,447	0		524,447
9	A. H. (V. H.)	883,285	0		883,285
10	N. B. (E.)	146,040	0		146,040
11	S. N.	694,296	0		694,296
12	S.	1,214,530	0		1,214,530
13	H. SHPK	1,841,000	0		1,841,000
14	H. SHPK	514,300	0		514,300
15	I. C.	109,200	0		109,200
16	M. Gj.	200,000	0		200,000
17	F. M.	128,328	0		128,328
18	"Z." SHPK	1,804,560	0		1,804,560
19	"V." SHPK	31,540	0		31,540
20	"V. H." SHPK	2,540,095	0		2,540,095
21	"E." SHPK	993,280	0		993,280
22	"B." ShPK, "S." ShPK & "A." ShPK	1,945,471	0		1,945,471
23	"B." SHPK	1,496,539	0		1,496,539
24	"V. H." SHPK	733,977	0		733,977
25	"Z." SHPK	233,363	0		233,363
26	E. M.	50,000	0		50,000
27	R. T.	50,000	0		50,000

NR	DEBITORET LLOGARIA 468	GJENDJA ME 01.01.2022	Shtesa për vitin 2023	Paksime për vitin 2023	Gjendja me 31.12.2023
28	M. K.	50,000	0		50,000
29	V. H. shpk Rruga Qyrkan p.pa kryer		271,632		271,632
30	V. H. shpk Rruga Kamunah, pun pa kryer		102,316		102,316
31	M. shpk,Kanale vadites pune e pakryer		104,610		104,610
32	A., Rruga Lican pune e pa kryer		129,152		129,152
33	G. shpk, 3-Rruget ,pune e pa kryer		369,779		369,779
34	Z. shpk Objekt 2 kate ,pune e pa kryer		113,360		113,360
	Totali	101,175,979	19,006,399	270,848	119,911,530

- **Gjendja e llogarisë 4342** “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 31,312,568 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2023, që trashëgohen në vitin 2024. Kjo gjendje ka në analizë ose përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-404 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” në vlerën 3,794,213 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 24,422,793 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 561,083 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 2,276,479 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 258,000 lekë. Gjendja e llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” pasqyron detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundërpartit në pasiv të Bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga:

- Gjendja e llogarisë **486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 167,506,789 lekë, vlerë e cila rakordon me gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, ku në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 167,506,789 lekë dhe përfaqëson detyrimet të prapambetura ndaj të tretëve.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

.Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël, nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivët Afatgjatë**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,123,993,085 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,110,227,930 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,771,434,305 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,211,552,768, të cilat janë të pasqyruara më poshtë, sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjatë jo materiale” që përbëhet nga:

Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 10,150,267 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën prej 9,542,342 lekë, diferenca është vlera e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 42,005,991 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 43,082,009 lekë, me një diferencë në rritje prej 1,076,018 lekë, që i përket 1 projekti elektrik prej 21,765 lekë dhe 1 projekti për rikonstruksion rrugësh të brendshme në vlerën 1,054,253 lekë. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar në Aneks.

Referuar tabelës vlera bruto prej 43,082,009 lekë i përket 48 projekteve, të cilat janë për investime në rrugë, sheshe, ujësjellës e KUZ, objekte arsimore e kulturore, zyra, kanale ujitës, qarkullim rrugor, rikonstruksion banesash, azhurnim fondi pyjor etj, vlera e të cilave nuk është kontabilizuar si pjesë e aktivitetit, pasi janë në proces dhe pritet të vihen në funksionim në vitet e mëvonshme. Nga këto:

- 11 projekte në vlerën bruto prej 7,627,769 lekë nuk janë zbatuar në mungesë të kryerjes së investimit.

- 24 projekte në vlerën bruto 31,241,880 lekë, ku sipas pretendimeve të Drejtorisë së Financës dhe Pronave investimet në zbatim të tyre janë në proces, por sipas të dhënave të paraqitura nuk ka një pasqyrim dhe analizë të qartë të tyre nëse aktivet, të cilat u përkasin këtyre projekt-studimeve janë kapitalizuar apo jo për të vazhduar më tej me bashkimin e vlerës projektit me vlerën e aktiveve përkatëse që janë kapitalizuar.

-12 projekte në vlerën bruto prej 4,212,360 lekë pretendohet se janë amortizuar, por në fakt amortizimi është përlllogaritur për çdo vit në grup aktivesh dhe jo aktiv për çdo aktiv, duke sjelle mungesë të dhënash, nëse është amortizuar në vlerë të plotë apo pjesor dhe në çfarë vlere

të mbetur është çdo aktiv pjesë e gjendjes së llog. 202 “Studime dhe kërkime” në vlerë neto 9,542,342 lekë.

Për këto vlera duhet të detajohen sipas investimeve dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 16/b.d, Kreu III. Aneksi 1 pika 2 Klasa 2, me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b.

- U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2023.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,409,354,232.00 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën totale prej 1,625,046,197.00 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,771,434,305 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,211,522,768 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 43,500,252 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 43,500,252 lekë, për këtë llogari amortizim nuk llogaritet. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 është në të njëjtën vlerë prej 43,500,252 lekë, pasi nuk ka shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2023. Analiza e gjendjes së llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqiten në Aneks bashkëlidhur RPA.

	Emërtimi i aktivit	Gjendja në fund të vitit 2022	Shtesa	Pakësime	Gjendja në fund të vitit 2023
	Shuma	43500252			43500252
1	Troje	2744312			2744312
2	Toke bujqësore	14011324			14011324
3	Terrene te shtresave	300000			300000
4	Sistemime dhe rregullime te tokave				
5	Te tjera	1748940			1748940
6	Troje sheshe Mollas	300000			300000
7	Troje Qendra e Grumbullimit	569469			569469
8	Toka inproduktive	23826207			23826207

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 11,169,913 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 11,169,913 leke.

Inventari kontabël i llogarisë 211 "Pyje,kullota,platacione" me datë 31.12.2023

	Shuma	11169913		11169913
1	Pyje	625926		625926
2	Kullota	4938261		4938261
3	Plantacione	4502779		4502779
4	Pyllzim fidana mollas	58800		58800
5	livadhe	290059		290059
6	ledhe	754088		754088

- **Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 836,129,779 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 794,323,290 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike, sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,065,772,500 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,065,772,500 lekë. Gjatë vitit 2023 nuk janë krijuar aktive shtesë. Analiza e gjendjes së llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” dhe ndryshimet për vitin 2023 paraqiten në Aneks bashkëlidhur RPA.

Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 445,309,013 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 703,280,674 lekë, ku diferenca prej 259,971,661 lekë është shtesa për vlerën neto të investimit të mbyllur në vitin 2023 në shumën 433,791,819 lekë, si dhe amortizimi i llogaritur për vitin 2023. Ndërsa gjendja me kosto historike, sipas Formatit nr. 7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,408,024,116 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,841,815,935 lekë. Gjatë vitit 2023 janë bërë shtesat në vlerën 433,791,819 lekë, e përbërë nga vlera 340,786,854 lekë përfaqëson investime të kryera me pagesë brenda sistemit në Ujësjellës Mollas nga vlera prej 93,004,965 lekë që përfaqëson investime me pagesë në rrugë dhe KUZ. Analiza e gjendjes së llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, si dhe ndryshimet për vitin 2023 paraqiten në Aneks bashkëlidhur RPA.

Bazuar në VKM nr. 302, datë 11.05.2023 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” dhe marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të “Ujësjellës Kanalizime Elbasan” Sha, “Ujësjellës Kanalizime Cërrik” Sha, i është bashkëngjitur “Ujësjellës Kanalizime Elbasan” Sha. Këshilli i Bashkisë Cërrik me VKB nr. 91, datë 27.12.2023 “Për transferimin kapital të aseteve të Bashkisë Cërrik” ka miratuar kalimin pa pagesë nga bashkia Cërrik në Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Elbasan” Sha, objektet e mëposhtme:

1. Rrjetin e linjave KUZ të Bashkisë Cërrik, kosto historike me vlerë 171,301,008 lekë dhe me vlerë neto 54,176,546 lekë.
2. Rrjetin e ujësjellësit të bashkisë Cërrik me kosto historike në vlerën 387,054,468 lekë dhe vlerë neto 122,411,886 lekë

Referuar analizës të gjendjes së llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezulton se, nuk është zbritur vlera e investimeve të kryera në ujësjellës që duhej të transferohej tek “Ujësjellës Kanalizime Cërrik” Sha, për 33 objekte në vlerën 974,489,659 lekë (përfshirë investime në ujësjellës e rrjetin shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji).

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 153, datë 03.04.1993 “Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore, të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” i ndryshuar, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 46,871,270 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 46,763,416 lekë, ku diferenca është amortizimi i përlllogaritur i vitit ushtrimor për këtë grup aktivesh. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr. 7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 69,927,977 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 72,046,780 lekë, për të cilat ka inventar fizik. Në këtë grup aktivesh shtesat për vitin 2023 janë në shumën 2,353,378 lekë, dhe pakësimet në vlerën prej 234,575 lekë, e cila përbëhet nga nxjerrjet jashtë përdorimit të këtyre aktiveve në vlerën 234,575 lekë të vitit 2023. Analiza e gjendjes së llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, si dhe ndryshimet nga viti 2022 në vitin 2023 paraqitet në Aneks.

Nr.	Emërtimi I aktivitet	Gjendja në 31.12.2022	Shtesat gjate vitit 2023	Gjendja në 31.12.2023	Nr.	Emërtimi I aktivitet	Gjendja në 31.12.2022	Shtesat gjate vitit 2023	Gjendja në 31.12.2023
	Shuma	69927977	2353378	72281355					
1	Pajisje e shp instaluese telekomunikacio	1641197		1641197	28	Stacione autobusi	9418000		9418000
2	Orendi dhe pajisje mence	216870		216870	29	Ndrcim rrugor	605400		605400
3	Pajisje qe sigurojnë energji	14093637	1000000	15093637	30	Klos	142600		142600
4	Ndriçim rrugor lagje nr. 1,nr.2	6282492		6282492	31	Pajisje pirun	148800		148800
5	ndriçim rruge brendesh lagje nr. 1,nr.2	1054514		1054514	32	Kov HD 1450	285200		285200
6	ndriçim rruge te brendshme kantier	619498		619498	33	m,420 Lit	1426000		1426000
7	ndriçim rruge te brendshme SHELG	624013		624013	34	kapse hap/mbyll XL HD	993600		993600
8	Ndriçim Rruges Shtepanje	1067498		1067498	35	Pisje perzjerese TG201	996000		996000
9	Pajisje dhe instrumente laboratorike	303000		303000	36	Presja Hidraulike	86800		86800
11	Instalimi i sistemit te kompjuterave	166800		166800	37	Kontinjer	108000		108000
12	Pajisje dhe instalimi i kondicionereve	6617533		6617533	38	Kolovajze dyshe	49800		49800
14	Pajisje për kontrollin e trafikut	91000		91000	39	Lisharse dyshe	64200		64200
16	Pajisje agrikulturore	87000		87000	40	Loder dyshe	59520		59520
18	Pajisje dhe makineri për kopshtarine	1300660	219131	1519791	41	Stola parku	136920		136920
21	Pajisje pastrimi për rruget	2735000		2735000	42	Pajisje për kompostim	1866000		1866000
22	Pajisje për policine	200000		200000	43	Rafte qendra grumbulli	1680000		1680000
23	Pajisje për sistemin e sigurimit	170000		170000	44	Pirun manovrimi	1462000		1462000
24	Pajisje audio-vizuale	678700		678700	45	Makineri Seleksionimi	2519280		2519280
27	Mjete dhe pajisje te tjera teknike	8867485	1134247	10001732	46	Dhoma Frigoferike	1062960		1062960
						Makine grirse mbetjesh			

- Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti" në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 13,748,554 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 10,998,843 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 57,832,895 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 57,832,8965 lekë. Shtesat gjatë vitit 2023 nuk ka riparimet Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2022 deri në fund të vitit 2023 paraqiten në Aneks bashkëlidhur RPA:

Inventari kontabël i llogarisë 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2023

Nr.	Emërtimi I aktivitet	Gjendja në 31.12.2022	Gjendja në 31.12.2023	Nr.	Emërtimi I aktivitet	Gjendja në 31.12.2022	Gjendja në 31.12.2023
	Shuma	57832895	57832895				
1	Benx 2500 Veture	1100000	1100000	14	Kamjon 3 Akse	2846160	2846160
2	Benx 220 Klas	1660000	1660000	15	Benat me goma 3.16	8696493	8696493
3	Makin Landrover Klosi	460000	460000	16	Eskavator me zinxhir	9055196	9055196
4	Benc 2500 nga shalsi	998000	998000	17	Eskavator me zinxhir(Ujesjellsi	1746000	1746000
5	Makina rruget rurale Elbasan 2400	705497	705497	18	Ambulanca	824600	824600
6	Makina benc 270 Gostim	1776000	1776000	19	Mjete kunder zjarrit	5233179	5233179
7	langrover	2472000	2472000	20	Mjete te tjera transporti(Auto vinc)	1235000	1235000
8	Iveko	1349255	1349255	21	Traktor korse bari	1104000	1104000
9	Iveko	1349255	1349255	22	Traktor për kompostim	4439200	4439200
10	Forde	946900	946900	23	Kamjoncin 1.5 t	646800	646800

Nr.	Emërtimi I aktivitet	Gjendja në 31.12.2022	Gjendja në 31.12.2023	Nr.	Emërtimi I aktivitet	Gjendja në 31.12.2022	Gjendja në 31.12.2023
11	Autobuze	2988000	2988000	24	Rimorkjo 1 t	357360	357360
12	Kamjon Benx 814 3.5 ton	1572000	1572000	25	Traktor për kompostim plera	780000	780000
13	Kamjon Teknologjik VOLVO	3492000	3492000				

- **Gjendja e llogarisë 218 "Inventar Ekonomik"** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 12,625,451 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 15,009,809 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr. 7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 73,200,661 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 76,302,484 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 2,501,858 lekë e pajisjeve dhe transferimet kapitale nga institucionet e tjera qendrore në vlerën 3,634,952 lekë, për të cilat janë ndjekur procedurat financiare e ligjore për evidentimin e tyre. Pakësimet janë në vlerën 3,034,987 lekë, që përfaqësojnë aktivet e inventarit ekonomik të nxjerrë jashtë përdorimi për llogari të vitit 2023.

Nr.	Emërtimi I aktivitet	Gjendja në 31.12.2022	Shtesa gjatë vitit 2023	Pakësime gjatë vitit 2023	Gjendja në 31.12.2023
	INVENTAR EKONOMIK	73200661	6136810	-3034987	76302484
1	Orendi zyre	18678185		-1504975	17173210
2	Fotokopje	987700			987700
3	Vidjo projektor	54000			54000
4	Pajisje kompjuteri	16695462	3734952	-47888	20382526
5	Te tjera pajisje zyre	36785314	2401858	-1482124	37705048
	Aktive ne proces	625121740		-228849195	396272545

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2023 paraqiten në Formatin nr.7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" të PF si më poshtë:

Nr. Refer Llog	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGJ/O MATERIALE	42,005,991	31,855,724	10,150,267	1,076,018	1,683,943	0	0	43,082,009	33,539,667	9,542,342
202	Studime dhe kerkime	42,005,991	31,855,724	10,150,267	1,076,018	1,683,943			43,082,009	33,539,667	9,542,342
21-28	II. AAGJ/ MATERIALE	2,729,428,314	1,320,074,082	1,409,354,232	442,282,007	226,590,042	3,269,562	3,269,562	3,168,440,759	1543394562	1,625,046,197
210	Toka,troje,Terene	43,500,252	0	43,500,252					43,500,252	0	43,500,252
211	Pvje,Kullota Plantacione	11,169,913	0	11,169,913					11,169,913	0	11,169,913
212	Ndertime e Konstruksione	1,065,772,500	229,642,721	836,129,779		41,806,489			1,065,772,500	271,449,210	794,323,290
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,408,024,116	962,715,103	445,309,013	433,791,819	175,820,158			1,841,815,935	1,138,535,261	703,280,674
214	Ins tekn,makiner,pais,vegla	69,927,977	23,056,707	46,871,270	2,353,378	2,461,232	234,575	234,575	72,046,780	25,283,364	46,763,416
215	Mjete transporti	57,832,895	44,084,341	13,748,554		2,749,711			57,832,895	46,834,052	10,998,843
218	Inventar ekonomik	73,200,661	60,575,210	12,625,451	6,136,810	3,752,452	3,034,987	3,034,987	76,302,484	61,292,675	15,009,809
24	Aktive Qend trupesh te demtu								0	0	0
28	Caktime								0	0	0
	TOTALI (I+II)	2,771,434,305	1,351,929,806	1,419,504,499	443,358,025	228,273,985	3,269,562	3,269,562	3,211,522,768	1,576,934,229	1,634,588,539

- **Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale** paraqitet në bilanc në vlerën 1,576,934,229 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

"Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara" është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.3.2018" Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 36. Për llogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

- Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Cërrrik

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2023 për Bashkinë Cërrik.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2023 kanë dalë urdhri nr. 266, datës 25.10.2023 “Për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, ky komision mbasi ka kryer inventarizimin ka mbajtur procesverbale të datës 26.12.2023. Është mbajtur relacion shpjegues për gjendjen e llogarive”, si dhe ka propozuar për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve objekt inventari që kanë humbur funksionin e tyre dhe kanë mbushur afatet e normuara të përdorimit sipas përcaktimeve të neneve 16, 17, 18, 107, 108 e 109 të Udhëzimit nr.: 30, datë:27.12.2011 të Ministrisë së Financave. Të gjitha proceset e kryerjes se inventarëve për vitet 2023 janë me dokumentacion bashkëlidhur.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi së komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive për Bashkinë Cërrik. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit Dhjetor 2023 dhe rezultojnë pa diferenca.

Në rubrikën e rezultati/shënime nga komisionet e inventarizimit janë evidentuar aktivet që propozohen për nxjerrje jashtë përdorimi. Në fund të procesit të inventarizimit nga grupi i inventarizimit është hartuar procesverbali përmbledhës i datës 26.12.2024 për gjithë inventarin e AAGJM, ku përshkruhen mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit. Kryetari i Bashkisë me Urdhër nr. 266/1, datë 05.01.2024 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit. Komisioni i Vlerësimit me procesverbal të datës 25.01.2024 ka bërë vlerësimin dhe ka propozuar për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre sipas paragrafit 111 të Udhëzimit nr:30, datë 27/12/2011 të Ministrisë së Financave. Në këtë dokument, komisioni është shprehur se, këto aktive janë të konsumuara e nuk kanë më vlerë përdorimi dhe nuk mund të riparohen, si dhe janë listuar materialet që propozohen për t’u nxjerrë jashtë përdorimi, sipas proces-verbalit të Komisionit të Vlerësimit e të sistemuara, sipas llogarive përkatëse, si më poshtë:

Nr.	E M E R T I M I	Vlefte
1	Konvikti	17382
2	Sherbimet Publike	217193.3
	Llog.214“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”	234,575.3

Nr.	E M E R T I M I	Vlefte
1	Administrata Cërrik	341675
2	Nj. Administrative Gostim	1088067.6
3	Nj. Administrative Mollas	257005
4	Nj. Administrative Klos	581468
5	Nj. Administrative Shales	766772
6	Ujësjiellësi	128900
	SHUMA llog. 218 “inventar ekonomik”	3,034,987.6

Nr.	E M E R T I M I	Vlefte
1	Administrata Cërrik	285196.24
2	Nj. Administrative Gostim	223310.7
3	Ujësjiellësi	74037.2
4	Nj. Administrative Klos	49436
2	Nj. Administrative Shales	219569
	SHUMA llog. 327 “inventar i imët”	851,549.19

Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) të klasës 21 për vitin 2023 është në vlerën 3,211,522,798 lekë, ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet e aktiveve gjatë vitit 2023 për shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 43,500,252 lekë;

211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 11,169,913 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,065,772,500 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,841,815,935 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 72,046,780 lekë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2023 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Mungon regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 79,366,846 lekë. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Gjendje 31.12.2023
1	S. C. T.	100,000
2	“E.”SHA	280,000
3	Usjelles Kanalizime Cërrik	79,086,846
	Totali	79,466,846

Kjo gjendje paraqet pjesëmarrjen në investime kapitale të bashkisë Cërrik nëpërmjet zotërimit të aksioneve të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

- Në masën 100% në Shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime Cërrik” Sha në vlerën 78,986,846 lekë. Me VKM nr. 302, datë 11.05.2023 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura” dhe marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të “Ujësjiellës Kanalizime Elbasan” Sha, “Ujësjiellës Kanalizime Cërrik” Sha, i është bashkëngjitur “Ujësjiellës Kanalizime Elbasan” Sha, dhe si rezultat nuk janë kryer veprimet e sistemuese në kontabilitet në lidhje me investimet kapitale.

- Në masën 8% në vlerën 280,000 lekë në shoqërinë e përbashkët tregtare “E.-Elb” Sha, me qendër në Elbasan me kapital fillestar 3,500,000 lekë, për depozitim dhe përpunimin e mbetjeve urbane.

- Në masën 40% në vlerën 100,000 lekë të Shoqërisë së përbashkët “Sport Klub Futbollit “T.” Sha me aksionar kryesor administrator G. Gj. në masën 60%.

Në datën 29.07.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet në ligjin nr.79/2017 “Për Sportin”. Bazuar në nenin 22 të ligjit 105/2020, datë 29.07.2020 “...të gjitha institucionet publike qendrore dhe vendore, të cilat kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Pas përfundimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive”.

Aktualisht, edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore, në të dhënat e regjistrimit tregtar të shoqërisë “Sport Klub Futbollit “T.” Sha, rezulton se Bashkia Cërrik është zotëruese e 40% të aksioneve të saj.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se nga Bashkia Cërrik nuk kanë filluar ende procedurat për kalimin në shitje të “Sport Klubit të Futbollit “T.” Sha, sipas procedurave ligjore dhe nga periudha që klubi sportiv duhej të kalonte procedurat e shitjes, për këtë qëllim janë

disbursuar fonde nga Bashkia Cërrik në vlerën 3,777,399 lekë.

Referuar analizës së kësaj llogarie rezulton se, në këtë vlerë nuk është përfshirë vlera prej 100,000 lekë e investimit kapital në Shoqërinë anonime “Sport Klub Futbollit “T.” Sha në formën e kontributit në kapitalin fillestar në momentin e themelimit. Për vlerën e kapitalit prej 100,000 lekë të derdhur nga Bashkia Cërrik duhet të ishin kryer veprimet e kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” në kredi të llogarisë 1011, “Shtesa të fondit bazë”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 31.

- Gjendja e ***llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”*** në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 396,272,545 lekë. Analiza e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” paraqitet në Aneks.

NR	Emërtimi i aktiveve në proces kapitalizimi	Gjendje në 31.12.2023	NR	Emërtimi i aktiveve në proces kapitalizimi	Gjendje në 31.12.2023
1	Rikonstruksion Shkollë Selvias	42365617	19	Rikonst.Rruga Çameria	20319583
2	Gostima - Tregu	10298964	20	Rikonstruksion Shkolla Selit	8726000
3	Tjera (Platacion)	14207063	21	Mbikqyrje shkolla Selit	674827
4	Supervizim Rruga Linas	650000	22	Rikonstruksion Rruge Kamunah	14064886
5	Kolaudim Fidan Pyjor	58800	23	Rikonstruksion Rruge Lushallijve	16037789
6	Rikualifikime Urbane kende lojrash	3579026	24	Rikualifikim Urban B2, L 1 Cërrik	9999558
7	Permiresim Kushte Banimi	16780251	25	Kolaudim blloku 2 lagje 1	117600
8	Terminal Autobuzi	13345788	26	Rikonstruksion rruga Cërrik Malasenje	8000000
9	Arredim e Foni për Kinemane	4981939	27	Rikonstruksion Rruge Shales Lazarec	10900000
10	Permirsim kushte banimi	12204104	28	Ndertim Kuz dhe Rruge Shtermen	9968326
11	Permirsim kushte banimi	6746484	29	Rikonst,Rruges se Pllakallinjve Gostime	9457003
12	Permirsim kushte banimi	34772302	30	Rikonstruksion I Rruges Fshat Dasar	7073952
13	Permirsim kushte banimi	13464143	31	Rikonst.Rruge Klos se Delinjve	5000000
14	Permirsim kushte banimi 2023	22066042	32	Te tjera Pajisje	216000
15	Rikonst.Rruge rurale Z.	52212877	33	Rikonstruksion Rruga Dyrmave	1066752
16	Supervizim rruge Rurale	1319507	34	Ndriçim Rrugor Ferem	1114440
17	Kolaudim rruge Rurale	390448		SHUMA	396272545
18	Rikonstruksion rruga Qyrkan	24092474			

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 336,662,003 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- ***Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”*** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarije në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 5,439,436 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,794,213lekë, vlerë e cila ka ardhur në zbritje, duke ulur numrin e faturat e palikujduara për mallra, shërbime të periudhës së fundvitit ushtrimor. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se, përbëhet nga 20 fatura të palikujduara ndaj të tretëve, borxh i krijuar në nentor-dhjetor të vitit 2022, ku në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analiza e llogarisë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to (mallra e shërbime)”

Nr .	Përshkrimi i veprimit	Operatori ekonomik	Data e kontratës	Data e faturës	Gjendja ne datë 31.12.2022	Pagesat gjate vitit 2023	Shtesat gjatë vitit 2023	Gjendja ne datë 31.12.2023
1	Mirmbajtje shkollat	S. L.	19/09/2016	11.11.2016	300000			300000
2	Zhavorime	E. I.		25.06.2018	117936			117936

Nr .	Përshkrimi i veprimi	Operatori ekonomik	Data e kontratës	Data e faturës	Gjendja ne datë 31.12.2022	Pagesat gjate vitit 2023	Shtesat gjatë vitit 2023	Gjendja ne datë 31.12.2023
3	Materiale Te tjera	E. L. Tirane	02/02/6792	14.05.2018	1786800			1786800
4	Matesa Uji	Ujesjelles Kanalizi	29/06/2020	29.06.2020	31,200			31,200
5	Organizim I Eventeve	D. & C. SHPK	02/08/2022	12.01.2022			68,029	68,029
6	Shërbime Interneti	A. SHA	02/10/2023	31.10.2022			176,700	176,700
7	Shërbime Interneti	A. SHA	02/10/2023	31.11.2022			176,700	176,700
8	Shërbime Interneti	A. SHA	02/10/2023	30.12.2020	176,680	176,680		
9	Shërbime Interneti	A. SHA	02/10/2023	30.06.2021	176,700	176,700		
10	Shërbime Interneti	A. SHA	02/10/2023	31.01.2022	176,700	176,700		
11	Shërbime Interneti	A. SHA	02/10/2023	28.02.2022	176,700	176,700		
12	Shërbime Interneti	A. SHA	02/10/2023	31.05.2022	176,700	176,700		
13	Shërbime Interneti	A. SHA	02/10/2023	30.06.2022	176,700	176,700		
14	Shërbime Interneti	A. SHA	02/10/2023	29.07.2022	176,700	176,700		
15	Shërbime Interneti	A. SHA	02/10/2023	31.08.2022	176,700	176,700		
16	Shërbime Interneti	A. SHA	02/10/2023	30.09.2022	176,700	176,700		
17	Karburant	G. C. GKG	17/08/2022	17.08.2022	1,613,220	1613220		
18	Organizim I Eventeve	D. & C. SHPK	23/02/2023	22.05.2023			253,453	253,453
19	Shërbim Kolaudimi	P. M.	24/02/2022	03.02.2023			50,000	50,000
20	shërbim pastrimi	V. G.	01/03/2023	10.10.2023			833,395	833,395
					5,439,436	3,203,500	1,558,277	3,794,213

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 24,422,793 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën kontabël 561,083 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2023 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2024.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 2,276,479 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës janar 2024. lekë.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2023 është në vlerën kontabël 258,000 lekë, e cila përbëhet nga:

a. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlere 258,000 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 31,150 lekë, e cila rakordon me detyrimet e pa derdhura të tatimit mbi të ardhurat personale llog.431 “Tatim Taksa” për muajin dhjetor të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 475 “Te ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse”** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 120,325,880 lekë, vlere të cilat rakordojnë me shumën e gjendjeve të llogarive kundërpanti në aktiv të bilancit llog.468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 119,911,530 lekë dhe llog.465 “Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlere” në vlerën 414,350 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 17,485,615.5 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Elbasan, ku në mënyrë analitike paraqitet në Aneks.

- **Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të vonesave të krijuara në kryerjen e procedurave të prokurimit, në lidhjen e kontratave apo në mbërritjen me vonesë të faturave dhe si rezultat i bllokimit të transaksioneve financiare nga MFE në ditët e fundit të dhjetorit të vitit ushtrimor. Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 152,354,112 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 167,506,789 lekë me një diferencë në rritje prej 15,152,677

lekë ne krahasim me vitin 2022, e cila tregon për punë jo te mire nga Bashkia Cërrik për uljen e detyrimeve të papaguar ndaj të tretëve, duke i lënë vend akumulimit të këtyre detyrimeve. Nga analiza e kësaj gjendje rezulton se, janë kryesisht detyrimet të lindura nga punë publike të kryera te pa paguara. Bashkia duhet të mos marrë angazhime për punë publike jashtë kapaciteteve të saj. Kryesisht këto detyrime kanë ardhur nga kontrata shumëvjeçare. Analiza e llogarisë **467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqitet në Aneks.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2023 paraqitet në Aneks.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 715,228,705.71 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Cërrik paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 69,594,250.88 lekë, i cili kuadron me akt rakordimin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 118,034 lekë e cila përfshin *taksën mbi biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 34,899,856 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7033 “Taksa mbi përdorimin mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 13,357,180 lekë e cila përfshin taksa e mjeteve te përdorura.

d. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 21,189,230.88 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin. etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 35,261,064 lekë, i cila kuadron me akt rakordimin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 11,642,133 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet i cili kuadron me akt rakordimin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 23,239,651 lekë, e cila përfshin tarifat e parkimit, kamatëvonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me aktrakordimin me thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** është në vlerën prej 31,312,568 lekë, e cila rakordon me gjendjen e llog. 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në bilancit.

Analiza e shpenzimeve në vitin 2023 , të cilat në total janë në vlerën 677,008,442 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 179,593,730 lekë dhe sipas akt trakordimit me thesarin është në vlerën 179,593,730 lekë diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 33,284,244 lekë dhe sipas akt rakordimit me thesarin është në vlerën 33,284,244 lekë, diferenca nuk ka.
 - Gjendja e llogarisë **602 ‘Blerje mallra e shërbime’** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 116,739,712 lekë dhe sipas akt rakordimit me thesarin është në vlerën 116,739,712 lekë, diferenca nuk ka.
 - Gjendja e llogarisë së fondeve **604 ‘Transferime korrente te brendshme’** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 4,882,448 lekë dhe sipas akt rakordimit me thesarin është në vlerën 4,882,448 lekë, diferenca nuk ka.
 - Gjendja e llogarisë së fondeve **606 ‘Transferime për buxhetet familjare e individë’** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 341,224,409 lekë, e cila rakordon me aktrakordimin me Thesarin.
- Për vitin 2023** totali i te ardhurave ne vlere është 715,228,705.71 lekë dhe totali shpenzimeve është 677,008,442 lek. Diferenca e tyre ne vlerën 38,220,263.71 rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”
- Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 ‘Ndryshimi i gjendjes së inventarit’** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2023 është në vlerën -1,283,899 lekë .

Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”

- Zëri “Burimet për investime” Formati 6, i plotësuar për shumën 119,886,583 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 81,265,186 lekë fonde të akorduara nga buxheti për investime, vlera prej 3,634,952 lekë investime te dhuruara nga donatore vendas. Vlera prej 34,986,445 leke përfaqëson fondet për investimet nga te ardhurat e veta te Bashkisë
- Zëri “Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale” formati 6 e plotësuar për shumën 207,396,002 lekë në analizë rakordon me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” kolona 4 formati 7/b.

- Nga testi kontrollit për vitet 2023 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:
- Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative. Gjendja e arkës nuk e kalon limitin e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kreut III pika 34 dhe 35 gërmat “a”, “b” dhe “c” të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr. 290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës”.

- Ligjshmëria dhe saktësia e e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi

dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- Pagesat e kryera jashtë afatit 30 ditë të paraqitjes së faturës.

Konkluzion: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2023 me urdhër-shpenzime në **32** raste faturash me vlerë 68,473,784 lekë, mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Cërrrik, ku 14 raste në vlerën 13,926,632 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llog. 602 “Shpenzime operative” dhe në 18 raste në vlerën 54,547,152 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llog.231 “Investime”, ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve. Likuidimi me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52³, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”. Rastet më konkretisht paraqiten në tabelat në Aneks.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z. H. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Pronave Publike në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe zj. A. S. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe rregjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

Asetet e kaluara nga pushteti qendror pranë Bashkisë Cërrrik paraqiten, sipas VKM-ve

- Për **Bashkinë Cërrrik** (Bashkia Qendër) është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrrik, me VKM nr. 573, datë 28.05.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrrik”, sipas lidhjes nr.1 me 261 (dyqindëgjashëdhjetenjë) fletë e përbërë nga 1979 (njëmijëntëqindëdhjetatë dhjetenëntë) prona.

- Për **Njësinë Administrative Mollas** është miratuar lista e inventarit paraprak me VKM nr. 275, datë 18.3.2009 “Për miratimin e Listës Paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësisë Administrative

³në të cilën përcaktohet se: “Nëpunësit zbatues të njëjësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.”

”Mollas” të Bashkisë Cërrrik. Lista e inventarit me 79 (shtatëdhjet e nëntë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 529 (pesqind e njëzetë e nëntë).

- Për **Njësinë Administrative Gostimë** është miratuar lista e inventarit paraprake të pronave të transferuara me VKM nr.298, datë 12.03.2008 “Për miratimin e Listës Paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësisë Administrative ”Gostim” të Bashkisë Cërrrik. Lista e inventarit me 146 (njëqind e dyzetë e gjashtë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 1034 (një mijë tridhjetë e katër). Nga dekontacioni i vënë në dispozicion rezulton se, me VKB nr. 298, datë 21.05.2018 është miratuar lista përfundimtare e inventarit të pronave publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrrik, të ndodhura në territorin e NJA Gostimë, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1000/1 prot., datë 06.06.2018.

- Për **Njësinë Administrative Klos** është miratuar lista e inventarit fillestar të pronave të transferuara me VKM nr. 238, datë 25.04.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore të Njësisë Administrative ”Klos” të Bashkisë Cërrrik”. Lista e inventarit ka 84 (tetëdhjetë e katër) fletë dhe përfundon me numrin rendor 569 (pesëqindë gjashtëdhjetë e nëntë) dhe ka 84 (tetëdhjetekatër) fletë.

Nga dekontacioni i vënë në dispozicion rezulton se, me VKB nr. 78, datë 26.10.20202 është miratuar e lista përfundimtare të inventarit të pronave publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrrik ,të ndodhura në territorin e NJA Klos, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 1260/1 prot., datë 2.11.2022.

- Në **Njësinë Administrative Shalës** është miratuar lista e inventarit paraprak me VKM nr. 1527, datë 19.16.2008 “Për miratimin e Listës Paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësisë Administrative ”Shalës” të Bashkisë Cërrrik”. Lista e inventarit me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 364 (treqindë e gjashtëdhjetë e katër). Për transferimin përfundimtar të pronave në NJA Shalës është ndjekur deri më sot kjo procedurë:

- Me VKB nr. 371, datë 21.12.2018 është miratuar i lista përfundimtare të inventarit të pronave publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrrik, të ndodhura në territorin e NJA Shalës, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 2267/1 prot., datë 03.11.2019.

- Me shkresën nr. 120, datë 15.01.2019 Bashkia Cërrrik i është drejtuar Mistrisë së Brendshme për miratimin listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrrik të shoqëruar me dosjen e plotë të pronave të ndodhura në NJA ”Shalës”, të përbërë nga Formularët për transferimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore dhe VKB nr. 371, datë 21.12.2018, ku lista e miratuar përbëhet me 55 prona.

- Me VKB nr. 21, datë 22.10.2019 është miratuar lista përfundimtare e inventarit të pronave publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrrik ,të ndodhura në territorin e NJA Shalës të Bashkisë Cërrrik” të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.1496/1 prot., datë 31.10.2019.

- Me shkresën nr.4013 prot., datë 31.10.2019 Bashkia Cërrrik i është drejtuar Mistrisë së Brendshme për miratimin e listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrrik, e përbërë nga 110 (njëqindëdhjetë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 266 (dyqindë e gjashtëdhjetë e gjashtë) prona, sipas lidhjes nr. 1.

- **Pyjet dhe Kullotat**, në bazë të **VKM nr. 433, datë 8.6.2016** “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në

administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, sipas shtojces nr. 14 bashkëlidhur këtij vendimi e cila përmban sipërfaqet pyjore dhe kullosore, sipas listës së inventarit, që transferohen në pronësi të Bashkisë Cërrik e cila përmban listën e inventarit që fillon me nr. rendor 1 (një) deri në 186 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë).

Nga dekumentacioni rezulton se nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave nuk ka kryer asnjë veprim për rregjistrimin në ZVRPP (ASHK) Elbasan në kundërshtim me nenet 5, 6 dhe 15 pika 2, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar dhe me Manualin e Mbarështrimit të Pyjeve.

- Asetet e rregjistruara si pronë e Bashkisë pranë ASHK-Drejtoria Vendore Elbasan

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, në total janë rregjistruar 72 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione, ku 65 prona i përkasin aktiveve të klasifikuara si AAGJM të evidentuara me vlerë në PF dhe 7 prona nga listat e transferuara, por të pa vlerësuara. Ne mënyrë të përmbledhur pronat e kaluara me VKM dhe të rregjistruara në ASHK paraqiten si me poshtë:

Nr	Bashkia/NJA	Nr.Pronave ne Inventar	Nr.i Praktikave te certifikuara deri Dhjetor 2022	Nr.i Praktikave te certifikuara deri Dhjetor 2023	Prona te pa rregjistruar
1	Bashkia/Cërrik	1979	38	7	1931
2	Njësia Mollas	529	16		513
3	Njësia Gostimë	1034	7		1027
4	Njësia Klos	569			569
5	Njësia Shalës	364	4		360
Shuma		4475	65	7	4400

Për 38 prona të transferuara është përgatitur dokumentacioni tekniko-ligjor dhe janë bërë aplikimet përkatëse për rregjistrim në ASHK, Drejtoria Elbasan. Këto të dhëna për pronat e në për proces hipotekimi paraqiten në Aneks bashkëlidhur RPA:

Nr	Nr. pasur	ZK	Sip e truallit M ²	Emertimi i Objektivit	Data e aplikimit	Sip e ndërteses M ²	Nr	Nr. pasur	ZK	Sip e truallit M ²	Emertimi i Objektivit	Data e aplikimit
1	1/157	1389	583	Kinemaja/qytetit(me+)	20/09/2017	472	20	4/68	1389	323	Ambulanca vjetër Lgj nr 2	16/05/2018
2	A-269	2449	6460	Njësia Shalës/Shkollë	9/10/2017	560	21	177/16	1820	875	Qëndër shëndetëso Gostim	20/06/2018
3	163/16	2449	2685	Qëndër shëndetësore	9/10/2017	305	22	A	3422	400	Shtërmën	20/06/2018
4	67/30	3856	1350	Shkollë	9/10/2017	320	23	A	2559	125	Malasej	20/06/2018
5	359/3	3862	1250	Shkollë	9/10/2017	319	24	300/5	1530	182500	Ndrysh emërt komun-Njës	20/02/2019
6	1/161	2281	5034	Tregu i vjetër	14/11/2017		25	183/23	1452	246226		20/02/2019
7	3/63	1389	787	Tregu i ri	14/11/2017		26	4/68	1389		Saktësi sip Ambulan vjetër	8/2/2019
8	26		16000	Varrezat publik qytetit	6/12/2017		27	4/73	1389	514	Shtëpia pionerit	27/03/2019
9	12/120	2441	7743	Zjarrfiksjia dhe sheshi	16/01/2018		28	6/18	2559	70	Zyrë/Bordë Kullimi	7/4/2019
10	12/122	2441	451	Truall	16/01/2018		29	6/17	2559	209	Truall midis ndërtesave	7/4/2019
11	12/124	2441	413	Truall	16/01/2018		30	A-(100a)	3856	196800	Ekonomi/Pyjore/Kullosore	16/04/2019
12	12/125	2441	1003.4	Rrugë vendore	16/01/2018		31	5/81	1389	414	Shkolla natës	8/5/2019
13	12/126	2441	860.54	Truall	16/01/2018		32	3/105	1389	280	NTI	16/6/2020
14	12/129	2441	521.07	Truall	16/01/2018		33	3/103	1389	585	NTI	16/6/2020
15	1/125	1389	200	Kopështi vjetër	15/02/2018	200	34	6/17,6/18	2559		Saktësim kufiri	9/11/2020
16	3/89	1389	2780	Shesh anësor i fushës	7/3/2018		35	220/7.50	3294	49.15	Ekonomi pyjo kodë EL6700001	17/12/2020
17	3/90	1389	9304	Fushë sporti	7/3/2018		36	46/1	3422	3154	Shkolla 9-vj Shtërmën	24/2/2022
18	3/91	1389		Ndërtes në fush sport	7/3/2018	212	37	46/2	3422	800	Obori shkollës Shtërmën	24/2/2022
19	12/123	1389	7224	Terren sportiv	7/3/2018		38		1389	433	Ambulanca re Lgj nr.2	24/2/2022

Referuar të dhënave të Sektori i Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Publike, rezulton se, janë 4475 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Cërrik (Qendër), listat përfundimtare të të cilave janë të miratuara me VKM-ët përkatëse, ndërsa për 2469 prona të 4 Njësive Administrative si **Mollas, Gostimë,**

Shalës janë në fazën e miratimit të listave paraprake dhe **Klos** në fazën fillestare. Nga këto prona janë hipotekuar 7 prona dhe janë në proces hipotekimi 38 prona të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë inventarizimi dhe përditësimi i të dhënave të këtyre pronave, pasi duhet që përmjet verifikimit në terren, dokumentacionit dhe korrespondencës zyrtare me institucionet përkatëse për statusin e tyre duhen identifikuar e propozuar e marrjen masave për ndjekjen e procedurave ligjore për të vepruar me ato prona që janë inekzistente fizikisht, të zaptuara, të kthyera pronarëve apo të privatizuara të cilat duhen identifikuar në listat e pronave. Sektori i Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Publike, në bazë të nenit 59/2 të Rregullores së Brendshme të miratuar me urdhrin e titullarit nr.50 me shkresën nr.prot.297, datë 27.01.2023 ka si objekt të veprimtarisë së saj inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave dhe regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, por kjo strukturë është miratuar me 2 punonjës, ku 1 përgjegjës dhe 1 specialist, Krahas kësaj strukture, që në fakt nuk ka kapacitete të plota për të kryer këtë proces Titullari i Bashkisë nuk ka nxjerrë asnjë urdher për ngritjen e grupeve të punës për verifikimin e gjendjes faktike të pronës në terren dhe matjen faktike të pasurisë, për kryerjen dhe verifikimin e gjendjes juridike të pronës nëpërmjet ASHK për informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, përpunim i të dhënave të hedhura në sistemin përkatës të secilës pasuri sipas ZK, plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për çdo pronë dhe dërgimi i dosjes përkatëse me listën e pronave shtetërore të përditësuar pranë DV-ASHK Elbasan.

Në mungesë të inventarizimit, përditësimit dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

Mos kryerja e procedurave për mos përditësimin e listave paraprake dhe fillestare të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM për 4 NJA **Mollas, Gostimë, Shalës** dhe **Klos**, më pas paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e të dhënave të listë-inventarëve të pronave, mos regjistrimi në ASHK në favor të Bashkisë i pjesës më të madhe të këtyre pronave të listuara, si dhe mosvlerësimi i tyre

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18,22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 ”Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z. A. S. në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Cërrik, z. Ç. Sh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyje-Kullotave dhe Kullimit e Mbrojtjes së Konsumatorit, z. H. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Pronave Publike dhe zj. M. Ll. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Publike.

2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

Realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB nr. 85, datë 29.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Cërrik për vitin 2022, me VKB nr. 9,8 datë 27.12.2022 “Per miratimin e buxhetit të Bashkisë Cërrik për vitin 2023.

Për vitin 2023.

Bashkia Cërrik ka zhvilluar gjithsej:

- “*Procedura prokurimi me vlera të larta*”, 1 procedurë, me vlerë të fondit limit 116,666,667 lekë pa Tvsh, vlerë të kontratës 116,055,624 lekë pa Tvsh, diferencë midis tyre prej 611,043 lekë pa Tvsh. Kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit gjithsej 1 (një) OE, janë skualifikuar 0 OE/BOE.

- “*Negocim me/pa shpallje*”, 0 procedura, me fondin limit në total prej 0 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 0 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumë prej 0 lekë pa Tvsh.

- “*E hapur e thjeshtuar*”, 2 procedura, me fondin limit në total prej 12,760,980 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 11,498,841 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumë prej 1,262,139 lekë pa Tvsh.

- “*Tender i Hapur*”, 5 procedura, me fondin limit në total prej 164,770,479.30 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej 141,765,023.90 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumë prej 23,005,455.40 lekë pa Tvsh.

Për vitin 2023: Bashkia Cërrik nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi me vlera të lartë.

- “*E hapur e thjeshtuar*”, 9 procedura, me fondin limit në total prej 52,833,500 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 48,964,984 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumë prej 3,868,516 lekë pa Tvsh.

- “*Tender i Hapur*”, 2 procedura, me fondin limit në total prej 166,379,443 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej 118,267,818.10 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumë prej 48,111,624.90 lekë pa Tvsh.

- “*Blerje me vlerë të vogël*”, 23 procedura, me fondin limit në total prej 20,863,049.77 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 17,120,019.67 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumë prej 3,743,030.1 lekë pa Tvsh;

Për vitin 2023

Nr.	Lloji i procedurës	Numri i procedurave të zhvilluara	Fondi limit pa tvsh	Vlera e kontratës pa tvsh	Diferenca
1	Procedura me vlera të larta	0	0	0	0
2	E hapur e thjeshtuar	9	52,833,500.00	48,964,984.00	3,868,516.00
3	Tender i Hapur	2	166,379,443	118,267,818.10	48,111,624.90
4	Blerje me vlerë të vogël	23	20,863,049.77	17,120,019.67	3,743,030
	Vlera totale	34	219,212,943	167,232,802.10	-51,980,140.9

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, Janë audituar procedura e prokurimit si më poshtë:

Nr.	Objekti	Fondi limit	OE/BOE fitues	Shënime
	Procedura që kanë filluar në fund të vitit 2022 me kontrata të lidhura në Dhjetor 2022 dhe në vitin 2023.			
1	Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej	49,833,666	BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk	Me shkelje
2	Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar	32,548,555.80	OE. “V. H.” Shpk	Me shkelje
3	Punime në shkollën 9 vjeçare “Vasil Belshi” Shtermen +Punime në konviktin e shkollës së mesme profesionale “Mihal Shahini” + punime hidroizolimi në kopështin e fëmijëve Mollas+Banesa për familjet në nevojë	5,260,980	OE “E.” Shpk	Me shkelje
4	Rikonstruksion rrugësh NjA Gostime	33,818,310	“A.” Shpk	Me shkelje
5	Ndërtim KUZ dhe rikonstruksion i rrugës së Rrasave e Kabashi në Shtermen	23,038,684.20	BOE “G.” Shpk & “V. K.” Shpk	Me shkelje
	Procedura që janë zhvilluar në vitin 2023			

6	Përmirësim i banesave egzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara	38,309,100	OE "Z." Shpk	Me shkelje
7	Sistemim varrezave të qytetit Cërrik	5,995,844	OE "M." Shpk	Me shkelje
8	Rikonstruksion i plotë i shkollës 9-vjeçare, ndërtim i ndërtesës së kopshtit të femijëve, palestrës, terreneve sportive fshati Selvijas, Njësia Administrative Klos	83,070,342.08	BOE "M." Sh.p.k & "Sh." Shpk	Me shkelje
		271,875,482.08		

1. Procedura e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej", Bashkia Cërrik.

1/ a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej", Bashkia Cërrik. REF-46676-10-19-2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 364, datë 09.09.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 363, datë 09.09.2022 Njësia e Prokurimit 1. D. L., Jurist 2. I. Ç., Ekonomist (Personi përgjegjës) 3. A. D., Inxhinier gjeoteknik	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 365., datë 09.09.2022 H. K., Kryetar R. J. Anetar M. Xh. Anetar
2. Lloji i Procedurës – "E hapur"		
5. Fondi Limit 49,833,666 (pa TVSh) lekë.	6. Oferta fituese 48,333,333 leke (pa Tvsh) BOE "M." Shpk & "Sh." Shpk	7. Diferenca me fondin limit 1,500,333 leke (pa Tvsh)
8. Data e hapjes së tenderit Datë 04.11.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkise	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S kualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime për DT; ska	12. Përgjigje Ankesës ska	13. Përgjigje Ankesës ska

Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Me Urdhërin e Prokurimit nr. 364 e nr. 2584 prot., datë 09.09.2022 është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D., bashkangjitur formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të interesit.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës me nr. 298/2 prot., datë 19.10.2022, botuar në Buletinin nr. 146 datë 24 tetor 2022 të APP, në faqen 25/479.

NJP më datë 18.10.2022 ka hartuar/nënshkruar "Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret për kualifikim", bashkangjitur DT.

- Më datë 26.01.2022, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep AK në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike të AK Bashkia Cërrik, rezulton se: për procedurën e me REF-46676-10-19-2022 me objekt: "Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Masej", me fond limit **48,833,666 lekë pa Tvsh**. Koordinimi i APP ka sygjëruar disa kriteret e DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 39 "Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike" dhe neni 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", konkretisht:

1. Në pikën 2.3.2. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: "OE ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë Licencën profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve objekt kontrate, e cila duhet të përmbajë së paku kategoritë e mëposhtëme:

N.P-5 A, Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

2. Në pikën 2.3.3. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 45 (dyzetë e pesë) punonjës të sigëruar, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për secilin muaj të kërkuar;

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

3. Në pikën 2.3.6. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

- 2 (dy) teknik ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 1 (një) teknik topograf, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 1 (një) teknik hidroteknik, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 2 (dy) muratorë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 2 (dy) Hidraulike, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 2 (dy) teknik ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 1 (një) teknik topograf, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 1 (një) teknik hidroteknik, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 2 (dy) muratorë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 2 (dy) Hidraulike, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 2 (dy) Hekurkthyes, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 2 (dy) Karpentier, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 2 (dy) punonjës për shtrim asfalti, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 3 (tre) manovratorë/eskavatoristë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

- 2 (dy) automakinistë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

- 1 (një) buldozerist, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

- 6 (gjashtë) shoferë për kamiona (kategoria C minimale), shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa

4. Në pikën 3.3.7. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike/ Në pronësi ose me qira	Ishte	Bëhet
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton	4	4
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton	2	2
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5-5ton	2	2
4	Kamioncine me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	2	2
5	Fadromë	1	1
6	Grejder me targa	2	2
7	Autobetoniere	2	2
8	Autopompë betoni	1	1
9	Asfaltoshtruese	1	1
10	Eskavator	3	3
11	Buldozer	1	1
12	Autobitumatriçe	1	1
13	Autobetoniere Kantieri 2.5m ³	1	1
14	Autobot uji	1	1
15	Rimorkiator	1	1
16	Fabrikë për prodhim asfalti/ ose kontratë furnizimi	1	1
17	Implant për prodhim betoni dhe inerte/ ose kontratë furnizimi	1	1
18	Rrul me peshë mbi 15 ton	2	2
19	Rrul me peshë mbi 10 ton	2	2

Referuar punimeve të përfshira në preventiv, rezulton se kërkesat për: **6 (gjashtë) kamio, 4 (katër) kamioçina, rul me vibrim; 1 (një) grejder;); 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë;** nuk janë të domosdoshëm për realizimin e kontratës.

Për sa trajtuar më sipër, kriteret: **2.3.3, 2.3.5, dhe 2.3.6,** nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

5. Në pikën 2.3.8. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të jetë i pajisur me leje/licencë të lëshuar nga QKL/QKB, Kodi III.2.B, lidhur me transportimin e mbetjeve që kanë ndikim në mjedis.

6. Në pikën 2.3.9. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE duhet të paraqesë kontratë furnizimi për tubo HDPE dhe PVC, plastike sipas preventivit. Kontrata e tubove të jetë e shoqëruar me: katalog, të dhënat teknike, makineritë e prodhimit të tubove, QKB, certifikata e cilësisë së provës. Furnizuesi të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga QKL KODI III.1.B (riciklim plastic), KODI III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), KODI III.2.B (përpunimi i plastikës).

7. Në pikën 2.3.10. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH ISO/IEC 17025:2017 “Kërkesa të përgjithshme për kopetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: znj. D. L., znj. I. Ç. dhe z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

Vlerësimi i procedurës së prokurimit:

Me Urdhërin e nr. 365 e nr. 2585 prot., datë 09.09.2022 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga: z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh..

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar procesverbalin e datës 04.11.2022 për paraqitjen e ofertave në SPE, ku është konstatuar se kanë shfaqur interes:

1. BOE “M.” Sh.p.k & “Sh.” Shpk (me Nipt-e respektive: **L.....C & K0.....N**) **me vlerë ekonomike të ofertës 48,333,333** (*dyzetë e tetëmilion e treqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre*) **lekë pa Tvsh.**

2. OE “L.” Shpk (me Nipt **L.....F**) **me vlerë ekonomike të ofertës 34.376.605** (*tridhjetë e kater milion e treqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pese*) **lekë pa Tvsh.**

Më datë 18.11.2022 KVO ka verifikuar dokumentacioni e OE/BOE të paraqitura në SPE, ku është konstatuar që: Dokumentacioni i paraqitur nga BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk janë në përputhje me kërkesat ligjore për kualifikim.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar **OE “L.” Shpk** për arsye se:

Më datë 18.11.2022, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar vendimin për klasifikimin përfundimtar të ofertave, dhe është dërguar kërkesa për paraqitjen e dokumentacioni provues si dhe dokumentat e tjera shoqëruese, siç parashikohet në DT.

Më datë 22.11.2022 KVO ka verifikuar fizikisht dokumentacioni e BOE të paraqitura në SPE, ku është konstatuar që: Dokumentacioni i paraqitur nga BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk janë në përputhje me kërkesat ligjore për kualifikim.

Me nr. 2982/1 prot., datë 23.11.2022 “Formulari i njoftimit të fituesit”, shpallur në Buletinin nr. 164 datë 30 Nëntor 2022 në faqet 189-192/590.

Në dosje e prokurimit gjendet Raporti Përmbledhës i datës 16.12.2022, bashkangjitur Vendimi me nr. extra protokollit për miratimin i Raportit Përmbledhës nga Titullari i AK (personi i autorizuar) z. T. Z., po më datë 20.12.2022.

Lidhja e kontratës: Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 203 prot., datë 19.01.2023, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Cërrrik, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor z. A. S. dhe Bashkimit e Operatorëve Ekonomikë “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, me përfaqësues respektiv administratorët z. E. B. e z. Y. B. me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Cërrrik dhe Malasej”, Bashkia Cërrrik, në përputhje me projektzbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **48,333,333** (*dyzetë e tetëmilion e treqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre*) **lekë pa Tvsh** (57,999,999.60 lekë me Tvsh).

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 212 prot., datë 06.01.2023, shpallur në Buletinin nr. 10 datë 30 janar 2023 të APP në faqen 387/519.

Lidhur me BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, nga auditimi rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Për sa trajtuar më sipër BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në

përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdorim më efektiv të fondit për vlerën **48,333,333 lekë pa Tvsh.**

Konkluzioni: Procedura e prokurimit paraqet parregullsi në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet vendosje e kriterëve jo në përputhjen me tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e OE në garë. Gjithashtu, parregullsi ka edhe në shpalljen fitues të BOE “M.” Sh.p.k & “Sh.” Shpk, pasi nuk plotësojnë të gjitha kriterëve e DT, veprime këto në kundërshtim të dispozitave ligjore të LPP. Në këtë rast KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdorim më efektiv të fondit me vlerë **48,333,333 lekë pa Tvsh.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. A. S. Kryetar i Bashkisë Cërrik në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, **z. T. Z.** (person i autorizuar) znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur : Komente mbi Projekt Raportin e Auditimit/observacionet me shkresën nr. 1138/1 prot., datë 20.05.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 190/4 prot., datë 23.05.2023, nga znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. anëtarë të Njësisë së Prokurimit, z. H. K., znj. R. J. dhe anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Sa i përket kësaj pike në procesverbal është bërë argumentimi gjithashtu ju informojmë se në preventivin fillestar (bashkëngjitur) ka zëra që i përkasin kësaj kategorie të licencës. Konsiderohet, Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve nbajtëse. Përfshin në mënyre të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

Zërat në të cilën përfshihen punimet janë: Sesioni 4 punime për mure rrethues, zëri 4 “Mure me blloqe betoni t=20 deri ne 3 m me llaç të përzier”, themel e xokol brutobetoni etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Grupi i auditimit i është referuar punimeve të përfshira në preventiv, rezulton se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorisë së mëposhtme, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008: N.P. 5. Ju nuk keni paraqitur asnjë zë punimi që të jetë për zbatimin e të cilit do duhej disponimi i kategorisë NP 5. Pasi zëra që ju përmendi “Mure me blloqe betoni t=20 deri ne 3 m me llaç të përzier” e “Themel e xokol brutobetoni” nuk përfshihen në “Punime nëntokësore, ura e vepra arti”.

Pretendimi i subjektit:

Sa i përket kësaj pike në procesverbal është bërë argumentimi gjithashtu ju informojmë se legjislacioni për prokurimet bashkëvepron dhe zbaton gjithashtu dhe detyrimet e përcaktuara në përgjithësi nga legjislacioni shqiptar psh në fushën e sigurimeve shoqërore, tatim taksave etj.

Llogaritja e fuqisë punërore është bërë në këtë mënyrë:

Orë e punët në total të llogaritur sipas zërave të preventivit është 42,217.43 orë pune total, afati i realizimit të punimeve 4 muaj.

42,217.43: 4 (muaj realizimi i punimeve) = 11,804;30 (ditë kalendarike) = 393.46 : OP = 49 punonjës.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në dosjen e prokurimit nuk gjendet asnjë dokumentacion ku pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës. Kërkesat për 49 (dyzetë e nëntë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, *eskavatoriste dhe shofere*, stafi teknik), nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët. Sa më sipër: nuk është argumentuar me grafikun e punimeve dhe volume sipas preventivit kërkesa për numrin e fuqisë punëtore që duhet për realizimin e objektit.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me pikën e mësipërme kërkesa për punonjës është kryer bazuar në nenin 39 pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e cila tregon se kërkesa për punonjës të kualifikuar është kriter që provon përshtatshmërinë për të kryer veprimtaritë profesionale dhe konsiderohet kriter i rëndësishëm për vërtëtimin se një OE mund ta realizojë kontratën me sukses. Për këtë arsye vendoset në kapacitetin teknik.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Është sqaruar që kërkesat për "Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në listëpagesat..." për 22 punonjës me diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, dhe për: 3 (tre) manovratorë/eskavatoristë; 2 (dy) automakinistë; 1 (një) buldozerist "dhe 6 (gjashtë) shoferë" me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik lëshuar nga ISHTI, nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët.

Pretendimi i subjektit:

Sa i përket kesaj pike në procesverbal është bërë argumentimi gjithashtu ju informojmë se legjislacioni për prokurimet bashkevepron dhe zbaton gjithashtu dhe detyrimet e përcaktuara në përgjithësi nga legjislacioni shqiptar psh ne fushen e sigurimeve shaqërore, tatim taksave etj. Në rastin konkret OE janë të detyruar të zbatojnë legjislacionin që rregullon menaxhimin e mbetjeve (në këtë rast ndërtime) duke patur parasysh se në preventivin fillestar parashikohen zëra prishjeje e transport i tyre. Kështu në bazë të ligjit 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar si dhe VKM nr. 538 datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuara, Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme". Në Vendimin nr. 99, datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" shtojca I, përfshirë vetëm mbetjet jo të rrezikshme 1/05 04 [Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03. 17 09 04 Mbetje të përziera nga ndërtimet dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 1 / 09 01, 1 / 09 02 dhe 1 / 09 03.

Po këtu, në pikën "e" parashikohet se mbetjet jo të rrezikshme të grumbullohen, transportohen dhe transferohen në bazë të rregullave të VKM nr. 229, datë 23.4.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Subjektet që kryejnë aktivitet (në rastin konkret rikonstruksion rrugësh), klasifikohen në subjekt që **gjeneron mbetje urbane** në NJQV ku zhvillojnë aktivitet. OE që ushtron veprimtari në një territor të caktuar, regjistrohet me NIPT-it sekondar (për OE që nuk kanë seli në NJA), nënkupton që subjekti paguan taksat dhe tarifën vendore (si taksë pastrimi, gjelbërimi, tabelle etj, sipas ligjit dhe VKB përkatës).

Referuar VKM nr. 538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", në aneksin 1,

Kategoria III, Licensimi i vepritarive të nënkategorive të nënkategorisë III.2.B, në pikën 9. Citohet: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”. Çdo operator/familje/individ që gjeneron mbetje urbane është i detyruar të depozitojë në pikat e grumbullit/kontenier dhe jo ti trajtojë këto mbetje. Referuar objektit të prokuruar, transporti i materialeve gjatë realizimit të punimeve, mjeteve të transportit të inerteve u nevojitet vetëm: lejen e qarkullimit, certifikatat e pronësisë siguracionin, kolaudimin, certifikatë transporti.

Pretendimi i subjektit:

Kjo kërkesë është bërë në përputhje me pikën 1, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” - Autoritetet se entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomike bazuar në: a) përshtatshërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objekti Përsa më lartë kërkojmë rishikimin e pikave të mësipërme sa i përket Njësisë së Prokurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Kriteri për disponimin me leje mjedisore lëshuar nga QKL Kodi III.1.B (riciklim plastic), Kodi III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), Kodi III.2.B (përpunimi i plastikës), sjellë kufizim të panevojshëm, pasi mjafton kontrata dhe të dhënat teknike të produkteve, gjithashtu kërkesa i referohet palëve të treta që nuk janë pjesëmarrës në prokurim. Nga ana juaj nuk justifikohet teknikisht/ligjërish lidhja midis realizimit të punimeve (për rikonstrukcionin e rrugëve) me kërkesat e sipërcituara.

Pretendimi i subjektit:

Kjo kërkesë është bërë në përputhje me pikën 1, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” - Autoritetet se entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për OE bazuar në: a) përshtatshërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,- Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objekti. Përsa më lartë kërkojmë rishikimin e pikave të mësipërme sa i përket Njësisë së Prokurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me kriterin për paraqitjen e kontratës me një laborator testimi të betonit, nuk është i detyrueshëm para realizimit të punimeve. Mostrimi dhe prova laboratorike e betoneve strukturore për objektet sanksionohet në VKM nr. 679, datë 22.10.2004 “Për miratimin e rregullave teknike për përdorimin e betoneve strukturore”, kjo kërkesë dhe ky dokumentacion duhet të paraqitet nga OE përgjatë fazës së zbatimit të kontratës, për të vërtetuar që artikujt apo mallrat e përdorur janë në përputhje sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. **Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.**

Pretendimi i subjektit:

Sa i përket kësaj pike ju informojmë se OE “Sh.” Shpk ka paraqitur vërtetim të taksave vendore për: Bashkia Fier, Kamëz, Bashkia Cërrik, Bashkia Tiranë, Bashkia Ura Vajgurore, Bashkia Prrenjas, Bashkia Puke, Bashkia Poliçan për rastet e mosregjistrimit në QKB kontratat e deklaruara mund të kenë qënë në nisje të tyre dhe procedurat e regjistrimit mund të jenë në proces.

• OE “M.” Shpk ka paraqitur vërtetime të taksave vendore për: Bashkia Gramsh, Bashkia Cërrik për rastet e mosregjistrimit në QKB kontratat e deklaruara mund të kenë qënë në nisje të tyre dhe procedurat e regjistrimit mund të jenë në proces.

Përsa më lart ju informojmë se KVO ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga OE në bazë të kontratave përkatëse ku konstatohen dhe emërtimet përkatëse.

Përsa më lartë kërkojmë rishikimin e pikave të mësipërme sa i përket KVO.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Grupi i auditimit ka konstaur që BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk nuk përmbushin të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT (në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore; staf mbështetës të kualifikuar) dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO. **Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.**

2. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i rrugës fshati Dasar”, Bashkia Cërrrik.

2/a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i rrugës fshati Dasar”, Nr. REF-52909-12-12-2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 370, datë 09.09.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 369., datë 09.09.2022 Njësia e Prokurimit 1. D. L., Jurist 2. I. Ç., Ekonomist (Personi përgjegjës) 3. A. D., Inxhinier gjeoteknik	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.371, datë 09.09.2022 H. K., Kryetar R. J. Anetar M. Xh. Anetar
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”		
5. Fondi Limit 32,548,555.8 (pa Tvsh) lekë.	6. Oferta fituese 32,527,340 leke (pa Tvsh) OE. “V. H.” Shpk	7. Diferenca me fondin limit 21,215,80 (pa Tvsh)
8. Data e hapjes së tenderit Datë 28.12.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime për DT; ska	12. Përgjigje Ankesës ska	13. Përgjigje Ankesës ska

Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë Cërrrik me financim 3 vjeçar miratuar me VKB nr. 62, datë 22.08.2022 “Për miratimin e listës së projekteve të treguara për vitin 2022-2024”. Në zbatim të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore” pika 2 në të cilin ky objekt është pjesë e projekteve që janë pjesë e buxhetit 3 vjeçar të miratuar nga njësia e qeverisjes vendore.

Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Me Urdhërin nr. 369 e nr. 2589 prot., datë 09.09.2022 është ngritur komisioni i përllogaritjes së fondit limit i përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D..

Me Urdhërin e Prokurimit nr. 370 e nr. 2590 prot., datë 09.09.2022 është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D., bashkangjitur formularët e deklaramentit të mospasjes së konfliktit të interesit. Afati i realizimit të punimeve 90 ditë.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës me nr. 2591/1 prot., datë 12.12.2022, botuar në Buletinin nr. 173 datë 19 dhjetor 2023 të APP, faqet 19--20/750.

NJP më datë 12.12.2022 ka hartuar/nënshkruar “Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret për kualifikim”, Bashkangjitur DT.

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

1. Në pikën 3.3.4. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **45 punonjës**. Të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimum për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- *Vërtetim të lëshuar Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.*

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

2. Në pikën 3.3.6. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- **1 (një)** punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

3. Në pikën 3.3.7. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) drejtues të makinerive të rënda manovrator dhe 7 (shtatë) shoferë, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dëshmi e aftësisë profesionale përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listpagesën e shoqërisë minimumi për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave.

4. Në pikën 3.3.9. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: 2.3.9. OE duhet të paraqesin çertifikatat dhe licensat si me poshte:

ISO 14001:2015 (Sistemet e menaxhimit mjedisor) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga RSH.

5. Në pikën 3.3.10. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të jetë i pajisur Licencë për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme që kanë ndikim në mjedis, kodi III.2.B, të lëshuara nga QKL.

6. Në pikën 3.3.6. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: 2.3.11. OE ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion OE që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 8) konkretisht:

Nr	Lloji i Makinerive/ Në pronësi ose me qira	Statusi	Sasia
1	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	1
	Eskavator me zinxhire	në pronësi ose me qira	2
2	Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës mbi 18 ton	në pronësi ose me qira	2
3	Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës 10-18 ton	në pronësi ose me qira	1
4	Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës 5 - 10 ton	në pronësi ose me qira	2
5	Kamioncine deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qira	2
6	Grejder	në pronësi ose me qira	1
7	Rrul 4-9 ton	në pronësi ose me qira	1
8	Rrul 10-15 ton	në pronësi ose me qira	1
9	Rrul mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	1
10	Fadrome me goma	në pronësi ose me qira	1
11	Autobot uji	në pronësi ose me qira	1
12	Buldozer	në pronësi ose me qira	1
13	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	1
14	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	1
15	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	1
16	Autopompe	në pronësi ose me qira	1
17	Betoniere	në pronësi ose me qira	2
18	Vibrator thellesie	në pronësi ose me qira	2
19	Minieskavator	në pronësi ose me qira	1
20	Minifadrome	në pronësi ose me qira	1
21	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	1
22	Deflektometer per matjen e ngjeshjes se shtresave te rruges	në pronësi ose me qira	1
23	Fabrike betoni/ ose kontrate furnizimi	ose kontratë furnizimi	1
24	Fabrike prodhimi tubosh betoni/ ose kontrate furnizimi	ose kontratë furnizimi	1
25	Fabrike asfalti(jo me larg se 40Km)/ ose kontrate furnizimi	ose kontratë furnizimi	1
26	Nyje inerte/ ose kontrate furnizimi	ose kontratë furnizimi	1

Për sa trajtuar më sipër, kriteret: **2.3.4, 2.3.5, dhe 2.3.7**, nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjrisht për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtoare dhe mjeteve/makinerive të punës.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: znj. D. L., znj. I. Ç. dhe z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

- **Vlerësimi i procedurës së prokurimit:**

Me Urdhërin e nr. 371 e nr. 2591 prot., datë 09.09.2022 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga: z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh..

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar procesverbalin e datës 28.12.2022 për paraqitjen e ofertave në SPE, ku është konstatuar se kanë shfaqur interes:

1. OE “V. H.” Shpk (me Nipt K12911201C) me vlerë ekonomike të ofertës 32,527,340 (tridhjetë e dy milion e pesëqind e njëzetë e shtatë mijë e treqind e dyzetë) lekë pa Tvsh.

Më datë 11.01.2023 KVO ka verifikuar dokumentacionin e OE të paraqitura në SPE, ku është konstatuar që: Dokumentacioni i paraqitur nga OE “V. H.” Shpk janë në përputhje me kërkesat ligjore për kualifikim.

Më datë 11.01.2023, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar vendimin për klasifikimin përfundimtar të ofertave, dhe është dërguar kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit provues si dhe dokumentat e tjera shoqëruese, siç parashikohet në DT.

Në dosje e prokurimit gjendet Raporti Përmbledhës i datës 24.01.2023, bashkangjitur Vendimi për miratimin i Raportit Përmbledhës nga Titullari i AK, po më datë 04.09.2023 (me nr. extra prot.).

Me nr. 353 prot., datë 16.01.2023 “Formulari i njoftimit të fituesit”, shpallur në Buletinin nr. 7 datë 23 janar 2023 në faqen 92/409.

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 354 prot., datë 03.02.2023, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Cërrik, të përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. A. S. dhe Operatorit Ekonomik “V. H.” Shpk, me përfaqësues administratorin: z. B. H. me objekt: “Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar”, Bashkia Cërrik, në përputhje me projektzbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **32,527,340 (tridhjetë e dy milion e pesëqind e njëzetë e shtatë mijë e treqind e dyzetë) lekë pa Tvsh (39,032,808 lekë me Tvsh).**

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 355 prot., datë 03.02.2023, shpallur në Buletinin nr. 14 datë 13 shkurt 2023 të APP në faqen 477/603.

Lidhur me OE “V. H.” Shpk, nga auditimi rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE “V. H.” Shpk, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Për sa trajtuar më sipër OE “V. H.” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues OE “V. H.” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE “V. H.” Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “V. H.” Shpk, Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285,

datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

Konkluzioni: Procedura e prokurimit paraqet parregullsi në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet vendosje e kriterëve jo në përputhjen me tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e OE në garë. Gjithashtu, parregullsi ka edhe në shpalljen fitues të OE “V. H.” Shpk, pasi nuk plotëson të gjitha kriterëve e DT, veprime këto në kundërshtim të dispozitave ligjore të LPP. Në këtë rast KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdorim më efektiv të fondit me vlerë **32,527,340** lekë pa Tvsh.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. S. Kryetar i Bashkisë Cërrik në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, z. T. Z. Person i Autorizuar, znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur : Komente mbi Projekt Raportin e Auditimit/observacionet me shkresën nr. 1138/1 prot., datë 20.05.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 190/4 prot., datë 23.05.2023, nga znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. anëtarë të Njësisë së Prokurimit, z. H. K., znj. R. J. dhe anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Vendosja e kriterit për numrin e punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po ti referohemi projektit, preventivit. relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në dosjen e prokurimit nuk gjendet asnjë dokumentacion ku pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës. Kërkesat për 45 (dyzetë e pesë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, *eskavatoriste dhe shofere*, stafi teknik), nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët. Sa më sipër: nuk është argumentuar me grafikun e punimeve dhe volume sipas preventivit kërkesa për numrin e fuqisë punëtore që duhet për realizimin e objektit.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me pikën e mësipërme: Kjo pikë është e argumentuar në procesverbal dhe kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Duke qenë se nga ana e AK është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me certifikatën ISO 45001 (Standard për menaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë/ekuivalente dhe e vlefshme), konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi certifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen me këtë certifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet certifikuese ndaj dhe kjo certifikatë i jep garanci AK lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon OE për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me pikën 3: Kjo pikë është e argumentuar në procesverbal se: Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (e cilat do publikohet së bashku me DT) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. AK domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga ISHT. Gjithashtu kërkesa për punonjës është kryer bazuar në nenin 39 pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e cila tregon se numri punonjësve është kriter që provon përshtatshmërinë për të kryer veprimtarit profesionale. dhe konsiderohet kriter i rëndësishëm për vërtetimin se një OE mund të realizojë kontratën me sukses. Për këtë arsye vendoset në kapacitetin teknik.

Sa më lart sipas punimeve pjesë e preventivit fillestar janë përcaktuar dhe personeli i kualifikuar si më poshtë:

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Kërkesat për manovratorë/eskavatoristë; shoferë, nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion me qera së bashku me manovratorët/shoferët.

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me pikën e mësipërme ju informojmë se kërkesat e mësipërme janë vendosur në zbatimte pikës 14 gërma “a” –“c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mand t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizma kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor. për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Grupi i auditimit i është referuar certifikatës ISO 14001:2015 (Sistemet e menaxhimit mjedisor) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga RSH, pasi efektet direkte indirekte të një projekti janë të ezauruar në fazën e realizimit të VNM. Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: *Sa i përket kesaj pike në procesverbal është bërë argumentimi gjithashtu ju informojmë se legjislacioni për prokurimet bashkevepron dhe zbaton gjithashtu dhe detyrimet e*

përcaktuara në përgjithësi nga legjislacioni shqiptar psh në fushën e sigurimeve shaqerore, tatim taksave etj. Në rastin konkret OE janë të detyruar të zbatojnë legjislacionin që rregullon menaxhimin e mbetjeve (në këtë rast ndërtime) duke patur parasysh se në preventivin fillestar parashikohen zëra prishjeje e transport i tyre. Kështu në bazë të ligjit 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar si dhe VKM nr. 538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuara, Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”. Në Vendimin nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” shtojca I, përfshirë vetëm mbetjet jo të rrezikshme 1/05 04 [Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03. 17 09 04 Mbetje të përziera nga ndërtimet dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 1 / 09 01, 1 / 09 02 dhe 1 / 09 03.

Po këtu, në pikën “e” parashikohet se mbetjet jo të rrezikshme të grumbullohen, transportohen dhe transferohen në bazë të rregullave të VKM nr. 229, datë 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Subjektet që kryejnë aktivitet (në rastin konkret rikonstruksion rrugësh), klasifikohen në subjekt që **gjeneron mbetje urbane** në NJQV ku zhvillojnë aktivitet. OE që ushtron veprimtari në një territor të caktuar, regjistrohet me NIPT-it sekondar (për OE që nuk kanë seli në NJA), nënkupton që subjekti paguan taksat dhe tarifën vendore (si taksë pastrimi, gjelbërimi, tabele etj, sipas ligjit dhe VKB përkatës).

Referuar VKM nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, në aneksin 1, Kategoria III, Licensimi i veprimtarive të nënkategorive të nënkategorisë III.2.B, në pikën 9. Citohet: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”. Çdo operator/familje/individ që gjeneron mbetje urbane është i detyruar të depozitojë në pikat e grumbullit/kontenier dhe jo të trajtojë këto mbetje. Referuar objektit të prokuruar, transporti i materialeve gjatë realizimit të punimeve, mjeteve u nevojitet vetëm: lejen e qarkullimit, certifikatat e pronësisë siguracionin, kolaudimin, certifikatë transporti.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën e mësipërme është argumentuar se këkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe Nenit 39, pika 6, gërma “d” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtyre kërkesave, OE duhet të dëshmojë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga projektuesi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtime sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26. 10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të rënda. Dokumentacioni shoqëues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci AK se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me DT).

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Grupi i auditimit ka analizuar kriteret: **2.3.4, 2.3.5, dhe 2.3.7, dhe ka konstatuar që** nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht për asrye se: në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesioneve/specialistët dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtorë dhe mjeteve/makinerive të punës.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën e mësipërme për plotësimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar ju informojmë se bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehemisht thuhet se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP, dhe në këto rregulla OE ka ngarkuar në system formularin vetpërmbledhës të vetdeklarimit ku në të shprehet se OE ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe kontributëve. Sa i përket kontratave të deklaruara mund të kenë qënë në nisje të tyre dhe procedurat e regjistrimit mund të jenë në proces.

Përsa më lartë kërkojmë rishikimin e pikave të mësipërme sa i përket komisionit të vlerësimit të ofertave.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Është konstatuar që: OE “V. H.” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT (nuk ka shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 dhe kështu e maturuara për vitin 2022) dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. **Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.**

3. Procedura e prokurimit me objekt: “Punime në shkollën 9 vjeçare “Vasil Belshi” Shtermen +Punime në konviktin e shkollës së mesme profesionale “Mihal Shahini” + punime hidroizolimi në kopështin e fëmijëve Mollas+Banesa për familjet në nevojë”, Bashkia Cërrik.

3/a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Punime në shkollën 9 vjeçare “Vasil Belshi” Shtermen +Punime në konviktin e shkollës së mesme profesionale “Mihal Shahini” +punime hidroizolimi në kopështin e fëmijëve Mollas+Banesa për familjet në nevojë”, Bashkia Cërrik. REF- 49073-11-08-2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 417 datë 03.10.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr., 416 datë 03.10.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.,418 datë 03.10.2022
2. Lloji i Procedurës – “E hapur e thjeshtuar”	Njësia e Prokurimit 1. D. L., Jurist 2. I. Ç., Ekonomist (Personi përgjegjës) 3. A. D. , Inxhinier	H. K., Kryetar R. J. M. Xh.
5. Fondi Limit (pa Tvsh) Lekë 5,260,980	6. Oferta fituese (pa Tvsh) 5,250,841 Leke OE “E.” Shpk	7. Diferenca me fondin limit 10,139 leke (pa Tvsh)
8. Data e hapjes së tenderit Datë: 21.11.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkise	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender : 1 OE b) S’kualifikuar : 0 c) Kualifikuar : 1 OE
11. Ankimime për DT; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës

Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Me Urdhërin nr. 416 e nr. 2807 prot., datë 03.10.2022 është ngritur komisioni i përllogaritjes së fondit limit i përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. dhe ka formuluar nënshkruar procesverbalin e përllogaritjes së vlerësimit të kontratës.

Me Urdhërin e Prokurimit nr. 417 e nr. 2808 prot., datë 03.10.2022 është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D., bashkangjitur formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të interesit.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës me nr. 2809/1 prot., datë 08.11.2022, botuar në Buletinin nr. 156 datë 14 nëntor 2023 të APP, faqen 68/533.

NJP më datë 08.11.2022 ka hartuar/nënshkruar “Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret për kualifikim”, Bashkangjitur DT.

Në hartimin e kriterëve për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Punime në shkollën 9 vjeçare “Vasil Belshi” Shtermen +Punime në konviktin e shkollës së mesme profesionale “Mihal Shahini” + punime hidroizolimi në kopështin e fëmijëve Mollas+Banesa për familjet në nevojë”, Bashkia Cërrik, janë konstatuar kriteret jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e saj.

1. Në pikën 2.3.3. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 30 (tridhjetë) punonjës të siguruar, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për secilin muaj të kërkuar;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga OE i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Në pikën 2.3.4. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si mëposhtë:

- 1 (një) inxhinier mekanik

3. Në pikën 2.3.5. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: 2.3.5. OE ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

- 1 Punonjës me dëshmi trajnimi si “Specialist për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Kontratë noteriale të punës si dhe certifikatë trajnimi “Për përgjegjësinë për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.

- 2 (dy) Specialiste të certifikuar për punime në lartësi. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune noteriale, si dhe dokumentin e perkates të certifikimit

- 2 Teknike hidroizolues shoqëruar me diplomë/deftesë, kontratë pune noteriale dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI

- 2 Teknike mekanik shoqëruar me diplome/deftesë, kontratë pune noteriale dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI,

- 2 Teknik ndërtimi shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe diplomë/deftesë.

- 3 (tre) hekurkthyes shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikatë dëshmie përkatëse të kualifikimit profesional (dëshmi profesionale)

- 3 (tre) karpentiere shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikatë dëshmie përkatëse të kualifikimit profesional (dëshmi profesionale)

- 2 (dy) hidraulike shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikatë dëshmie përkatëse të kualifikimit profesional (dëshmi profesionale)

- 3 (tre) bojaxhi shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikatë dëshmie përkatëse të kualifikimit profesional (dëshmi profesionale)

-1 (nje) elektrikist shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikatë dëshmie përkatëse të kualifikimit profesional (dëshmi profesionale).

4. Në pikën 2.3.6. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min.10 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamionçinë 3-5 ton	3 copë	Në pronësi ose me qera
3	Eskavatore	3 cope	Në pronësi ose me qera
4	Autopome betoni	2 cope	Në pronësi ose me qera
5	Pompë suvatimi	3 copë	Në pronësi ose me qera
6	Gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Depozitë uji 3.000-5.000 litra	2 copë	Në pronësi ose me qera
8	Autovinç	2 copë	Në pronësi ose me qera
9	Skela dhe rrjetë mbrojtëse	500m2	Në pronësi ose me qera

10	Vibrator	2 copë	Në pronësi ose me qera
11	Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
12	Betoniere kantieri 1.5-3 m ³	2 copë	Në pronësi ose me qera
13	Vinç karele	1 copë	Në pronësi ose me qera
14	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
15	Nivelues betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
16	Minieskavator	1 copë	Në pronësi ose me qera

Për sa trajtuar më sipër, kriteret: **2.3.3, 2.3.4, dhe 2.3.5, (referuar dhe afatit të realizimit të punimeve 35 ditë)** nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtoare dhe mjeteve/makinerive të punës.

5. Në pikën 2.3.7. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë MTI, RSH, sic percaktohet ne *Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM nr.42, datë 16.01.2008.*

- Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001** (e vlefshme).

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: znj. D. L., znj. I. Ç. dhe z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

Vlerësimi i procedurës së prokurimit:

Me Urdhërin e nr. 418 e nr. 2809 prot., datë 03.10.2022 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga: z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh..

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar procesverbalin e datës 21.11.2022 për paraqitjen e ofertave në SPE, ku është konstatuar se kanë shfaqur interes:

1. OE “E.” Shpk (me Nipt K02277229P) me vlerë ekonomike të ofertës 5,250,841 (pesë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e dyzetë e një) lekë pa Tvsh.

Më datë 23.11.2022 KVO ka verifikuar dokumentacioni e OE të paraqitura në SPE, ku është konstatuar që: Dokumentacioni i paraqitur nga OE “E.” Shpk janë në përputhje me kërkesat ligjore për kualifikim.

Më datë 11.01.2023, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar vendimin për klasifikimin përfundimtar të ofertave, dhe është dërguar kërkesa për paraqitjen e dokumentacioni provues si dhe dokumentat e tjera shoqëruese, siç parashikohet në DT.

Në dosje e prokurimit gjendet Raporti Përmbledhës i datës 09.12.2022, bashkangjitur Vendimi për miratimin i Raportit Përmbledhës nga Titullari i AK, po më datë 09.12.2022 (pa nr. prot.). Me nr. 2809/2 prot., datë 25.11.2023 “Formulari i njoftimit të fituesit”, shpallur në Buletinin nr. 167 datë 05 dhjetor 2022 në faqet 90-91/385.

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 3502 prot., datë 16.12.2022, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Cërrik, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor z. A. S. dhe Operatorit Ekonomik “E.” Shpk, me përfaqësues administratorin: z. E. B. me objekt: “Punime në shkollën 9 vjeçare “Vasil Belshi” Shtermen +Punime në konviktin e shkollës së mesme profesionale “Mihal Shahini” + punime hidroizolimi në kopështin e fëmijëve Mollas+Banesa për familjet në nevojë”, Bashkia Cërrik, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **5,250,841 (pesë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e dyzetë e një) lekë pa Tvsh.** (6,301,009.20 lekë me Tvsh).

Nga auditimi i dokumentacionit të OE "E." Shpk, të shpallur fitues janë konstatuar mangësi në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në kriteret e veçanta për kualifikim si më poshtë:

Nga auditimi i dokumentacionit të OE "E." Shpk, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Për sa trajtuar më sipër OE "E." Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues OE "E." Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE "E." Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE "E." Shpk, Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 3, "Parimet të përgjithshme", neni 98 "Anulimi i një procedure prokurimi" si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" pika 2, neni 67 "Klasifikimi i ofertave" pika 2, neni 83 "Njoftimi i fituesit".

Konkluzioni: Procedura e prokurimit paraqet parregullsi në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet vendosje e kriterëve jo në përputhjen me tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e OE në garë. Gjithashtu, parregullsi ka edhe në shpalljen fitues të OE "E." Shpk, pasi nuk plotëson të gjitha kriterëve e DT, veprime këto në kundërshtim të dispozitave ligjore të LPP. Në këtë rast KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdorim më efektiv të fondit me vlerë **5,250,841 lekë** pa Tvsh.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. A. S. Kryetar i Bashkisë Cërrik në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, **z. T. Z.** (person i autorizuar) znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur : Komente mbi Projekt Raportin e Auditimit/observacionet me shkresën nr. 1138/1 prot., datë 20.05.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 190/4 prot., datë 23.05.2023, nga znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. anëtarë të Njësisë së Prokurimit, z. H. K., znj. R. J. dhe anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me pikën e mësipërme është bërë argumentini se në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion, OE për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës dhe gjithashtu kërkesa për punonjës është kryer bazuar në nenin 39 pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e cila tregon se numri i punonjësve është kriter që provon përshtatshmërinë për të kryer veprimtaritë*

profesionale. kërkesa për 30 (tridhjetë) punonjës është argumentuar në procesverbalin e argumentimit dhe në këtë numër përfshihen dhe inxhinierët e stafi teknik.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në dosjen e prokurimit nuk gjendet asnjë dokumentacion ku pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrimin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.:Kërkesat për 30 (tridhjetë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, *eskavatoriste dhe shofere*, stafi teknik), nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët. Sa më sipër: nuk është argumentuar me grafikun e punimeve dhe volume sipas preventivit kërkesa për numrin e fuqisë punëtore që duhet për realizimin e objektit.

Pretendimi i subjektit: *Kërkohet inxhinieri mekanik, pasi referuar projektin dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen punime të strukturave metalike nëpër strehat e objektit. E kemi kërkuar këtë inxhinier për arsye se mund të ketë problematika gjatë zbatimit të punimeve dhe mund të ketë ndryshime dhe rregullime të cilave mund ti përgjigjet gjatë zbatimit inxhinieri përkatës. Si dhe është e domosdoshme asistenca e inxhinierit për çdo defekt të mundshëm të mjeteve që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Pretendimi juaj nuk qëndron ligjërisht dhe teknikisht, pasi nuk ka asnjë analizë çmimi për zërat e punimeve që përfshihen në preventive, ku të përfshihet nevoja për inxhinier mekanik. Në lidhje me mirëmbajtjen e mjeteve nuk është çështje e AK por e OE që realizon punimet.

Ju nuk keni sjellë asnjë arsyetim tekniko ligjor ku të kundërshtojë gjetjen e grupit të auditimit në lidhje me kërkesën për 1 (një) inxhinier mekanik dhe 1 (një) inxhinier gjeodet/topograf.

Pretendimi i subjektit: *Për sa më sipër: Është bërë argumentimi në procesverbalin e miratimit në lidhje me punonjësit gjithashtu kërkesa për punonjës është kryer bazuar në nenin 39 pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e cila tregon se numri i punonjësve është kriter që provon përshtatshmërinë për të kryer veprimtarite profesionale. Punonjësit e mëposhtëm janë të domosdoshëm për:*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Kërkesat për 21 punonjës me diplomë/dëshmi kontratë pune noteriale dhe me dëshmi kualifikimi me certifikata ose dëshmi përkatëse, nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët. Referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij **Kodi përcaktohet që:** “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar...”, në asnjë paragraf të bazës ligjore të sipërcituar nuk kërkohet: “kontratat noteriale”.

Pretendimi i subjektit: *Për sa më sipër kërkesa për mjete është kryer bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion OE për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar lloin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës.*

Sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga projektuesi. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të renda. Analiza për mjetet është bashkëngjitur të punonjësit,

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Grupi i auditimit ka analizuar kriteret: 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, dhe 2.3.6 e është konstatuar që: nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën 5 kërkesat e mësipërme janë vendosur në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39 pika 6 Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose. neni 44 pika 1 Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetua se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit nga organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga RSH, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Ju rikujtojmë që Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) realizohet para fillimit të procedurës së prokurimit dhe është pjesë integrale e projektit të objektit. Vlerësimi i një vepre publike ose me interes publik, do të thotë edhe gjykimi i vlerës së saj në perspektivën e interesit kolektiv. Pra një objekt nuk prokurohet pa u zgjidhur problematikën e ndikimit në mjedis.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën e mësipërme për plotësimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar ju informojmë se bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimisht thuhet se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje, ose të afertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP, dhe nga këto rregulla OE ka ngarkuar në sistem formularin vetëpërmbledhës të vetëdeklarimit ku në të shprehet se OE ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe kontributeve. Sa i përket kontratave të deklaruar mund të kenë qenë në nisje të tyre dhe procedurat e regjistrimit mund të jenë në proces. KVO ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga OE në bazë të kontratave përkatëse ku konstatohen dhe emërtimet përkatëse.

Përsa më lartë kërkojmë rishikimin e pikave të mësipërme sa i përket KVO.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Grupi i auditimit ka konstautuar që OE “E.” Shpk, nuk përmbushin të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO. **Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.**

4. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Njësinë Administrative Gostime”, Bashkia Cërrik.

6/a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në NJA Gostime”, Bashkia Cërrik. Nr. REF-49595-11-11-2022		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 376, datë 09.09.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 375 datë 09.09.2022 Njësia e Prokurimit 1. D. L., Jurist 2. I. Ç., Ekonomist (Personi përgjegjës) 3. A. D., Inxhinier gjeoteknik	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.,377 datë 09.09.2022 H. K., Kryetar R. J. M. Xh.
2. Lloji i Procedurës – “E hapur”		
5. Fondi Limit (pa Tvsh) 33,818,310 lekë.	6. Oferta fituese (pa Tvsh): 33,668,309.9 Lekë	7. Diferenca me fondin limit 150000.1 leke (pa TVSh)
8. Data e hapjes së tenderit Datë: 07.12.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkise me financim tre vjecar	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender : 1 OE b) S’kualifikuar: 0 OE, c) Kualifikuar: 1 OE
11. Ankimime për DT; JO	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës

Projektuar nga OE “Z.” Shpk, me **Licencë N.6811/1, grup projektimi:** Ing. F. D.; nxh. Ndërtimi L. H., realizuar në vitin 2022.

Ark. H. B. Ark. S. B.; Konstruktorë Ing. V. L.; Ing Hidro. A. Sh. & A. D.; Ngrohje Ventilim Ing. A. Sh. & Ing. A. D.; Ing. Elektrik A. K.; Ing. MKZ Ing. A. Sh. & Ing. A. D. në Prill të vitit 2018.

Me Urdhërin e nr. 375 e nr. 2595 prot., datë 09.09.2022 është ngritur komisioni i përlogaritjes së fondit limiti përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D..

Më datë 11.11.2022, është formular/nënshkruar procesverbali nga Komisioni i Përlogaritjes së Fondit Limiti. **Afati i realizimit të punimeve 30 ditë**

Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Me Urdhërin nr. 375 e nr. 2596 prot., datë 09.09.2022 është ngritur komisioni i përlogaritjes së fondit limiti i përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D..

Me Urdhërin e Prokurimit nr. 376 e nr. 2596 prot., datë 09.09.2022 është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D., bashkangjitur formularët e deklaramit të mospasjes së konfliktit të interes.

NJP më datë 11.11.2022 ka hartuar/nënshkruar “Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret për kualifikim”, bashkangjitur DT.

Ankesa për DT

- Më datë 16.11.2022, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep AK në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike të AK Bashkia Cërrik, rezulton se: për procedurën e me REF-49595-11-11-2022 me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në NJA Gostime”, me fond limit **33,818,310 lekë pa Tvsh**. Koordimi i APP ka sygjyer disa kriteret të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Njësia e Prokurimit ka hartuar procesverbalin e datë 17.11.2022, ku janë reflektuar sygjerimet e sipërcituara. Shtojca

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21e neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

1. Në pikën 2.3.3. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 47 (dyzetë e shtatë) punonjës të siguruar, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- *Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për secilin muaj të kërkuar;*

- *Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.*

2. Në pikën 2.3.4. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

Kërkesa për staf teknik (drejtues teknik) 4 inxhinier kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e funditReferuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij Kodi përcaktohet që “*Kontrata e punës*

lidhet në formë të shkruar...”, në asnjë paragraf të bazës ligjore të sipërcituar nuk kërkohet: “kontratat noteriale”.

3. Në pikën 2.3.5. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht.

- 3 (tre) Drejtues makineri shtrimi asfalti shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

- 2 (dy) Drejtues makineri të rënda shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

- 7 (shtatë) punëtor asfaltimi në rrugë shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmi aftësie profesionale.

- 5 (pesë) Shoferë me Cap shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR

- 8 (tetë) Punëtor ndërtimi krahu të shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmi aftësie profesionale.

2.3.6. OE ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike/ Në pronësi ose me qira	Ishte	Sasia
	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton	Në pronësi ose me qera	2
	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton	Në pronësi ose me qera	2
	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5-5ton	Në pronësi ose me qera	1
	Kamioncine me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	Në pronësi ose me qera	1
	Fadromë	Në pronësi ose me qera	2
	Grejder	Në pronësi ose me qera	1
	Autobetoniere	Në pronësi ose me qera	1
	Autopompë betoni	Në pronësi ose me qera	1
	Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qera	2
	Eskavator	Në pronësi ose me qera	1
	Buldozer	Në pronësi ose me qera	1
	Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qera	1
	Autobot uji	Në pronësi ose me qera	1
	Rimorkiator	Në pronësi ose me qera	1
	Fabrikë për prodhim asfalti/ ose kontratë furnizimi	Në pronësi ose me qera	1
	Impiant për prodhim betoni dhe inerte/ ose kontratë furnizimi	Në pronësi ose me qera	2
	Rrul me peshë mbi 15 ton	Në pronësi ose me qera	2
	Rrul me peshë mbi 10 ton	Në pronësi ose me qera	1
	Makineri shtrimi bordurash	Në pronësi ose me qera	

Për sa trajtuar më sipër, kriteret: **2.3.4, 2.3.5, dhe 2.3.6, (referuar dhe afatit të realizimit të punimeve 35 ditë)** nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: znj. D. L., znj. I. Ç. dhe z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. D. L., znj. I. Ç. dhe z. A. D. në cilësinë e anëtarëve NJHDT dhe të Njësisë së Prokurimit.

Vlerësimi i procedurës së prokurimit:

Me Urdhërin e nr. 377 e nr. 2596/1 prot., datë 09.09.2022 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga: z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh..

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar procesverbalin e datës 07.12.2022 për paraqitjen e ofertave në SPE, ku është konstatuar se kanë shfaqur interes:

1. **OE “A.” Shpk (me Nipt L.....E) me vlerë ekonomike të ofertës 33,668,309.90 (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e nëntë presje nëntë lekë pa Tvsh.**

Më datë 08.02.2022 KVO ka verifikuar dokumentacioni e OE të paraqitura në SPE, ku është konstatuar që: Dokumentacioni i paraqitur nga OE “A.” Shpk janë në përputhje me kërkesat ligjore për kualifikim.

Më datë 11.01.2023, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar vendimin për klasifikimin përfundimtar të ofertave, dhe është dërguar kërkesa për paraqitjen e dokumentacioni provues si dhe dokumentat e tjera shoqëruese, siç parashikohet në DT.

Me nr. 3423 prot., datë 12.12.2022 “Formulari i njoftimit të fituesit”, shpallur në Buletinin nr. 173 datë 19 Dhjetor 2023 në faqet 132-133/750.

Në dosje e prokurimit gjendet Raporti Përmbledhës i datës 20.12.2022, bashkangjitur Vendimi me nr. extra protokollit për miratimin i Raportit Përmbledhës nga Titullari i AK (personi i autorizuar) z. T. Z., po më datë 20.12.2022.

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 13 prot., datë 06.01.20223, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Cërrik, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor z. A. S. dhe Operatorit Ekonomik “A.” Shpk, me përfaqësues administrator z. Stefan Llabotiadhi me objekt: “Rikonstruksion rrugësh NJA Gostime”, Bashkia Cërrik, në përputhje me projektzbatimin e objektit, specififikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **33,668,309.90 (tridhjetë e tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e nëntë presje nëntë lekë pa Tvsh** (40,401,971.90 lekë me Tvsh).

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 17 prot., datë 06.01.2023, shpallur në Buletinin nr. 4 datë 16 janar 2023 të APP në faqen 242/387.

Nga auditimi i dokumentacionit të Operatorit Ekonomik “A.” Shpk, nuk u konstatuan parregullsi.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur : Komente mbi Projekt Raportin e Auditimit/observacionet me shkresën nr. 1138/1 prot., datë 20.05.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 190/4 prot., datë 23.05.2023, nga znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. anëtarë të Njësisë së Prokurimit, z. H. K., znj. R. J. dhe anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Për këtë pikë të kërkesave ju informojmë se numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën.*

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të OE e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së OE, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

Vendosja e kriterit për numrin e punonjësve duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po ti referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që ti shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vertetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në dosjen e prokurimit nuk gjendet asnjë dokumentacion ku pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrimin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës. Kërkesat për 47 (dyzetë e shtatë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, *eskavatoriste dhe shofere*, stafi teknik), nuk është pjesë e kriteve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët. Sa më sipër: nuk është argumentuar me grafikun e punimeve dhe volume sipas preventivit kërkesa për numrin e fuqisë punëtore që duhet për realizimin e objektit

Referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij Kodi përcaktohet që “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar...”, në asnjë paragraf të bazës ligjore të sipërcituar nuk kërkohet: “kontratat noteriale”.

Pretendimi i subjektit: Për këtë pikë në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislati për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. OE duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Ne lidhje me disponueshmërinë e inxhinierëve:

1 (një) inxhinier ndërtimi- Kërkohet Inxhinieri pasi kemi të bëjmë me rikonstrukcione të rrugëve. Referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen punime, të cilat kërkojnë detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri i ndërtimit gjatë gjithë periudhës të zbatimit të punimeve.

1 (një) inxhinier elektrik -Kërkohet inxhinieri elektrik, pasi referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen instalime elektrike të cilat janë të përcaktuara në preventivin fillestar e përkatësisht në sesionin B2 zëri 1,2 eti/

1 (një) inxhinier topografijeodet/makshajder-, është përcaktuar nga pikëpjmja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

1 (një) inxhinier Mjedisi- kërkohet inxhinieri i mjedisit për shkak se punimet e rrugëve do të kryhen në zonë të populluara cka kërkon rehabilitim të zonës përreth këtyre objekteve.

1 (një) inxhinier hidroteknik- Kërkohet inxhinieri hidroteknik, pasi referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit punime të cilat janë të përcaktuara në preventivin fillestar e përkatësisht në zërat: B/6,3, B/6,4, B/9,6, B/9,7, B/9,8, B/9,9 etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij Kodi përcaktohet që “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar...”, në asnjë paragraf të bazës ligjore të sipërcituar nuk kërkohet: “kontratat noteriale”.

Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

5. Procedura e prokurimit me objekt: “Ndërtim KUZ dhe rikonstrukcion i rrugës së Rrasave e Kabashi në Shtermen”, Bashkia Cërrik.

5/a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim KUZ dhe rikonstrukcion i rrugës së Rrasave e Kabashi në Shtermen”, Bashkia Cërrik Nr. REF- 47996-10-31-2022

1. Urdhër Prokurimi
Nr. 373, datë 09.09.2022

3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit
Urdhër Nr. 372, datë 09.09.2022

4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr.,374 datë 09.09.2022

2. Lloji i Procedurës – “E hapur”	Njësia e Prokurimit 1. D. L., Jurist 2. I. Ç., Ekonomist (Personi përgjegjës) 3. A. D., Inxhinier gjeoteknik	H. K., Kryetar R. J. M. Xh.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 23,038,684.20 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh): 22,361,041 BOE “G.” & “V. K.” Shpk	7. Diferenca me fondin limit 677,643.20 lekë (pa TVSh)
8. Data e hapjes së tenderit Datë 17.11.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkise me financim tre vjeçar	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 1 BOE b) S’kualifikuar: 0 BOE, c) Kualifikuar: 1 BOE
11. Ankimime për DT: JO	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës

Me VKB nr. 62 e nr. 2447 prot., datë 23.8.2022 “Miratimi i listës së projekteve prioritare për financimin 2022-2024, janë miratuar projektet:

Burimi i financimit: Buxheti i bashkisë Cërrik me financim 3 vjeçar miratuar me VKB nr. 62, datë 22.08.2022 “Për miratimin e listës së projekteve tre vjeçare për vitin 2022-2024”. Në zbatim të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore pika 2 në të cilin objekti në fjalë është pjesë e projekteve që janë pjesë e buxhetit 3 vjeçar të miratuar nga NJQV.

Projektuar nga OE “Z.” Shpk, me **Licencë N.6811/1, grup projektimi:** Ing. F. D.; nxh. Ndërtimi L. H., realizuar në vitin 2022.

Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Me Urdhërin nr. 372 e nr. 2592 prot., datë 09.09.2022 është ngritur komisioni i përlogaritjes së fondit limit i përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. dhe ka formuluar nënshkruar procesverbalin e përlogaritjes së vlerës limit të kontratës.

Me Urdhërin e Prokurimit nr. 373 e nr. 2593 prot., datë 09.09.2022 është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D., bashkangjitur formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të interesit.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës me nr. 3076 prot., datë 01.11.2022, botuar në Buletinin nr. 152 datë 07 nëntor 2023 të APP, faqet 21—22/750.

NJP më datë 01.12.2022 ka hartuar/nënshkruar “Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret për kualifikim”, Bashkangjitur DT.

Ankesa për DT

- Më datë 02.11.2022, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep AK në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike të AK Bashkia Cërrik, rezulton se: për procedurën e me REF-48151-11-01-2022 me objekt: “Ndërtim KUZ dhe rikonstruksion i rrugës së Rrasave e Kabashi në Shtermen”, Bashkia Cërrik, me fond limit **23,038,684 lekë pa Tvsh**. Koordimi i APP ka sygjëruar disa kriteret të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Njësia e Prokurimit ka hartuar procesverbalin e datë 03.11.2022, ku janë reflektuar sygjërimet e sipërcituara.

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

1. Në pikën 2.3.3. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 52 (pesëdhjetë e dy) punonjës të siguruar, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për secilin muaj të kërkuar;

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

2. Në pikën 2.3.4. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me **kontratë pune noteriale të vlefshme** dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si mëposhtë:

- **1 (një) inxhinier mekanik**

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga OE i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

3. Në pikën 2.3.5. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

- Mjek, 1 të punësuar (nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë). Kontratë noteriale të punës, diplomë, licence si dhe CV.

- 1 (një) Punonjës me dëshmi trajnimi si “Specialist për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Kontratë noteriale të punës si dhe certifikatë trajnimi “Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.

- 1 (një) Specialistë të certifikuar për punime në lartësi. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune noteriale, si dhe dokumentin e përkatës të certifikimit

- 1 (një) Inspektor Cilësie me background Inxhinierik me mbi 5 vite eksperiencë pune si Inspektor Cilësie në përputhje me standartin ISO 9001:2015., i cili duhet të figurojë në listëpagesë e shoqërisë për periudhën nëntor 2020-janar 2021. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune noteriale, si dhe dokumentin e përkatës të certifikimit

- 1 (një) person të certifikuar si “Përgjegjës për dëmet në mjedis” gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune noteriale, si dhe dokumentin e përkatës të certifikimit

- 1 (një) specialist ekspert zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në mbështetje të pikës 4 të nenit 49, Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune noteriale, si dhe dokumentin e përkatës të certifikimit.

- 2 (dy) Automakinistë shoqëruar me kontratë pune noteriale, leje drejtimi (të vlefshme) të leshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor .

- 2 (dy) eskavatoristë shoqëruar me kontratë pune noteriale, leje drejtimi (të vlefshme) ë leshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor .

- 2 (dy) buldozeriste shoqëruar me kontratë pune noteriale, leje drejtimi (të vlefshme) ë leshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor .

- 1 (një) Shoferë kamioni - të pajisur me kontratë pune noteriale dhe dëshmi të aftësisë profesionale të lëshuar nga Ministria e Transportit (Certifikatë Aftësimi Profesional)

- 2 (dy) Shoferë me patentë kategoria C shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe leje drejtimi kategoria C.

- 3 Inxhinier ndërtimi shoqëruar me diplomë, kontratë pune noteriale.

- 2 Teknikë Elektriçist shoqëruar me diplomë/deftesë, kontratë pune noteriale dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI.

- 2 Teknikë mekanik shoqëruar me diplomë/deftesë, kontratë pune noteriale dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI,

- 2 Teknik ndërtimi shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe diplomë/deftesë.
- 2 Saldator shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikatë dëshmie përkatëse të kualifikimit profesional (dëshmi profesionale)
- 2 specialistë për ndihmën e shpejtë, shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikatë nga Kryqi i Kuq Shqiptar
- 3 (tre) hekurkthyes shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikatë dëshmie përkatëse të kualifikimit profesional (dëshmi profesionale)
- 3 (tre) karpentierë shoqëruar me kontratë pune noteriale certifikatë dëshmie përkatëse të kualifikimit profesional (dëshmi profesionale)
- 2 (dy) saldatorë shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikatë dëshmie përkatëse të kualifikimit profesional (dëshmi profesionale)
- 2 (dy) specialistë montim tubash HDPE shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikatë dëshmie përkatëse të kualifikimit profesional (dëshmi profesionale)
- 2 (dy) hidraulikë shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikatë dëshmie përkatëse të kualifikimit profesional (dëshmi profesionale)

4. Në pikën 2.3.6. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min.10 ton	2 copë	pronësi ose me qera
2	Kamionçinë 3-5 ton	3 copë	pronësi ose me qera
4	Eskavatore	3 cope	pronësi ose me qera
5	Fadroma	1 cope	pronësi ose me qera
6	Asfaltoshtrueses	1 cope	pronësi ose me qera
7	Autobitumatrice	1 cope	pronësi ose me qera
8	Makineri skarifikim asfalti	1 cope	pronësi ose me qera
9	Grejder	1 cope	pronësi ose me qera
10	Rrul ngjeshes	2 cope	pronësi ose me qera
11	Rrul vibrues	4 cope	pronësi ose me qera
12	Autobetoniere	3 cope	pronësi ose me qera
13	Autopome betoni	2 cope	pronësi ose me qera
14	Fabrikë betoni shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë, planin e vendosjes	1	pronësi, qira ose kontratë furnizimi
15	Fabrike asfalti e pajisur me leje mjedisore	1	pronësi, qira ose kontratë furnizimi
16	Pompë suvatimi	3 copë	pronësi ose me qera
17	Gjenerator	1 copë	pronësi ose me qera
18	Depozitë uji 3.000-5.000 litra	2 copë	pronësi ose me qera
19	Autovinç	2 copë	pronësi ose me qera
20	Skela dhe rrjetë mbrojtëse	500m ²	pronësi ose me qera
21	Vibrator	2 copë	pronësi ose me qera
22	Autobot uji	1 copë	pronësi ose me qera
23	Betoniere kantieri 1.5-3 m ³	2 copë	pronësi ose me qera
24	Vinç karele	1 copë	pronësi ose me qera
25	Matrapik	2 copë	pronësi ose me qera
26	Nivelues betoni	1 copë	pronësi ose me qera
27	Minieskavator	1 copë	pronësi ose me qera
28	Termometer per matje togezimi	1 copë	pronësi ose me qera

Referuar punimeve të përfshira në preventiv, rezulton se kërkesat për: **6 (gjashtë) Rula** (2 ngjeshës dhe 4 me vibrim); **3 (tre) autobetoniere**; **2 (dy) autopompa betony**; **3 (tre) pompa suvatimi** **2 (dy) autoviça**; nuk janë të domosdoshëm për realizimin e kontratës.

5. Në pikën 2.3.8. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë MTL, RSH, sic përcaktohet në *Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM nr. 42, datë 16.01.2008.*

- **Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001** (e vlefshme)

- Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë për sistemin e intergruar, **PASS 99** (e vlefshme).

Në rast të BOE secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë certifikatat ISO sipas zëravë të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes.

Certifikatat ISO duhet të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: znj. D. L., znj. I. Ç. dhe z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

Vlerësimi i procedurës së prokurimit:

Me Urdhërin e nr. 374 e nr. 2593/1 prot., datë 09.09.2022 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga: z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh..

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar procesverbalin e datës 17.11.2022 për paraqitjen e ofertave në SPE, ku është konstatuar se kanë shfaqur interes:

1. BOE “G.” Shpk & “V. K.” Shpk (me Nipt-e respektiv: L.....I & K.....L) me vlerë ekonomike të ofertës 22.361.041 (njëzete e dy milion e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyzetë e një) lekë pa Tvsh.

Më datë 11.01.2023 KVO ka verifikuar dokumentacionin e OE të paraqitura në SPE, ku është konstatuar që: Dokumentacioni i paraqitur nga OE “V. H.” Shpk janë në përputhje me kërkesat ligjore për kualifikim.

Më datë 17.11.2022, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar vendimin për klasifikimin përfundimtar të ofertave, dhe është dërguar kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit provues si dhe dokumentat e tjera shoqëruese, siç parashikohet në DT.

Në dosje e prokurimit gjendet Raporti Përmbledhës i datës 01.12.2022, bashkangjitur Vendimi për miratimin i Raportit Përmbledhës nga Titullari i AK (persononi i autorizuar), nr. 3263/1 prot., 01.12.2022.

Me nr. 3263 prot., datë 21.11.2022 “Formulari i njoftimit të fituesit”, shpallur në Buletinin nr. 164 datë 30 nëntor 2022 në faqet 149-150/590.

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 3542 prot., datë 21.12.2022, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Cërrik, të përfaqësuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. A. S. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “G.” Shpk & “V. K.”, me përfaqësues respektiv administratorët: z. N. Xh. e z. Gj. B., krijuar me marrëveshjen paraprake e bashkëpunimit të përkohshëm datë 16.11.2022 me objekt: “Ndërtim KUZ dhe rikonstruksion i rrugës së Rrasave e Kabashi në Shtermen”, Bashkia Cërrik, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **22.361.041 (njëzete e dy milion e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyzetë e një) lekë pa Tvsh (26,833,249.20 lekë me Tvsh).**

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 3543/1 prot., datë 22.12.2022, shpallur në Buletinin nr. 176 datë 27 dhjetor 2022 të APP në faqen 450/594.

Lidhur me BOE “G.” Shpk & “V. K.” Shpk, nga auditimi rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “G.” Shpk & “V. K.” Shpk, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Për sa trajtuar më sipër BOE “G.” Shpk & “V. K.” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues BOE

“G.” Shpk & “V. K.” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE “G.” Shpk & “V. K.” Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “G.” Shpk & “V. K.” Shpk, Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

Konkluzioni: Procedura e prokurimit paraqet parregullsi në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet vendosje e kriterëve jo në përputhjen me tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e OE në garë. Gjithashtu, parregullsi ka edhe në shpalljen fitues të BOE “G.” Shpk & “V. K.” Shpk, pasi nuk plotëson të gjitha kriterëve e DT, veprime këto në kundërshtim të dispozitave ligjore të LPP. Në këtë rast KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdorim më efektiv të fondit me vlerë **22.361.041 pa Tvsh.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. S. Kryetar i Bashkisë Cërrik në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, z. T. Z. Person i Autorizuar, znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur : Komente mbi Projekt Raportin e Auditimit/observacionet me shkresën nr. 1138/1 prot., datë 20.05.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 190/4 prot., datë 23.05.2023, nga znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. anëtarë të Njësisë së Prokurimit, z. H. K., znj. R. J. dhe anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me pikën e mësipërme ju informojmë se kërkesa është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe Neni 39, pika 6, gërma “ç” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të OE e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument qe vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së OE, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.*

Vendosja e kriterit për numrin e punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po ti referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që ti shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe

profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Punonjësit janë kërkuar në propocion me volume e punës sipas manualeve përkatëse.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në dosjen e prokurimit nuk gjendet asnjë dokumentacion ku pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrimin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës. Kërkesat për 52 (pesëdhjetë e dy) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, *eskavatoriste dhe shofere*, stafi teknik), nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët. Sa më sipër: nuk është argumentuar me grafikun e punimeve dhe volume sipas preventivit kërkesa për numrin e fuqisë punëtore që duhet për realizimin e objektit.

Referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij Kodi përcaktohet që “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar...”, në asnjë paragraf të bazës ligjore të sipërcituar nuk kërkohet: “kontratat noteriale”.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën e mësipërme ju informojmë se kërkesat e mësipërme janë vendosur në zbatim të pikës 14 gërma “a” e janë vendosur në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma nderkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “AK, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit. Ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij Kodi përcaktohet që “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar...”, në asnjë paragraf të bazës ligjore të sipërcituar nuk kërkohet: “kontratat noteriale”.

Kërkesat për “Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në listëpagesat...”, nga të cilët: 2 (dy) Automakiniste 2 (dy) eskavatoriste (dy) buldozeriste 1 (nje) Shoferë kamioni 2 (dy) Shoferë me patente kategoria C, gjithsej 37 (Teknik specialist) me dëshmi kualifikimi, nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët.

Grupi i auditimit ka analizuar kriteret: **2.3.4, 2.3.5, dhe 2.3.6, dhe ka konstatuar që** nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrimin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën e mësipërme ju informojmë se kërkesat e mësipërme janë vendosur në zbatim të pikës 14 gërma “a” – “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizma kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor. për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohuar nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Ju rikujtojmë që Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) realizohet para fillimit të procedurës së prokurimit dhe është pjesë integrale e projektit të objektit. Vlerësimi i një vepre publike ose me interes publik, do të thotë edhe gjykimi i vlerës së saj në perspektivën e interesit kolektiv. Pra një objekt nuk prokurohet pa u zgjidhur problematikën e ndikimit në mjedis.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën e mësipërme për plotësimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar ju informojmë se bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimisht thuhet se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vartetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP, dhe në këto rregulla OE ka ngarkuar në system formularin vetpërmbledhës të vetdeklarimit ku në të shprehet se OE ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe kontributeve. Sa i përket kontratave të deklaruara mund të kenë qënë në nisje të tyre dhe procedurat e regjistrimit mund të jenë në proces.

Përsa më lartë kërkojmë rishikimin e pikave të mësipërme sa i përket komisionit të vlerësimit të ofertave.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Është konstatuar që: BOE “G.” Shpk & “V. K.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, si dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. **Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.**

6. Procedura e prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave egzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara”, Bashkia Cërrik.

6/a. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave egzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara”, Bashkia Cërrik. REF-79703-09-12-2023		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 215, datë 09.08.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 214, datë 09.08.2023 Njësia e Prokurimit 1. D. L., Jurist 2. I. Ç., Ekonomist (Personi përgjegjës) 3. A. D., Inxhinier gjeoteknik	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.216, datë 09.08.2023 H. K., Kryetar R. J. Anetar M. Xh. Anetar
2. Lloji i Procedurës “E hapur” 30 ditë		
5. Fondi Limit 38,309,100 lekë.	6. Oferta fituese (37,696,216.10 lekë pa Tvsh) OE “Z.” Shpk	7. Diferenca me fondin limit (612,883,90 lekë pa Tvsh)
8. Data e hapjes së tenderit Datë 28.09.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit + buxheti i bashkise	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S’kualifikuar Ska, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime për DT; Ska	12. Përgjigje Ankesës Ska	13. Përgjigje Ankesës Ska

Procedura është realizuar në zbatim të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore”, pika 2 në të cilin është miratuar me shkresën nr. 14413 prot., datë 04.08.2023 “Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2023” të Ministrisë së Financave, fondet për realizimin e projektit.

Projekt-zbatimi është realizuar nga Bashkia Cërrik nga D.P.T.&ZH. (ing. F. U.; ing. E. B. e ing. A. D. në janar 2023, me porositet Sektorin e Strehimit.

Me shkresën nr. 3124/5 prot., datë 09.6.2023 “dërgohet çelja e fondeve në grupin e shpenzimeve kapitale për projektet me cikël financimi 2023-2024” Ministria e Arsimit dhe Sporteve është kërkuar raportimimi mujor mbi ecurinë e procedurave të prokurimit, lidhjes së kontratës dhe zbatimi i grafikut të punimeve. (bashkangjitur shkresa me nr. 9069/1, datë 07.6.2023 e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Transferim fondi për shpenzime kapitale” miratimi i fondeve për Bashkinë Cërrik.).

Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Me Urdhërin nr. 214 e nr. 1820 prot., datë 09.08.2023 është ngritur komisioni i përlogaritjes së fondit limit i përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D..

Më datë 09.08.2023 është formuluar/nënshkruar procesverbali nga Komisioni i Përlogaritjes së Fondit Limiti. **Afati i realizimit të punimeve 30 ditë**

Situacioni është nënshkruar nga z. F. U., miratuar nga Titullari i AK z. A. S..

Me Urdhërin e Prokurimit nr. 215 e nr. 1821 prot., datë 09.08.2023 është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D., bashkangjitur formularët e deklaramit të mospasjes së konfliktit të interesit.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës me nr. 1995 prot., datë 12.09.2023, botuar në Buletinin nr. 78 datë 18 shtator 2023 të APP, faqe 26-27/548.

NJP më datë 12.09.2023 ka hartuar/nënshkruar “Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret për kualifikim”, Bashkangjitur DT.

Ndryshime në DT.

- Më datë 15.09.2023, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep AK në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike të AK Bashkia Cërrik, rezulton se: për procedurën e me REF-79703-09-12-2023 me objekt: “Përmirësim i banesave egzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara” me fond prej 38,309,100 (*tridhjetë e tetë milion e treqind e nëntë mijë e njëqind*) lekë pa Tvsh. Koordimi i APP ka sygjyer disa kriteret të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Njësia e Prokurimit ka hartuar procesverbalin e datë 18.09.2023, ku janë reflektuar sygjerimet e sipërcituara. Bashkangjitur shtojca me nr. 1995/1 prot., datë 18.09.2023.

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

1. Në pikën 2.3.3. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga MIE, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e OE lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi

- NP-7- B (*Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje*)

Punime speciale ndërtimi

- NS- 18 –B (*Punime topogjeodezike*)

Referuar punimeve të përfshira në preventiv, rezulton se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorisë së mëposhtme, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008:

2. Në pikën 2.3.4. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punetore minimalisht 85 (**tetëdhjetë e pese**) personash. Për përmbushjen e këtij kriteri, OE duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën Qeshor 2023- Gusht 2023, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

OE krahas deklaratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj

- Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi

3. Në pikën 2.3.5. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Mekanik**

- **1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf**

Për të dëshmuar përbushjen e këtij kriteri, OE duhet të paraqesë:

Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e vlefshme, diplomë, librezë pune dhe CV.

4. Në pikën 2.3.7. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjësit specialistë të kualifikuar në profilet përkatëse si më poshtë:

- Teknik Ndërtimi 1 (një); - Teknik Topograf 1 (një); - Hidraulik 2 (dy); - Hekurkthyes 2 (dy)

- Murator 3 (tre); - Pllakashtrues 3(tre); - Hidroizolues 1 (një); - Bojaxhi 3 (tre); -

Punëtor/Specialist ndërtimi 1 (një); - Punonjës/specialist duralumini 1 (një); -

Punonjës/specialist sistem ngrohje 2 (dy)

Për punojësit e mësipërm duhet të paraqiten:

Kontratat e punës individuale (të vlefshme).

Certifikata ose dëshmi përkatëse

Si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Maj-Korrik.

Për manovratorët të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR

5. Në pikën 2.3.8. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- OE të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licënsuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë për periudhën Qeshor 2023- Gusht 2023.

- OE të kenë në stafin e tyre **1 (një)** punonjës të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë e akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga RSH. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit, e dhënë nga një organizem i licëncuar, shqiptar ose i huaj, si edhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë për periudhën Qeshor 2023- Gusht 2023.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DT, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga OE i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

5. Në pikën 2.3.10. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3-5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri n 3 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Kamion me Vinc	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Trajler për transport mjetetsh	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Rimorkio për transport mjetetsh	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Fadrome me Goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1

10	Eskavator me zinxhirë	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Minieskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 2
12	Mini fadrome bobcat	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Autobeniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
16	Pompa Suvatimi	në pronësi ose me qira	Copë 3
17	Tranxhe per prerjen e kthimin e hekurit	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Skeleri	në pronësi ose me qira	Min 500 m2
19	Vinç kullë me krah jo me pak se 30 meter	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Greider	në pronësi ose me qira	Copë 1
21	Aparat topogjeodezik me GPS	në pronësi ose me qira	Copë 1
22	Depozite uji 1000l-5000l	në pronësi ose me qira	Copë 5
23	Pompa Uji	në pronësi ose me qira	Copë 3
24	Rul vibrues minimumi 8 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
25	Pajisje niveluese per nivelim shtresash	në pronësi ose me qira	Copë 1
26	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 2
27	Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
28	Fabrikë prodhimi bordura dhe pllaka betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
29	Fabrikë prodhimi dyer dritare PVC dhe duralumin	në pronësi ose me qira	Copë 1

Referuar punimeve të përfshira në preventiv, rezulton se kërkesat për: **4 (gjashtë) kamio, 3 (tre) kamioçina, 2 (dy) kamiona me vinç, 1 (një) Trajler për transport mjetetsh, 1 (një) Rimorkio për transport mjetetsh, 1 (një) Vinç kullë me krah jo më pak se 30 meter, 1 (një) rul me vibrim; 1 (një) grejder;); 1 (një) Aparat topogjeodezik me GPS 1 (një) Rul vibrues minimumi 8 ton; Fabrikë prodhimi bordura dhe pllaka betony e Fabrikë prodhimi dyer dritare PVC dhe duralumin** nuk janë të domosdoshëm për realizimin e kontratës.

Për sa trajtuar më sipër, kriteret: **2.3.5, 2.3.7, dhe 2.3.10, (referuar numrit të banesave 52 dhe afatit të realizimit të punimeve 30 ditë)** nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjrisht për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: znj. D. L., znj. I. Ç. dhe z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

Vlerësimi i procedurës së prokurimit:

Me Urdhërin e nr. 216 e nr. 1822 prot., datë 09.06.2023 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga: z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh..

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar procesverbalin e datës 28.09.2023 për paraqitjen e ofertave në SPE, ku është konstatuar se kanë shfaqur interes:

1. OE “Z.” Shpk (me Nipt J.....K) me vlerë ekonomike të ofertës 37,696,213.10 (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e trembëdhjetë pikë dhjetë) lekë pa Tvsh

Më datë 03.10.2023 KVO ka verifikuar dokumentacioni e OE të paraqitura në SPE, ku është konstatuar që: Dokumentacioni i paraqitur nga **OE “Z.” Shpk** janë në përputhje me kërkesat ligjore për kualifikim.

Më datë 28.09.2023, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar vendimin për klasifikimin përfundimtar të ofertave.

Në dosje e prokurimit gjendet Raporti Përmbledhës i datës 13.10.2023, bashkangjitur Vendimi për miratimin i Raportit Përmbledhës nga Titullari i AK, po më datë 13.10.2023 (me nr. 2202 prot.).

Me nr. 2153 prot., datë 04.10.2023 “Formulari i njoftimit të fituesit”, shpallur në Buletinin nr. 84 datë 09 tetor 2023 në faqen 148/625.

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 2244 prot., datë 18.10.20223, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Cërrik, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor z. A. S. dhe Operatorit Ekonomik “Z.” Shpk, me përfaqësues administratorin z. Y. Z. e me objekt: “Përmirësim i banesave egzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara”, Bashkia Cërrik, në përputhje me projekt-zbatimin e objektit, specififikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **37,696,213.10** (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e trembëdhjetë pikë dhjetë) **lekë pa Tvsh** (45,235,455.70 lekë me Tvsh).

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 2251 prot., datë 18.10.2023, shpallur në Buletinin nr. 87 datë 23 tetor 2023 të APP në faqet 384-385/564.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE “Z.” Shpk, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Për sa trajtuar më sipër OE “Z.” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues OE “Z.” Shpk, por anullimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE “Z.” Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “Z.” Shpk, Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

Konkluzioni: Procedura e prokurimit paraqet parregullsi në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet vendosje e kriterëve jo në përputhjen me tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e OE në garë. Gjithashtu, parregullsi ka edhe në shpalljen fitues të OE “Z.” Shpk, pasi nuk plotëson të gjitha kriterëve e DT, veprime këto në kundërshtim të dispozitave ligjore të LPP. Në këtë rast KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdorim më efektiv të fondit me vlerë **37,696,213.10 lekë** pa Tvsh.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. S. Kryetar i Bashkisë Cërrik në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, z. T. Z. Person i Autorizuar, znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur : Komente mbi Projekt Raportin e Auditimit/observacionet me shkresën nr. 1138/1 prot., datë 20.05.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 190/4 prot., datë 23.05.2023, nga znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. anëtarë të Njësisë së Prokurimit, z. H. K., znj. R. J. dhe anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Sa i përket pikës së mësipërme ju informojmë se: *N.P. 7 B Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të*

veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës **deri tek përdoruesi**, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Në rastin konkret duke qënë se kemi të bëjmë me një ndërtim civil në preventive janë parashikuar punime për rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza .

NS- 18 -B Punime topogjeodezike Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizin të veçantë, punime topogjedezike në objekte inxhinierike, punime special gjeodezike; rrjeta mbiëshetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Në rastin konkret duke qënë se kemi të bëjmë me një ndërtim civil në preventive janë parashikuar punime për zbatimi i rlevimeve topografike.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në opinion e grupit të auditimit punimet hidraulike në banesa nuk përfshihet në punime e kategorisë N.P. 7 B pasi nuk kanë asnjë lidhje me: veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura. Në rastin konkret kemi të bëjmë me konsumatorin (nga banesa deri tek sahati ujëmatës, që është pronë e përdoruesit/pronarit të banesës) . Përsa i përket kategorisë NS- 18 –B, jemi në rastin e përmirësimit të banesave egzistuese.

Pretendimi i subjektit: Ky kriter është vendosun bazuur në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik” në të cilin thuhet: “Afësia profesionale e OE për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të OE e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rjedhje çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së OE, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe ekspericncës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për numrin e punonjesve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet: Po ti referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi Është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Janë përcaktuar 85 punonjës për shkak se janë 48 banesa për tu rikonstruktuar brenda një kohe të shkurtër prej 30 ditësh dhe duhet të përfundojnë para se të fillojnë shirat dhe ngricat.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në dosjen e prokurimit nuk gjendet asnjë dokumentacion ku pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës. Kërkesat për 85 (tetëdhjetë e pesë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, eskavatoriste dhe shofere, stafi teknik), nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencia të suksesshme në realizimin e punimeve të

ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët. Sa më sipër: nuk është argumentuar me grafikun e punimeve dhe volume sipas preventivit kërkesa për numrin e fuqisë punëtore që duhet për realizimin e objektit.

Referuar Kodit të Punës, në lidhje me formën që duhet të ketë një kontratë pune, në nenin 21 të këtij Kodi përcaktohet që “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar...”, në asnjë paragraf të bazës ligjore të sipërcituar nuk kërkohet: “kontratat noteriale”.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me kërkesën për staf teknik, 1 (një) inxhinier mekanik dhe 1 (një) inxhinier gjeodet/topograf, duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen të përfshira në preventivin e punimeve, AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierëve të sipërmendur. Kriteret për inxhinierët, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Pretendimi juaj nuk qëndron ligjërisht dhe teknikisht, pasi nuk ka asnjë analizë çmimi për zërat e punimeve që përfshihen në preventive, ku të përfshihet nevoja për inxhinier mekanik apo gjeodet/topograf. Në lidhje me mirëmbajtjen e mjeteve nuk është çështje e AK por e OE që realizon punimet.

Ju nuk keni sjellë asnjë arsyetim tekniko ligjor ku të kundërshtojë gjetjen e grupit të auditimit në lidhje me kërkesën për 1 (një) inxhinier mekanik dhe 1 (një) inxhinier gjeodet/topograf.

Pretendimi i subjektit: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimit publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. AK argumenton se kërkesa për (një) Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 77, pika 4; të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: “Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë...”

Theksojmë se, AK ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DT, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilët janë të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. Gjithashtu, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) punonjësi të pajisur me certifikatë Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Kërkesat për “Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në listëpagesat...” për 20 punonjës me diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor,” me certifikata ose dëshmi përkatëse, nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët.

Grupi i auditimit ka analizuar kriteret: **2.3.5, 2.3.7, dhe 2.3.10, dhe ka konstatuar që** nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën e mësipërme për plotësimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar ju informojmë se bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimisht thuhet se :”Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, AK pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla” OE ka ngarkuar në sistem formularin vetëpërmbledhës të vetëdeklarimit ku në të shprehet se OE ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe kontributeve. Sa i përket kontratave të deklaruara mund të kenë qënë në nisje të tyre dhe procedurat e regjistrimit mund të jenë në proces.

KVO ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga OE në bazë të kontratave përkatëse ku konstatohen dhe emërtimet përkatëse.

• Përsa. më lartë kërkojmë rishikimin e pikave të mësipërme sa i përket KVO.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Është konstatuar që: OE “Z.” Shpk & “V. K.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, si dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. **Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.**

7. Procedura e prokurimit me objekt: “Sistemim i varrezave të qytetit Cërrik”, Bashkia Cërrik.

7/a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim i varrezave të qytetit Cërrik”, Bashkia Cërrik. REF -61530-03-06-2023		
1. Urdhër Prokurimi Nr.94, datë 21.02.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 93, datë 21.02.2023 Njësia e Prokurimit 1. D. L., Jurist 2. I. Ç., Ekonomist (Personi përgjegjës) 3. A. D., Inxhinier gjeoteknik	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr 95., datë 21.02.2023 H. K., Kryetar R. J. Anetar M. Xh. Anetar
2. Lloji i Procedurës “Procedure e hapur e thjeshtuar”		
5. Fondi Limit 5,995,844 (pa Tvsh) lekë.	6. Oferta fituese 5.693.309 lekë (pa Tvsh) OE “M.” Shpk	7. Diferenca me fondin limit 302,535 leke (pa Tvsh)
8. Data e hapjes së tenderit Datë 24.03.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkise	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) S’kualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime për DT; ska	12. Përgjigje Ankesës ska	13. Përgjigje Ankesës ska

Projektuar është realizuar nga OE “Z.” Shpk, me **Licencë N.6811/1, grup projektimi:**

Inxh. Hidro. M. M., Ark. R. M., Ark. E. M., Ark. G. K.

Inxh. Ndërt. R. T., Inxh. Elek. S. P., Inxh. K. Gj., Inxh. B. Sh.

Inxh. Gjeo.Y. M., Inxh. Mek. A. P. e Inxh. Gjeodet L. V. në Janar 2023

Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Me Urdhërin nr. 93 e nr. 594 prot., datë 21.02.2023 është ngritur komisioni i përllogaritjes së fondit limit i përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D..

Më datë 21.02.2023 është formuluar/nënshkruar procesverbali nga Komisioni i Përllogaritjes së Fondit Limiti. **Afati i realizimit të punimeve 30 ditë**

Me Urdhërin e Prokurimit nr. 94 e nr. 595 prot., datë 21.02.2023 është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D., bashkangjitur formularët e deklarimit të mospasjes së konfliktit të interes.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës me nr. 596/1 prot., datë 06.03.2023, botuar në Buletinin nr. 24 datë 13 mars 2023 të APP, faqen 52/793.

Më datë 15.03.2023 është formuluar/nënshkruar Shtojca e DT, për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt “Sistemim i varrezave te qytetit Cerrik” pas monitorimit te APP

-Vlerësimi i kritereve.

Në aplikimin e kritereve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

1. Në pikën 2.3.2. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë Licencën profesionale të shoqërise për realizimin e punimeve objekt kontrate, e cila duhet të përmbajë së paku kategoritë e mëposhtme:

N.P-5 A, Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjisllacionit në fuqi.

2. Në pikën 2.3.3. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 32 (tridhjetë e dy) punonjës të siguar, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për secilin muaj të kërkuar;

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjisllacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

3. Në pikën 2.3.4. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: 2.3.4. OE ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si mëposhtë:

- 1 (një) inxhinier mjedisi

4. Në pikën 2.3.6. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi infrastrukture transporti, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë;

- 1 (një) teknik ndërtimi, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 1 (një) teknik topograf, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 1 (një) teknik Hidroteknik, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 2 (dy) muratorë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 1 (një) Hidraulike, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 1 (dy) Hekurkthyes, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesionale në RSH”;

- 1 (një) Karpentier, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme dhe diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”;

- 2 (dy) manovratorë/eskavatoristë, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

- 2 (dy) shoferë për kamiona (kategoria C minimale), shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

4. Në pikën 3.3.7. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike/ Në pronësi ose me qira	Ishte	Bëhet
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 ton	2	1
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton	2	2
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5-5ton	1	1
4	Kamioncine me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	2	1
5	Fadromë	1	1
6	Autobetoniere	2	2
7	Autopompë betoni	1	1
8	Eskavator	3	1
9	Buldozer	1	1
10	Autobetoniere Kantieri 2.5m ³	1	1
11	Autobot uji	1	1
12	Rimorkiator	1	1
13	Impiant për prodhim betoni dhe inerte/ ose kontratë furnizimi	1	1
14	Rrul me peshë mbi 10 ton	2	2

Për sa trajtuar më sipër, kriteret: **2.3.3, 2.3.5, dhe 2.3.6**, nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

5. Në pikën 2.3.8. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të jetë i pajisur me leje/licencë të lëshuar nga QKL/QKB, Kodi III.2.B, lidhur me transportimin e mbetjeve që kanë ndikim në mjedis.

6. Në pikën 2.3.9. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose nderkombëtar sipas standarteve SSH ISO/IEC 17025:2017 “Kërkesa të përgjithshme për Kopetencën e Laboratorëve Testues dhe Kalibrues”.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: znj. D. L., znj. I. Ç. dhe z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

Vlerësimi i procedurës së prokurimit:

Me Urdhërin e nr. 95 e nr. 596 prot., datë 21.02.2023 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga: z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh..

Më datë 15.03.2023 është hartuar procesverbali mbi modifikimin e DT nënshkruar nga Z. T. Z.. Personi i Autorizuar nga Titullar i AK. Bashkangjitur Shtojca me nr. 596/2 prot., datë 15.03.2023.

Në zbatim të nenit 75 pika 2 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në zbatim të sygjërimeve të kordinimit të APP (bashkengjitur) bëhen ndryshimet si me poshte vijon:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar procesverbalin e datës 24.03.2023 për paraqitjen e ofertave në SPE, ku është konstatuar se kanë shfaqur interes:

1. OE “M.” Shpk (me Nipt L26310801C) me vlerë ekonomike të ofertës **5,693,309** (pesë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntë) **lekë pa Tvsh**

Më datë 29.08.2023 KVO ka verifikuar dokumentacioni e OE të paraqitura në SPE, ku është konstatuar që: Dokumentacioni i paraqitur nga **OE “M.” Shpk** janë në përputhje me kërkesat ligjore për kualifikim.

Më datë 24.03.2023, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar vendimin për klasifikimin përfundimtar të ofertave.

Në dosje e prokurimit gjendet Raporti Përmbledhës i datës 31.03.2023, bashkangjitur Vendimi për miratimin i Raportit Përmbledhës nga Titullari i AK, po më datë 31.03.2023 (me nr. extra prot.).

Me nr. 596 prot., datë 29.03.2023 “Formulari i njoftimit të fituesit”, shpallur në Buletinin nr. 30 datë 03 prill 2023 në faqet 145-146/618.

Kontrata e sipërmarrjes për punë publike me nr. 995 prot., datë 05.09.20223, është lidhur mes Autoritetit Kontraktor, Bashkia Cërrik, të përfaqësuar nga Titullari i Autoriteti Kontraktor z. A. S. dhe Operatorit Ekonomik “M.” Shpk, me përfaqësues administratorin z. E. B. e me objekt: “Sistemim i varrezave të qytetit Cërrik”, Bashkia Cërrik, në përputhje me projektzbatimin e objektit, specifikimet teknike dhe çdo dokument të tenderit, si pjesë integrale e kontratës. Vlera e kontratës është **5,693,309** (pesë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntë) **lekë pa Tvsh** (6,831,970.80 lekë me Tvsh).

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 995/1 prot., datë 06.04.2023, shpallur në Buletinin nr. 34 datë 18 prill 2023 të APP në faqet 489-490/603.

Lidhur me OE “M.” Shpk, nga auditimi rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE “M.” Shpk, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Për sa trajtuar më sipër OE “M.” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE “M.” Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “M.” Shpk, Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

Konkluzioni: Procedura e prokurimit paraqet parregullsi në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet vendosje e kriterëve jo në përputhjen me tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e OE në garë. Gjithashtu, parregullsi ka edhe në shpalljen fitues të OE “M.” Shpk, pasi nuk plotëson të gjitha kriterëve e DT, veprime këto në kundërshtim të dispozitave ligjore të LPP. Në këtë rast KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdorim më efektiv të fondit me vlerë **5,693,309 lekë pa Tvsh**.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A. S. Kryetar i Bashkisë Cërrrik në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, z. T. Z. Person i Autorizuar, znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur : Komente mbi Projekt Raportin e Auditimit/observacionet me shkresën nr. 1138/1 prot., datë 20.05.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 190/4 prot., datë 23.05.2023, nga znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. anëtarë të Njësisë së Prokurimit, z. H. K., znj. R. J. dhe anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Përsa i përket pikës së mësipërme ju informojme se kërkesa për mjetet është vendosur sipas pikës 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe neni 39, pika 6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, s dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve të këtij objekti, si më poshtë: Për punime të përgjithshme të ndërtimit: NP-5A, është kërkuar për shkak të punimeve të mureve mbajtëse në zërat III/13; III/14; III/13; III/13;*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Së pari zëri III në preventive i përrket “Punime për furnizim me ujë të pijshëm” dhe nënzërat janë përkatësisht: III/13 “Realizim i strukturës së çezmave me mur betony” III/14 “Veshje me pllaka guri për çezma” dhe III/15 “Mbulesë guri në formë lavamani për çezma”.Grupi i auditimit i është referuar punimeve të përfshira në preventiv, rezulton se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorisë së mëposhtme, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008: N.P. 5. Ju nuk keni paraqitur asnjë zë punimi që të jetë për zbatimin e të cilit do duhej disponimi i kategorisë NP 5. *Pasi zëra që ju përmendi “Mure me blloqe betoni t=20 deri ne 3 m me llaç të përzier” e themel e xokol brutobetoni” nuk përfshihen në “Punime nëntokësore, ura e vepra arti”.*

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me pikën e mësipërme ju informojmë se: është kërkuar inxhinier i mjedisit për shkak se punimet do të kryhen në zonë të populluar çka kërkon rehabilitimin e zonës përreth këtyre objekteve.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) realizohet para fillimit të procedurës së prokurimit dhe është pjesë integrale e projektit të objektit. Vlerësimi i një vepre publike ose me interes publik, do të thotë edhe gjykimi i vlerës së saj në perspektivën e interesit kolektiv. Pra një objekt nuk prokurohet pa u zgjidhur problematikën e ndikimit në mjedis.

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me pikën e mësipërme kërkesa për punonjës është kryer bazuar në nenin 39 pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e cila tregon se kërkesa për punonjës të kualifikuar është kriter që provon përshtatëshmërinë për të kryer veprimtaritë profesionale dhe konsiderohet kriter i rëndësishëm për vërtëtimin se një OE mund ta realizojë kontratën me sukses. Për këtë arsye vendoset në kapacitetin teknik.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Kërkesat për “Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në listëpagesat...” për 14 punonjës me diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, dhe 1 (një) inxhinier ndërtimi infratsrukturë transporti,... për: 2 (dy) manovratorë/eskavatoristë; 2 (dy) shoferë për kamiona” me certifikata ose dëshmi përkatëse, nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund ti vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët.

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me pikën 2.3.7 ju informojme se kërkesa për mjetet është vendosur sipas pikës 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe neni 39, pika 6, gërma “d” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Njëpërmjet këtyre kërkesave, OE duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për*

ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga projektuesi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të renda. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shtitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci AK së punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me DT).

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Grupi i auditimit ka analizuar kriteret: **2.3.3, 2.3.5, dhe 2.3.6**, dhe ka konstatuar që nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtoresh dhe mjeteve/makinerive të punës.

Pretendimi i subjektit: Sa i përket kësaj pike në procesverbal është bërë argumentimi gjithashtu ju informojmë se legjislacioni për prokurimet bashkëvepron dhe zbaton gjithashtu dhe detyrimet e përcaktuara në përgjithësi nga legjislacioni shqiptar psh në fushën e sigurimeve shoqërore, tatim taksave etj. Në rastin konkret OE janë të detyruar të zbatojnë legjislacionin që rregullon menaxhimin e mbetjeve (në këtë rast ndërtimore) duke patur parasysh se në preventivin fillestar parashikohen zëra prishjeje e transporti tyre. Kështu në bazë të ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar si dhe VKM nr. 538 datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuara, Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si **grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme**". Në Vendimin nr. 99, datë 18.02.2008 "Për miratimi e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", shtojca 1, përfshirë vetëm mbetjet jo të rrezikshme 17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03. 17 09 04 Mbetje të përziera nga ndërtimet dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03.

Po këtu, në pikën "e" parashikohet se mbetjet jo të rrezikshme të grumbullohen, transportohen dhe transferohen në bazë të rregullave të VKM nr. 229, datë 23.4.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Subjektet që kryejnë aktivitet (në rastin konkret rikonstruksion rrugësh), klasifikohen në subjekt që **gjeneron mbetje urbane** në NJQV ku zhvillojnë aktivitet. OE që ushtron veprimtari në një territor të caktuar, regjistrohet me NIPT-it sekondar (për OE që nuk kanë seli në NJA), nënkupton që subjekti paguan taksat dhe tarifën vendore (si taksë pastrimi, gjelbërimi, tabele etj, sipas ligjit dhe VKB përkatës).

Referuar VKM nr. 538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", në aneksin 1, Kategoria III, Licensimi i veprimtarive të nënkategorive të nënkategorisë III.2.B, në pikën 9. Citohet: "Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme". Çdo operator/familje/individ që gjeneron mbetje urbane është i detyruar të depozitojë në pikat e grumbullit/kontenier dhe jo të trajtojë këto mbetje. Referuar objektit të prokuruar, transporti i materialeve gjatë realizimit të punimeve, mjeteve u nevojitet vetëm: lejen e qarkullimit, certifikatat e pronësisë siguracionin, kolaudimin, certifikatën transporti.

Pretendimi i subjektit: Kjo kërkesë është bërë në përputhje me pikën 1, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" "Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për OE bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale: b) gjendjen

ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, - Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në lidhje me kriterin për paraqitjen e kontratës me një laborator testimi të betonit, nuk është i detyrueshëm para realizimit të punimeve. Mostrimi dhe prova laboratorike e betoneve strukturore për objektet sanksionohet në VKM nr. 679, datë 22.10.2004 “Për miratimin e rregullave teknike për përdorimin e betoneve strukturore”, kjo kërkesë dhe ky dokumentacion duhet të paraqitet nga OE përgjatë fazës së zbatimit të kontratës, për të vërtetuar që artikujt apo mallrat e përdorur janë në përputhje sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. **Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.**

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën e mësipërme për plotësimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar ju informojmë se bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimisht thuhet se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP, dhe në këto rregulla OE ka ngarkuar në system formularin vetpërmbledhës të vetëdeklarimit ku në të shprehet se OE ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe kontributeve. Sa i përket kontratave të deklaruara mund të kenë qënë në nisje të tyre dhe procedurat e regjistrimit mund të jenë në proces.

Përsa më lartë kërkohet rishikimin e pikave të mësipërme sa i përket komisionit të vlerësimit të ofertave.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Është konstatuar që: OE “M.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, si dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. **Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.**

8. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i plotë i shkollës 9-vjeçare, ndërtim i ndërtesës së kopshtit të femijëve, palestrës, terreneve sportive fshati Selvijas, Njësia Administrative Klos”, Bashkia Cërrik.

9/a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i plotë i shkollës 9-vjeçare, ndërtim i ndërtesës së kopshtit të femijëve, palestrës, terreneve sportive fshati Selvijas, Nj.ADM Klos”, REF-75304-07-17-2023		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 177, datë 19.06.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 176/1., datë 19.06.2023 Njësia e Prokurimit 1. D. L., Jurist 2. I. Ç., Ekonomist (Personi përgjegjës) 3. A. D., Inxhinier gjeoteknik	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 177/1, datë 19.06.2023 H. K., Kryetar R. J. Anetar M. Xh. Anetar
2. Lloji i Procedurës “E hapur”		
5. Fondi Limit 83,070,342.08 pa Tvsh lekë.	6. Oferta fituese (80,571,605 lekë pa Tvsh) BOE “M.” Sh.p.k & “Sh.” Shpk	7. Diferenca me fondin limit 2,498,737 leke (pa Tvsh)
8. Data e hapjes së tenderit Datë 02.08.2023. Afati i realizimit të punimeve 65 ditë	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit + buxheti i Bashkise me financim tre vjeçar	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 BOE b) S’kualifikuar 1 BOE ” c) Kualifikuar 1 BOE
11. Ankimime për DT; ska	12. Përgjigje Ankesës ska	13. Përgjigje Ankesës ska

- Për ndërtimin e investimit me objekt: “Rikonstruksion i plotë i shkollës 9-vjeçare, ndërtim i ndërtesës së kopshtit të femijëve, palestrës, terreneve sportive fshati Selvijas, Njësia Administrative Klos”, Bashkia Cërrik.

-Në dosjen e zbatimit nuk ndodhet Oponenca Teknike, në kundërshtim me Ligjin nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe

disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...**”.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, titullari i Bashkisë Cërik, z. A. S..

Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Me Urdhërin nr. 176/1 e nr. 1428/1 prot., datë 19.06.2023 është ngritur komisioni i përlllogaritjes së fondit limit i përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D..

Më datë 19.06.2023 është formuluar/nënshkruar procesverbali nga Komisioni i Përlllogaritjes së Fondit Limiti.

Me Urdhërin e Prokurimit nr. 177 e nr. 1429 prot., datë 19.06.2023 është ngritur Njësia e Prokurimit e përbërë nga: znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D., bashkangjitur formularët e deklaramit të mospasjes së konfliktit të interes.

Njoftimi i shkurtuar i kontratës me nr. 1429/2 prot., datë 17.07.2023, botuar në Buletinin nr. 64 datë 24 korrik 2023 të APP, faqe 19-20/678.

NJP më datë 17.7.2023 ka hartuar/nënshkruar “Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteret për kualifikim”, Bashkangjitur DT.

Ndryshime në DT.

Shtojca për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt: *“Rikonstruksion i plotë i shkollës 9-vjeçare, ndërtim i ndërtesës së kopshtit të fëmijëve, palestrës, terreneve sportive fshati Selvijas, Nj.ADM Klos”* me fond prej 83,070,342.08 (tetëdhjetë e tre milion e shtatëdhjetë mijë e treqind e dyzetë e dy presje tetë) lekë pa Tvsh dhe nr. Reference të procedurës: **REF-75304-07-17-2023.**

Në zbatim të nenit 75 pika 2 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në zbatim të sygjërimeve të kordinimit të APP.

Vlerësimi i kriterëve.

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 neni 21e nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

1. Në pikën 3.3.3. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga MIE, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e OE lidhur me ekzekutimin e puneve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi

- NP-12 B - Punime të inxhinierisë së mjedisit

Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

2. Në pikën 3.3.4. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtoare minimalisht **55 (pesëdhjetë e pesë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, OE duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën prill 2023-qershor 2023, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8.

Shënim: AK do të bejë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi. OE i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, original ose te noterizuar sipas deklaratës së mësipërme përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

3. Në pikën 3.3.7. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: 2.3.5. OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë: - **1 (një) Inxhinier Mjedisi;** - **1 (një) Inxhinier Mekanik;** - **2 (dy) Inxhinier Gjeodet/Topograf;** **5. Në pikën 3.3.6. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar:** “OE ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjësit specialistë të kualifikuar ne profilet perkatëse si më poshtë: - **Teknik Ndërtimi 2 (dy);** - **Teknik Topograf 1 (një);** - **Teknik Hidroteknik 1 (një);** - **Ing. Profili Gjeoteknik 1 (një);** - **Elektriçist 3 (tre);** - **Hidraulik 3 (tre);** - **Karpentierë 2 (dy);** - **Hekurkthyes 2 (dy);** - **Mekanik 1 (një);** - **Murator 2 (dy);** - **Saldator 2 (dy);** - **Pllakashtrues 3 (tre);** - **Hidroizolues 2 (dy);** - **Bojaxhi 3 (tre);** - **Specialist ndërtimi 2 (dy);** - **Manovrator 3 (tre);** - **Shofer 2 (dy);** - **Punonjës/specialist duralumini 2 (dy);** - **Punonjës/specialist sistem ngrohje 2 (dy);** - **Punonjës /Specialist gipsi 2 (dy);**

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).

- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën prill 2023-qershor 2023”, sipas ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe ligji nr. 13/2013.

- Për teknikun e ndërtim, Teknik Hidroteknik dhe teknikun topograf të paraqiten edhe diplomat e shkollës së mesme profesionale ose licencat përkatëse.

- Për Inxhinierin Profili Gjeoteknik të paraqitet diplomë univeristare

Për profesionet si me sipër, OE duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

Për manovratorët të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR. Për manovratorin të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia e aftësisë profesionale lëshuar nga DPSHTRR. (Në rastin kur punonjësit e mësipërm janë të kontraktuar me kontratë pune respektivisht për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

6. Në pikën 3.3.9. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

a- OE duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

Në pikën 3.3.10. të Kapacitetit teknik në DT është kërkuar: OE pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	copë 2
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 ton	në pronësi ose me qira	copë 2
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3-5 ton	në pronësi ose me qira	copë 2
4	Kamioncine me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton	në pronësi ose me qira	copë 1
5	Kamion me Vinc	në pronësi ose me qira	copë 1
6	Koke Terheqese per Rimorikator	në pronësi ose me qira	copë 1
7	Rimorikator	në pronësi ose me qira	copë 1
8	Fadrome me Goma	në pronësi ose me qira	copë 1
9	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	copë 2
10	Mini fadrome	në pronësi ose me qira	cope 1
11	Autobot uji	në pronësi ose me qira	copë 1
12	Autobeniere	në pronësi ose me qira	copë 2
13	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	copë 1

14	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	copë 2
15	Pompa Suvatimi	në pronësi ose me qira	copë 2
16	Tranxhe per prerjen e kthimin e hekurit	në pronësi ose me qira	cope 1
17	Skeleri	në pronësi ose me qira	min 300 m2
18	Greider	në pronësi ose me qira	copë 1
19	Autobetoniere me kapacitet 2-3m3	në pronësi ose me qira	copë 1
20	Rul vibrues minimumi	në pronësi ose me qira	copë 1
21	Pajisje niveluese per nivelim shtresash	në pronësi ose me qira	copë 2
22	Gjenerator	në pronësi ose me qira	copë 1
23	Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qira	copë 1

Referuar punimeve të përfshira në preventiv, rezulton se kërkesat për: **4 (katër) kamio, 3 (tre) kamioçina, 1 (një) Rimorkio për transport mjetesh, 1 (një) Rimorikator, 1 (një) rul me vibrim; 1 (një) grejder;**; (një) **Rul vibrues minimumi** nuk janë të domosdoshëm për realizimin e kontratës.

Për sa trajtuar më sipër, kriteret: **2.3.5, 2.3.7, dhe 2.3.10, (referuar dhe realizimit të punimeve 65 ditë)** nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirë argumentuar dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë e ngarkojnë me përgjegjësi **anëtarët e NJHDT: znj. D. L., znj. I. Ç. dhe z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit.**

Vlerësimi i procedurës së prokurimit:

Me Urdhërin e nr. 177/1 e nr. 1429/1 prot., datë 19.06.2023 është krijuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga: z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh..

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka formuluar/nënshkruar procesverbalin e datës 02.08.2023 për paraqitjen e ofertave në SPE, ku është konstatuar se kanë shfaqur interes:

1. BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk (me Nipt-e respective: 2.....C & K.....N), me vlerë ekonomike të ofertës **80,571,605 [tetëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nje mijë e gjashtëqind e pesë] lekë pa Tvsh**

2. BOE “2.” Shpk & “I.” Shpk (me Nipt-e respektive L.....L& J.....Ë) me vlerë ekonomike të ofertës **71,000,000 (shtatëdhjetë e një milion) lekë pa Tvsh**

Më datë 18.08.2023 KVO ka verifikuar dokumentacioni e dy BOE të paraqitura në SPE, ku është konstatuar që: Dokumentacioni i paraqitur nga **BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk** janë në përputhje me kërkesat ligjore për kualifikim.

Konstatohet qe dokumentacioni i paraqitur nga BOE “2.” Shpk & “I.” Shpk, nuk janë në përputhje me kërkesat ligjore për kualifikim.

Formulari i njoftimit të publikimit të kontratës së nënshkruar fituesit me nr. 1995/1 prot., datë 14.09.2023, shpallur në Buletinin nr. 78 datë 18 Shtator 2023 të APP në faqet 436-437/548.

Referuar marrëveshjes (Për bashkimin e përkohëshëm të shoqërive), më datë 01.08.2023.

Palët bien dakort që **OE “M.” Shpk** me administrator **z. E. B.**, merr përsipër kryesimin dhe përfaqësimin e BOE.

OE “M.” Shpk do të realizojë **75 %** të punimeve, sipas ndarjes bashkangjitur duke patur parasysh kapacitetin teknik, organizativ të sipërmarrjes.

OE “Sh.” Shpk do të realizojë **25 %** të punimeve, sipas ndarjes bashkangjitur duke patur parasysh kapacitetin teknik, organizativ të sipërmarrjes.

Lidhur me BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, nga auditimi rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, rezulton se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DT duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Për sa trajtuar më sipër BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. KVO dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor të shpallte fitues BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, por anulimin e procedurës së prokurimit publik, për arsye se asnjë nga OE nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

Mos disponimi, apo mosparaqitja e dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

Konkluzioni: Procedura e prokurimit paraqet parregullsi në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet vendosje e kriterëve jo në përputhjen me tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e OE në garë. Gjithashtu, parregullsi ka edhe në shpalljen fitues të BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, pasi nuk plotëson të gjitha kriterëve e DT, veprime këto në kundërshtim të dispozitave ligjore të LPP. Në këtë rast KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdorim më efektiv të fondit me vlerë **80,571,605 lekë** pa Tvsh.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. A. S. Kryetar i Bashkisë Cërrik në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, z. T. Z. (person i autorizuar) znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe z. H. K., znj. R. J. e znj. M. Xh. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur : Komente mbi Projekt Raportin e Auditimit/observacionet me shkresën nr. 1138/1 prot., datë 20.05.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 190/4 prot., datë 23.05.2023, nga znj. D. L., znj. I. Ç. e z. A. D. anëtarë të Njësisë së Prokurimit, z. H. K., znj. R. J. dhe anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën e mësipërme ju informojmë se është kryer argumentimi dhe kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe Neni 39, pika 6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar si dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” pikat e licencës dhe kategoritë me klasifikimet përkatëse caktohen duke u mbështetur në punimet e parashikuara në preventivin e objektit dhe në vlerën totale të punimeve për secilën kategori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojë se disponojë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) realizohet para fillimit të procedurës së prokurimit dhe është pjesë integrale e projektit të objektit. Vlerësimi i një vepre publike ose me interes publik, do të thotë edhe gjykimi i vlerës së saj në perspektivën e interesit kolektiv. Pra një objekt nuk prokurohet pa u zgjidhur problematikën e ndikimit

në mjedis. Ju në asnjë rast nuk përmendni se kush janë **punimet e parashikuara në preventivin e objektit** që do të realizohen nga Ing. Mjedisi.

Pretendimi i subjektit: *Sa më sipër ju informojmë se kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 55 punonjësish, për të paktën 3 muajt e fundit është në zbatim të nenit 77, pika 4 e LPP, dhe nenit 39, pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikimet e kontratës. Në përlllogaritjen e numri të punonjësve, NJP ka marrë parasysh numri i punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në DT, për periudhën 65 ditë, ku në zbatim të nenit 77, pika 4 e LPP dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që do të paraqiten nga OE pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numri të punonjësve përfshihen inxhinierët, specialistët, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj, duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e lartë të punimeve.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në dosjen e prokurimit nuk gjendet asnjë dokumentacion ku pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtorë dhe mjeteve/makinerive të punës. Kërkesat për 55 (pesëdhjetë e pesë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, eskavatoriste dhe shofere, stafi teknik), nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund të vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët. Sa më sipër: nuk është argumentuar me grafikun e punimeve dhe volume sipas preventivit kërkesa për numrin e fuqisë punëtorë që duhet për realizimin e objektit.

Pretendimi i subjektit: *Në lidhje me pikën e mësipërme ju informojmë se ju informojmë se për të përcaktuar stafin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, bazuar në përlllogaritjen e orëve të punës, kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zërave të punimeve, të cilat lidhen ngushtësisht me listën e stafit teknik të kërkuara nga.*

Është kërkuar gjodet/topograf, pasi sipas relacionit teknik dhe specifikimeve, është parashikuar se kontraktori që do të marrë përsipër zbatimin e objektit inxhinierik, duhet të bëjë dendësumin e pikavetë bazamentit, duke realizuar vlerat e paracaktuara të dhëna në specifikimet teknike të objektit, në lidhje me saktësinë e realizimit të piketimit të piketimit. Nga shoqëria kërkohet dhe një azhurnim i saktë i këtij investimi në përfundim.

Është kërkuar inxhinier mjedisi, pasi ai është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të ndërtohet për secilin nga zërat e punimeve të mjedisit. Zbatimi i projektit nuk duhet të ketë pasoja negative në mjedisin e zonës. Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të zhurmave në mjedis.

Është kërkuar inxhinier elektronik dhe gazrave në ajër, për kanalet e drenazimit të ujërave, rreth perimetrin të zonës së punimeve.

Është kërkuar inxhinier elektronik, pasi ai është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që do të ndërtohet kryesisht punime internet, kamera, system automaatizimi pompa et.

Është kërkuar inxhinier mekanik, pasi ai është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike siç janë punimet e ngrohjes ftohjes, punime konstruksione metalike etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Pretendimi juaj nuk qëndron ligjërisht dhe teknikisht, pasi nuk ka asnjë analizë çmimi për zërat e punimeve që përfshihen në preventive, ku të përfshihet nevoja për inxhinier mekanik apo mjedisi (s qaruar më lartë). (ju nuk sqaroni përse duhen dy ing. gjodet/topograf). Në lidhje me mirëmbajtjen e mjeteve nuk është çështje e AK por e OE që realizon punimet. Observacioni juaj pranohet (me rezervë) në lidhje me **inxhinier elektronik** dhe reflektohet në materialin e auditimit

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën e mësipërme ju informojmë se është kryer argumentimi në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“, të

ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë një listë personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe lose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion OE për të përmbushur kontratën.

Sa më lart sipas punimeve pjesë e preventivit fillestar janë përcaktuar dhe personeli i kualifikuar si më poshtë:

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Kërkesat për “*Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në listëpagesat...*” për 45 punonjës me diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor,” me certifikata ose dëshmi përkatëse, nuk është pjesë e kriterëve që vërtetojnë eksperiencën të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme apo qëndrueshmërinë ekonomike e financiare të ofertuesit. Aq më tepër që mjetet mund t'i vihen në dispozicion (me qera) së bashku me manovratorët/shoferët.

Grupi i auditimit ka analizuar kriteret: **2.3.5, 2.3.7, dhe 2.3.10, dhe ka konstatuar që** nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

Pretendimi i subjektit: Për sa më sipër ju informojmë se: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.1 62/2020 “Për prokurimin publik” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për OE, bazuar në: aftësinë teknike dhe profesionale; Për sai përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që OE të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore, mund të vendosin kërkesa që garantojnë se OE zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se: AK gjykon se OE pjesëmarës, duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate, në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, NJP ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se OE i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. NJP përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE dhe të mundësisë së tyre, për përmbushjen me sukses të kontratës.

ISO 14001 është Certifikimi i Memaxhimit të Mjedisit. Me fjalë të tjera, vazhdimi i aktiviteteve në një zonë prodhimi; Ai përfshin shumëllojshmërinë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve dhe njerëzve dhe ndërlidhjen e tyre. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbalohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi te konsumatori. ISO 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Popullisia gjithnjë në rritje e botës, kënaqësia dhe shpejtësia e progresit teknologjik, shkurtimi i jetës njerëzore, shkatërrimi i mjedisit ekologjik, zhurmat e forta dhe të dhunshme, zbatimi jo i plotë, mungesa e njohurive dhe faktorët që ndikojnë negativisht në më shumë se një mjedis që do të shtohet kohët e fundit dhe janë faktorët kryesorë që kërcënojnë standartet e jetesës.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Grupi i auditimit i është referuar certifikatës **ISO 14001:2015** (Sistemet e menaxhimit mjedisor) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga RSH, *pasi efektet direkte indirekte të një projekti janë të ezauruar në fazën e realizimit të VNM.* Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.

Grupi i auditimit ka analizuar kriteret: **2.3.5, 2.3.7, dhe 2.3.10, dhe ka konstatuar që** nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish për asrye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrumin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën e mësipërme ju informojme se është kryer argumentimi dhe këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj NJP vendosi që të kërkojë që OE të disponojn mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjestim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Nunri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci AK se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar ligjvënësi i jep të drejtën AK të kërkojë nga ana e OE dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. NJP ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që OE disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cënuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, objekti ka një shtrirje të konsiderueshme gjeografike, prandaj do të punohet në disa fronte pune njëkohësisht, për të kapur afatet e përcaktuara. Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, NJP vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, OE u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në lidhje me 4 (katër) kamio, 3 (tre) kamioçina, 1 (një) Rimorkio për transport mjetesh, 1 (një) Rimorikator, 1 (një) rul me vibrim; 1 (një) grejder;); (një) Rul vibrues minimumi ju nuk jepni asnjë argumentim tekniko - ligjor

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën e mësipërme për plotësimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar ju informojmë se bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku shprehimisht thuhet se :”Bashkë me dorëzinnin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, AK pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla” OE ka ngarkuar në sistem fomularin vetëpërmbledhës të vetdeklarimit ku në të shprehet se OE ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe kontributeve. Sa i përket kontratave të deklaruara mund të kenë qënë në nisje të tyre dhe procedurat e regjistrimit mund të jenë në proces.

KVO ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga OE në bazë të kontratave përkatëse ku konstatohen dhe emërtime përkatëse.

• Përsa. më lartë kërkojmë rishikimin e pikave të mësipërme sa i përket KVO.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Është konstatuar që: OE “Z.” Shpk & “V. K.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, si dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte skualifikuar. **Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit, pasi nuk qëndrojnë dhe do të trajtohen në raportin e auditimit.**

- **Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për blerjet e vogla.**

Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2023 janë zhvilluar 24 procedura prokurimi me vlerë të vogël me fond limit pa tvsh për vlerën prej 20,395 mijë lekë, dhe vlerën e kontratës prej 17,120 mijë lekë (83.9% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 3,275 mijë lekë.

Për vitin 2023, është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Personi i Autorizuar prej tij me nr. 544 dhe nr. Prot., datë 3609, datë 30.12.2022 me përbërje si vijon:

1. Zj. I. Ç. – Kryetar
2. Zj. D. L. – Anëtar
3. Z. A. D. – Anëtar

Për periudhën 01.01.2023, janë realizuar 24 procedura blerje të vogla me fond limit 20,395 mijë lekë dhe vlerë kontrate 17,120 mijë lekë⁴.

Janë audituar 11 procedura prokurimi “blerje të vogla” me fond limit 9,965,490 lekë dhe vlerë kontrate 8,473,400 lekë me një ulje prej 15%.

-Në të gjitha rastet e testuara, konstatohet mungesa e kërkesës nga sektori përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi;

-Nga auditimi ka rezultuar se në 8 raste, hartimi i fondit limit është kryer nëpërmjet testimit të tregut, ku është mbajtur procesverbali përkatës. Nga ky testim, rezulton se është cituar oferta e marrë, por mungojnë treguesit e këtyre ofertave, në kundërshtim me paragrafin e fundit të pikës 7 të Udhëzimit Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, e cila përcakton se *Në rastet kur, në përlllogaritjen e fondit limit përdoret metoda e testimit të tregut, nuk është e domosdoshme të administrohen ofertat e marra në kuadër të këtij procesi, por vetëm treguesit e çmimeve, të cilat dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga KBV.*

-Në të gjitha rastet rezulton se është vendosur fondi limit në urdhrin e prokurimit, veprim në kundërshtim me paragrafin e fundit të pikës 8 të Udhëzimit Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, e cila përcakton se *Në këtë urdhër nuk do të përcaktohet fondi limit për objektin e kontratës.*

-Në ftesën për ofertë, rezulton se në 8 raste është vendosur si kriter kërkesa që OE të disponojnë licencë për objektin e prokurimit. Lidhur me këtë kërkesë, rezulton e pa plotë, duke mos përcaktuar se çfarë dokumenti duhet të kërkohej për të përcaktuar llojin e licencës së kërkuar, kjo në kundërshtim me pikën 2 të neni 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet “..... Në çdo rast, Autoriteti/ Enti Kontraktor, duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

-Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE, ka rezultuar në 3 raste mungesë e dokumenteve sipas ftesës për ofertë. Konkretisht në procedurën “Marrje mjete me qira për nevojat e Bashkisë Cërrik”, për mjetin me targa AA661CN në pronësi të subjektit G.Z., nuk përcaktohet mënyra e disponimit të këtij mjeti nga ofertuesi “E.SA.” shpk. Mungon leja e qarkullimit për këtë mjet, ku të përcaktohet njëkohësisht edhe numri i akseve të këtij mjet.

Në procedurën me objekt “Blerje dru zjarri për Bashkinë Cërrik”, subjekti fitues K. P., nuk ka paraqitur të plotë dokumentacionin sipas ftesës për ofertë, dhe konkretisht vërtetimin e lëshuar nga OSHEE për likuidimin e detyrimeve të energjisë elektrike.

Në procedurën me objekt “Blerje pelet për kaldajat e Bashkisë Cërrik, pjesa II”, subjekti fitues A. K., nuk ka paraqitur të plotë dokumentacionin sipas ftesës për ofertë, dhe konkretisht certifikata ISO 9001: 2015, nuk ka objekt aktiviteti materialet e peletit.

-Nga auditimi për likuidimin e urdhër shpenzimeve për këto blerje, ka rezultuar në 7 raste të jetë kryer likuidimi përtej afatit 30 ditor në mosrespektim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 në të cilën përcaktohet se: “Nëpunësit zbatues të njësisve shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për

⁴ Tabela me blerjet e vogla në Aneksin nr. 7

rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”.

Si konkluzion, rezulton se veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me nenin 41, pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 7 dhe 8, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52.

Kjo ka ardhur për shkak të neglizhencë së Komisionit për Blerje e Vogla për përcaktimin e treguesve të çmimit në përllogaritjen e fondit limit dhe në vendosjen e pa plotë të kërkesës për licenca në ftesën për ofertë.

Vendosja e pa plotë të kriterit për licencat mund të sjellë konfuzion në ofertimin dhe vlerësimin e ofertave dhe dokumentacionit që paraqitet.

Për veprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Blerjeve të Vogla.

2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Në zbatim të Programit të Auditimit në Bashkinë Cërrik, nga audituesit e KLSH-së u krye auditimi me objekt: “*Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik*”. Nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit të përputhshmërisë 01.07.2021 deri me datën 31.12.2021.

Për periudhën e auditimit në Bashkinë Cërrik u audituan **5** (pesë) dosje/objekte të prokuruar (Tabela në vijim), në vlerën totale të kontratave **226,297,757.30 lekë me Tvsh**, mbi zbatimin e kontratave për punë publike.

Tabela: Objekte të prokuruarra për punë publike.

Nr	Objekti	Kontraktori Sipërmarrës	Vlera e kontratës meTVSH
Viti 2021 (01.07.2021 – 31.12.2021)			
1	Rikonstruksion i rrugës së Çapallarëve dhe Veshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, fshati Licaj	OE “Z.” Shpk	58,862,977.80
2	Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar	OE “V. H.” Shpk	39,032,808
3	Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej	BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk	57,999,999.60
4	Rikonstruksion rrugësh në Njësinë Administrative Gostime	OE “A.” Shpk	40,401,971.90
5	Rikonstruksion i rrugës së Delijve dhe Xhamisë së fshatit Selvijas	OE “B.” Shpk	30,000,000
Shuma në lekë me TVSH			226,297,757.30

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u konstatua si vijon:

1. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Çapallarëve dhe Veshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, fshati Licaj”, Bashkia Cërrik me këto të dhëna:

1/b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstruksion i rrugës së Çapallarëve dhe Veshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, fshati Licaj”, Njësia Administrative Shalës”, Bashkia Cërrik.		
14. Lidhja e kontratës Nr. 3519 prot., datë 20.12.2022.	15. Vlera e kontratës (pa tvsh) 49,052,481.15lekë OE fitues OE “Z.” Shpk	16. Likuiduar lekë lekë
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 58,862,789.48 lekë -Vlera pa tvsh 49,052,324.57 lekë	18. Afati I kontratës në dite Parashikuar 120 ditë, Zbatuar ditë. Fillim i punimeve: 23.02.20223 22.06.2023 Përfundim i punimeve: 18.09.2023	19. Zgjatja e kontratës: nr. 494/3 prot., datë 22.05.2023. 120 ditë

20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "Z." Shpk	Licenca Nr: MK 3360/3 Datë 26.10.2022	Kontrata nr. 3520prot., datë 20.12.2022.	Vlera e Kontratës (me Tvsh) 871,417.20 lekë	Likujduar (me Tvsh) 0.0 leke
21. Kolaudatori i punimeve Emri Mbiemri: N. M.	Licenca Nr: MK. 0992/3, datë 23.04.2019	Kontrata nr. 494/5 prot.. date 25.09.2023	Vlera e Kontratës (me Tvsh) 60,000 lekë	Likujduar (me Tvsh)lekë
22.Akt Kolaudimi Datë .	23.Akt i marrjes në dorëzim datë . 17.07.2023			

-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume punë ndërtimi në vlerën **139,125 lekë pa Tvsh.**

Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksion i rrugës së Çapallarëve dhe Veshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, fshati Licaj", Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve OE "Z." Shpk, për zërat e punimeve A. 3.1; B. 3.4.

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "F.V. Bordura betoni 15x30cm", "Mur me blloqe betoni t=20cm deri 3m me llaç përzier M 15", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3519 prot., datë 20.12. 2022.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3520 prot., date 20.12.2022.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 494/5 prot., datë 25.09.2023.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "Rikonstruksion i rrugës së Çapallarëve dhe Veshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, fshati Licaj", Bashkia Cërrik u konstatua:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 23.02.2023 dhe duhet të përfundonin më datë 22.06.2023 në bazë të objekteve specifike ku kryhen punimet.

Është bërë amendimi i kontratës me nr. 494/3 prot. datë 22.05.2023 ku përfundimi i punime do të jetë më datë 18.09.2023.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 23.02.2023, sipas të cilit "...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...".

Punimet kanë përfunduar më datë 18.09.2023 sipas afateve të parashikuar në amendamentin e kontratës. Garancia e punimeve është 12 muaj.

-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume pune ndërtimi në vlerën **139,125 lekë pa Tvsh.**

2. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar”, Bashkia Cërrik me këto të dhëna:

2/b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar”, Bashkia Cërrik.				
14. Lidhja e kontratës Nr. 354 prot., datë 03.02.2023.	15. Vlera e kontratës (pa tvsh) 32,527,340 lekë OE fitues OE “V. H.” Shpk		16. Likuiduar lekë 7,073,952 lekë	
17. Situacioni Përfundimtar datë -Vlera 39,030,479.88 me tvsh lekë -	18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 90 ditë. Fillim i punimeve: 02.03.2023 04.05.2023 Përfundim i punimeve: 04.05.2023		19. Zgjatja e kontratës	
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “Z.” & “Z.” Shpk	Licenca Nr: MK 3360/3 MK 1208/14	Kontrata nr. 354/1 prot., datë 03.02.2023.	Vlera e Kontratës (me Tvsh) 623,916 lekë	Likuiduar (me Tvsh) lekë
21. Kolaudatori i punimeve Emri Mbiemri: L. K.	Licenca Nr: MK.0068/3	Kontrata nr. 623/9 prot., datë 07.06.2023	Vlera e Kontratës (me Tvsh) 66,600 lekë	Likuiduar (me Tvsh) Xxxxx lekë
22. Akt Kolaudimi Datë	23. Akt i marrjes në dorëzim datë 16.07.2023			

-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume punë ndërtimi në vlerën **157,906 lekë pa Tvsh**.

Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar”, Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve OE “V. H.” Shpk, për zërin e punimeve 4.1.

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërin e punimeve: “Mbushje me zhavorr pas mureve”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfutuar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 354 prot., datë 03.02.2023.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 354/1 prot., date 03.02.2023.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 623/9 prot., datë 07.06.2023.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar”, Bashkia Cërrik u konstatua:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 02.03.2023 dhe më datë 04.05.2023 në bazë të objekteve specifike ku kryhen punimet.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 02.03.2023 sipas të cilit “...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...” dhe kanë përfunduar në datë 04.05.2023.

Garancia e punimeve është 12 muaj.

-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume punë ndërtimi në vlerën **157,906 lekë pa Tvsh**.

3. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej”, në kuadër të procesit të rindërtimit”, Bashkia Cërrik, me këto të dhëna:

b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej”, Bashkia Cërrik.				
14. Lidhja e kontratës Nr. 203 prot., datë 19.01.2022.	15. Vlera e kontratës (pa tvsh) 48,333,333 lekë BOE fitues BOE “M.” Sh.p.k & “Sh.” Shpk		16. Likuiduar lekë 8,000,000 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar datë -Vlera 57,772,572 me tvsh lekë -Vlera pa tvsh 48,143,810 lekë	18. Afati I kontratës në dite Parashikuar 4 muaj, Zbatuar 4 muaj. Fillim i punimeve: 22.11.2022 25.11.2022 Përfundim i punimeve : ne zbatim		19. Zgjatja e kontratës	
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “Z.” Shpk & “Z.” Shpk “	Licenca Nr: MK.3360/3 MK. 1208/14	Kontrata nr. 227 prot., datë 19.01.2023.	Vlera e Kontratës (me Tvsh) lekë	Likuiduar (me Tvsh) leke
21. Kolaudatori i punimeve Emri Mbiemri: N. M.	Licenca Nr:	Kontrata nr. 227/1 prot., datë 14.09.2023	Vlera e Kontratës (me Tvsh) 99,600 lekë	Likuiduar (me Tvsh) lekë
22. Akt Kolaudimi Datë	23. Akt i marrjes në dorëzim datë 17.07.2023			

-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume punë ndërtimi në vlerën **161,280 lekë pa Tvsh**.

Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej”, në kuadër të procesit të rindërtimit”, Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve BOE“M.” Shpk & “Sh.” Shpk, për zërat e punimeve A.6.2, C. 3.2 D. 3.2.V\

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërin e punës:, “Struktura monolite betony C 16/20 për kunetë dhe fiksimin e bordurës”, , për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 203 prot., date 19.01.2023.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 227 prot., date 19.01.2023.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 227/1 prot., datë 14.09.2023.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej”, në kuadër të procesit të rindërtimit”, u konstatua:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 23.02.2023 dhe më datë 22.06.2023 duhet të përfundonin në bazë të objekteve specifike ku kryhen punimet.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 23.02.2023., sipas të cilit “...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...”.

-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume punë ndërtimi në vlerën **161,280 lekë pa Tvsh**.

4. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Njësinë Administrative Gostime”, Bashkia Cërrik, me këto të dhëna:

4/b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstruksion rrugësh në Njësinë Administrative Gostime”, Bashkia Cërrik.				
14. Lidhja e kontratës Nr. 13 prot., datë 06.01.2023.	15. Vlera e kontratës (pa tvsh) 33,668,309.96 lekë OE fitues OE “A.” Shpk		16. Likuiduar lekë 9,457,003 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar datë -Vlera me tvsh 40,401.971.96 lekë -Vlera pa tvsh 33,668,309.97lekë	18. Afati I kontratës në dite Parashikuar 4muaj, Zbatuar 5 muaj Fillim i punimeve: 17.02.2023 05.05.2023 Përfundim i punimeve: 16.07.2023		19. Zgjatja e kontratës	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “Z.” Shpk	Licenca Nr: MK. 3360/3 Datë 26.10.2022	Kontrata nr.13/1 prot., datë 06.01.2023.	Vlera e Kontratës (me Tvsh) 688,549.2lekë	Likuiduar (me Tvsh) leke
21. Kolaudatori i punimeve Emri Mbiemri: L. K.	Licenca Nr: MK. 0068/3, datë 19.05.2020	Kontrata nr. 17/7 prot., date10.07.2023.	Vlera e Kontratës (me Tvsh) 72,000 lekë	Likuiduar (me Tvsh) Xxxxxlekë
22. Akt Kolaudimi Datë	23. Akt i marrjes në dorëzim datë16.07.2023			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume punë ndërtimi në vlerën **128,842 lekë pa Tvsh**.

Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Rikonstruksion rrugësh në Njësinë Administrative Gostimë”, Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve OE “A.” Shpk, për zërat e punimeve A. 3.6, B. 6.4..

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës: “Shtresë stabilizanti t=7cm për bankina”, “Pusetë b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 13 prot., datë 06.01. 2023.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 13/1 prot., date 06.01.2023.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 17/7 prot., datë 10.07.2023.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Njësinë Administrative Gostime”, u konstatua:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 22.11.2022 dhe më datë 25.11.2022 në bazë të objekteve specifike ku kryhen punimet.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 22.11.2022 dhe në datë 25.11.2022., sipas të cilit “...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...”.

Është bërë amendimi i kontratës me nr. 13/1 prot., datë 06.05.2023 ku përfundimi i punime do të jetë më datë 18.09.2023.

Punimet kanë përfundura më datë 18.09.2023 sipas afateve të parashikuar në amendamentin e kontratës. Garancia e punimeve është 12 muaj.

-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume punë ndërtimi në vlerën **128,842 lekë pa Tvsh.**

5. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Delijve dhe Xhamisë së fshatit Selvijas”, Bashkia Cërrik.

b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Rikonstruksion i rrugës së Delijve dhe Xhamisë së fshatit Selvijas” Bashkia Cërrik				
14.Lidhja e kontratës Nr. 341 prot., datë 01.02.2023.	15.Vlera e kontratës (pa tvsh) 25,000,000lekë OE fitues OE“ B.” Shpk		16. Likuiduar lekë 5,000,000 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar datë -Vlera me tvsh 30,000,000 lekë -Vlera pa tvsh 25,000,000 lekë	18.Afati I kontratës në dite Parashikuar 4 muaj, Zbatuar 4 muaj. Fillim i punimeve: 01.03.2023 05.06.2023 Përfundim i punimeve 05.06.2023		19. Zgjatja e kontratës	
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “Z.” Shpk	Licenca Nr: MK 2463/7	Kontrata nr. 342 prot., datë 01.02.2023.	Vlera e Kontratës (me Tvsh) 529,082.40 lekë	Likuiduar (me Tvsh) leke
21. Kolaudatori i punimeve OE “A.” Shpk	Licenca Nr: MK 2463/7	Kontrata nr. 1364/2 prot., datë 06.07.2023	Vlera e Kontratës (me Tvsh) 96,000 lekë	Likuiduar (me Tvsh) lekë
22.Akt Kolaudimi Datë 10.07.2023	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 19.07.2023			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume punë ndërtimi në vlerën **114,432 lekë pa Tvsh.**

Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Rikonstruksion i rrugës së Delijve dhe Xhamisë së fshatit Selvijas”, Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve Operatori Ekonomik “B.” Shpk, për zërat e punimeve: 7-2, 8-3.1 dhe B-5.

Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Mbushje me zhavorr pas mureve”, “Pusetë b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize” e “Struktura monolite betoni C 20/25,

portal, puseta”, për pasojë vlere e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 341 prot., datë 26.09. 2022.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit 354/1 prot., datë 03.02.2023.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1364/2 prot., datë 06.07.2023.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dosjes teknike dhe i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Delijve dhe Xhamisë së fshatit Selvijas”, u konstatua:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 01.03.2023 dhe më datë 05.06.2023, kanë përfunduar në bazë të objekteve specifike ku kryhen punimet.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën dhe në datë 05.06.2023 sipas të cilit “...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lire dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...”.

Punimet janë në proces zbatimi sipas afateve të parashikuar në kontratë. Garancia e punimeve është 12 muaj.

-Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume punë ndërtimi në vlerën **114,432 lekë pa Tvsh**.

2.5 Mbi organizimin, funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Për periudhën objekt auditimi, nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bashkia Çërrik janë miratuar 28 leje ndërtimi⁵, nga të cilat 6 leje ndërtimi janë për objekte mbi 250 m², dhe 20 leje janë për objekte nën 250 m², dhe 2 leje janë për rikonstruksion për ndryshim funksioni. TNI e arkëtuar për lejet e mësipërme është në vlerën 3,594 mijë lekë.

Nga auditimi i lejeve të ndërtimit për periudhën objekt auditimi, në 8 raste janë evidentuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur për lejet e ndërtimit si më poshtë:

1. Sipas regjistrit elektronik nr. 3024 me nr. Aplikimi AN251020220088 në emër të zhvilluesit E. M., me datë aplikimi 05.10.2022, për objektin: “Fabrikë për prodhimin e vajit nga ulliri”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

1.Plani i riveimit është në shkallën 1:1200, ndërkohë duhet të jetë 1:1500, në kundërshtim me pikën 1, germa (ç) të nenit 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar.

2. Sipas regjistrit elektronik nr. 297 dhe nr. Aplikimi AN050420230040, në emër të zhvilluesve B. S. dhe Rr. S., me datë aplikimi 05.04.2023, për objektin: “Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri”.

⁵ Tabela me lejet e ndërtimit për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 në aneksin nr. X.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

a. Raporti i vlerësimit në mjedis (V.N.M) nuk është miratuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në kundërshtim me ligjin 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” Shtojca II: pika 10 “Prodhime infrastrukturore” (a) **Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale.**

b.Mungon projekti dhe relacioni i instalimeve të ngrohje – ftohjes, në kundërshtim me nenin 15, pika 1/1, germa (iii) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar.

d.Lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, ajo është përlllogaritur gabim nga personat përgjegjës. Konkretisht, sipas njoftimit me nr. 970/4 prot., datë 04.05.2023, vlera e TNI e përlllogaritur është 210,516 lekë, bazuar në preventivin e punimeve në vlerën 10,525,813 x 2%. Nga shqyrtimi i preventivit të ngarkuar në sistem, rezulton se ai është më i lartë, konkretisht 14,651,461 lekë x 2% TNI sipas tipologjisë së objektit bazuar në paketën fiskale të miratuar me vendimin nr. 96, datë 27.12.2022, dhe rezulton vlera totale **293,029 lekë.**

Sa më sipër, diferenca prej 82,513 lekë, përbën të ardhur të paarkëtuar për buxhetin e Bashkisë Cërrik.

3. Sipas regjistrimit elektronik nr. 1866 dhe nr. Aplikimi AN180820230036, në emër të zhvilluesve E. Xh. dhe J. Xh., me datë aplikimi 18.08.2023, për objektin: “Ndërtim magazinë 1 Kat”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

a.Mungon Raporti i Vlerësimit në Mjedis (V.N.M) e cila duhet miratuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në kundërshtim me ligjin 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” Shtojca II: pika 10 “Prodhime infrastrukturore” (a) **Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale.**

b.Polica e sigurimit për inxhinierin gjeodet F. A. është jashtë vlefshmërie nga data 04.03.2023, ndërkohë që aplikimi mban datën 18.08.2023, në kundërshtim me pikën 1 germa (g) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar.

4. Sipas regjistrimit elektronik nr. 1596 dhe nr. Aplikimi AN050720230048, në emër të zhvilluesve J. P. dhe E. P., me datë aplikimi 05.07.2023, për objektin: “Ndërtim objekt banimi 2-kat”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

a.Rezulton se nuk është respektuar intensiteti i ndërtimi. Konkretisht sipas Njesisë Strukturore 2/202, intensiteti i lejuar për ndërtimi është 0.5. Nga verifikimi i projektit rezulton sipërfaqe totale e ndërtimit 261.6 m²/ 500² sipërfaqe e parcelës, nga e cila rezulton se intensiteti i ndërtimit për objektin e ri është 0.52, duke e tejkaluar intensitetin, në kundërshtim me nenin 38, pika 2 të VKM-së 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar.

b.Preventivi i punimeve rezulton i pa plotë, duke mos pasqyruar zërin e prishjes së objektit ekzistues, duke sjell ulje të preventivit, në kundërshtim me pikën 1 germa (dh) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar.

5. Sipas regjistrimit elektronik nr. 809 dhe nr. Aplikimi AN200320230064, në emër të zhvilluesve N. Z. dhe E. Z., me datë aplikimi 20.03.2023, për objektin: “Banesë 2 kat”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

a.Mungon leja e zhvillimit në kundërshtim me nenin 15, pika 1 germa (h) të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar.

b.Preventivi i punimeve rezulton i pa plotë, duke mos pasqyruar zërin e prishjes së objektit ekzistues, duke sjell ulje të preventivit, në kundërshtim me pikën 1 germa (dh) të nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar.

6. Sipas regjistrimit elektronik nr. 971 dhe nr. Aplikimi AN050420230121, në emër të zhvilluesve S. D. dhe A. D., me datë aplikimi 05.04.2023, për objektin: “Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

a.Mungon Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis. Është paraqitur një raport, si dhe është administruar mendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e cila përcakton se ky projekt **duhet t'i nënshtrohet procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**, por mungon vendimi nga ky Institucion për vijimin e miratimit të lejes.

7. Sipas regjistrimit elektronik nr. 1151 dhe nr. Aplikimi AN020520230070, në emër të zhvilluesve Th. A. dhe V. A., me datë aplikimi 05.04.2023, për objektin: *“Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri”*.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

a.Mungon Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis. Është paraqitur një raport, si dhe është administruar mendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e cila përcakton se ky projekt **është në proces shqyrtimi për procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**, pra mungon vendimi nga ky Institucion për vijimin e miratimit të lejes.

8. Sipas regjistrimit elektronik nr. 2011 dhe nr. Aplikimi AN140920230019, në emër të zhvilluesve G. A., me datë aplikimi 14.09.2023, për objektin: *“Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri”*.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

a.Mungon Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis. Është paraqitur një raport, si dhe është administruar mendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e cila përcakton se ky projekt **duhet t'i nënshtrohet Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**, pra mungon vendimi nga ky Institucion për vijimin e miratimit të lejes.

Si konkluzion, rezulton se veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nr. VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, neni 10, pika 1, germa (ç), neni 15, pika 1/1, germa (iii), pika 1 germa (g, dh, h), neni 38 pika 2, Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” Shtojca II: pika 10 “Prodhime infrastrukturore” (a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale. Përlllogaritja e gabuar e TNI sjell të ardhura të paarkëtuara për buxhetin e Bashkisë Çërrrik. Miratimi i lejeve pa VNM-të, mbart risk për investimet në raport me kujdesin ndaj mjedisit.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, neni 10, pika 1, germa “ç”, neni 15, pika 1/1, germa “iii”, pika 1 germa “g”, “dh” e “h”, neni 38 pika 2, Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” Shtojca II: pika 10 “Prodhime infrastrukturore” (a) **Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale.**

Për veprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi: F. U. – Drejtor i DPZHT, E. B. dhe S. F. – Kontrollues, A. D. - Nëpunës.

2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtës së Territorit.

Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga Sektori Juridik dhe i Burimet Njerëzore, në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*. Në strukturën aktuale, IMTV ka në përbërje 3 pozicione pune, nga të cilët 1 Kryeinspektor dhe 2 inspektor.

-Për periudhën objekt auditim 01.01.2023 deri 23.12.2023, IMTV është drejtuar nga K/inspektor F. Q., i cili rezulton me arsim për Shkenca Politike.

Inspektorët që kanë punuar dhe punojnë gjatë kësaj periudhe janë K. M. me arsim juridik, dhe S. Sh. me arsim për inxhinieri elektronike.

Për sa më sipër, konstatohet se IMTV Bashkia Çërrrik, përgjatë periudhës objekt auditimi, ka funksionuar me një pjesë të stafit në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007

“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i cili përcakton se: Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit

Kryeinspektori dhe njëri nga inspektorët e cituar më sipër, nuk kanë arsimimin e duhur për të ushtruar detyrën e K/inspektorit dhe atë të inspektorit. Mungesa e stafit të kualifikuar, sidomos atij inxhinierik përbën mungesë cilësore për mbarëvajtjen e punës së inspektoratit, pasi nuk kanë kualifikimet e nevojshme për të kryer akte kontrolli apo për të përcaktuar dhe përshkruar teknikisht situatat e konstatuara gjatë inspektimit.

-Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, janë mbajtur 6 akte konstatimi për punime pa leje, për të cilat rezulton të jetë lëshuar 6 vendime me gjobë në vlerën 1,550,000 lekë, 4 vendime për prishje, dhe asnjë vendim pezullimi.

Akt Konstatimet për punime pa leje 01.01.2023 – 31.12.2023

Nr	Emri I subjektit Vendndodhja Njoftimi	Proçes-verbal “Për Konstatimin e Kundërvajtjes ” me Numër Serie	Arsyeja	Vendim “Për Dënimin me Gjobë” me Numër Serie + Vlera gjobës	Vendim Për Prishjen e Objektit të Kundërligjsh ëm me Numër Serie	Njoftim për shlyerje detyrimi	Kërkesë për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit
1	R. P., Gjyralë, Gostimë, Njoftim Nr.88 Prot, datë:11.01.2023	Nr.0059, datë:09.01.202 3	Ndërtimi i mureve mbajtëse	Nr.0037, datë:11.01.2023 150,000	Nr.0040, datë:11.01.20 23	Nr.extra Prot, datë:17.02.20 23	Nr.1377 Prot, datë:08.06.2 023 (Dërguar)
2	N. D. Selitë Mollas, Njoftim Nr.967/1 Prot, datë:06.04.2023	Nr.0060, datë:29.03.202 3	Ndërtimi i çatisë së pashfrytëzuesh me	Nr.0038, datë:05.04.2023 100,000	---	Nr.1065 Prot, datë:25.04.20 23	Nr.1556 Prot, datë:29.06.2 023 (Dërguar)
3	T. Sh., Qyrkan Klos, Njoftim Nr.1353 Prot, datë:02.06.2023	Nr.0061, datë:29.05.202 3	Shtesë kati	Nr.0039, datë:02.06.2023 500,000	Nr.0041, datë:02.06.20 23	Nr.1639 Prot, datë:13.07.20 23	Nr.2714 Prot, datë:23.12.2 023 (Dërguar)
4	N. A. Selvijas Klos, Njoftim Nr.1381 Prot, datë:08.06.2023	Nr.0062, datë:05.06.202 3	Ndërtim objekti 1-kat	Nr.0040, datë:06.06.2023 500,000	Nr.0042, datë:06.06.20 23	Nr.1640 Prot, datë:13.07.20 23	Nr.2715 Prot, datë:23.12.2 023 (Dërguar)
5	M. Q., Shalës, Njoftim Nr.2479 Prot, datë:20.11.2023	Nr.0063, datë:09.11.202 3	Shtrimi i dyshemesë, heqja e mbulesës së çatisë dhe rrëzimin e faqes ballore të murit në momentin e prishjes së çatisë	Nr.0041, datë:15.11.2023 150,000	---	Nr.2673 Prot, datë:17.12.20 23	Nr.538 Prot, datë:21.02.2 024 (Dërguar)
6	Ç. Ll., Gjyralë Gostimë, Njoftim Nr.2661 Prot, datë:15.12.2023	Nr.0064, datë:06.12.202 3	Ndërtimi i mureve mbajtëse	Nr.0042, datë:15.12.2023 150,000	Nr.0043, datë:15.12.20 23	-----	-----

1. Lidhur me procedurat e mësipërme, konstatohet mangësi në veprimtarinë e IMTV, pasi masa e gjobës për 6 subjektet e mësipërme, është aplikuar gabim, pasi me ligjin nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 52, pika 1 gërma “e”, është ndryshuar si më poshtë: e) “kryerja e punimeve pa leje

dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe me....”.

Në këto kushte masa e gjobës e caktuar me vlera nga 100,000 deri në 500,000 lekë është masë e cila nuk mbështetet në ligj, pasi me ndryshimet e cituara më sipër, masa e gjobës përlllogarit sipas vlerës së punimeve të kryera pa leje, dhe në çdo rast kur kemi të bëjmë me ndërtim për qëllime fitimi, masa e gjobës është jo më pa se 35,000 lekë për metër katror.

- Lidhur me këto mangësi, audituesit kanë sqaruar në hyrje të këtij akt konstatimi, se do duhej që në stafin e IMTV të kishte staf të kualifikuar, sidomos me profil inxhinierik, pasi me ndryshimet e ligjit nuk kemi më minimum gjobe në vlerë të përcaktuar, por kërkohet ekspertizë dhe staf i kualifikuar për të nxjerrë përlllogaritjet dhe nxjerr masën e gjobës në përputhje me dispozitat ligjore.

2. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori/ët kanë nxjerrë vendime për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, por rezulton se nuk ka marrë apo pasqyruar asnjë masë apo procesverbal për ekzekutimin e vendimit të prishjes së këtyre ndërtimeve.

-Lidhur me mungesën e mos prishjes së ndërtimeve, K/inspektori ka paraqitur 2 kërkesa drejtuar Kryetarit të Bashkisë Cërrik, konkretisht shkresën pa numër prot., datë 30.12.2022 dhe shkresën nr. 151 prot., datë 17.01.2024, në të cilën bën kërkesë për mbështetjen për blerjen ose marrjen me qira të mjetit fadromë për prishjen e ndërtimeve pa leje, të cilat kanë ngelur pa ekzekutuar për vitin 2021-2023. Nuk është paraqitur asnjë marrje masash që lidhet me këtë kërkesë, nga e cila rezulton se nuk kemi asnjë ekzekutim për vendimin për prishje të objekteve të ndërtuara pa leje.

-Gjithashtu, për kundërvajtësin N. D., rezulton se nuk është nxjerrë vendimi për prishje të objektit pa leje, në kundërshtim me nenin 5, gërma “d” të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, dhe pikës 7 të VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

3. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se K/inspektori/ët, nuk kanë nxjerrë asnjë vendim për pezullimin e punimeve të konstatuara pa leje, veprim në kundërshtim me nenin 5 gërma “ç” të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, dhe pikës 5 të VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

4. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 gërma “a” të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”. Njëkohësisht sqarohet se në mungesë të stafit të kualifikuar, ky kontroll do ishte i pamundur pasi punonjësit nuk kanë kualifikimin sipas ligjit për të kryer akte kontrolli në objektet që kanë leje ndërtimi.

5. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, në përputhje me nenin 5, gërma “f” të ligjit

nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

6. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se k/inspektori, për periudhën objekt auditimi **ka** miratuar planet mujore të punës, në përputhje me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, dhe pika 2 Rregullores së Bashkisë Cërrik “Detyrat e Kryeinspektorit/ Inspektorit të IMT, miratuar me vendimin nr. 50, datë 27.01.2023 të Titullarit, por pavarësisht faktit se kemi të miratuar këto plane, në të cilat specifikohet verifikimi i lejeve të ndërtimit, siç është cituar tek pika 4 e gjetjes së mësipërme, IMT nuk ka realizuar asnjë kontroll dhe të mbajë aktet e kontrollit për objektet me leje ndërtimi, ndërkohë rezulton se për vitin 2023, janë miratuar shumë leje ndërtimi të tipologjive të ndryshme.

7. Lidhur me gjobat e vendosura nga IMT, rezulton se në 5 raste nga 6 në total, janë përcjellë kërkesë paditë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, por nga informacioni i administruar nuk disponohet vendimmarrje nga gjykata për këto kërkesa.

8. Rezulton se gjobat janë përcjellë për kontabilizim pranë Drejtorisë Ekonomike, e cila i ka pasqyruar në bilanc gjobat.

Lidhur me gjobat për periudhën 2020 – 2022, rezulton se janë 24 debitorë për gjoba nga IMT, në vlerë totale 9,800,000 lekë⁶. Lidhur me këto gjoba, të cilat janë të kontabilizuara, por rezulton se nuk janë arkëtuar.

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” neni 4, neni 5 gërmat “a”, “d” e “ç”, Ligji nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51, neni 52 pika 1 germa “e”, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, pika 2.

Për veprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi F. Q. – Kryeinspektor, K. M. dhe S. Sh. - Inspektor.

2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në zbatim të Rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Cërrik, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 208/10 prot., datë 18.07.2023, (*prto Bashkia Cërrik me shkresën nr. 1427/6 prot., datë 19.07.2023*), nga bashkia janë marrë një sërë masash dhe përgatitur programe me afate dhe persona për zbatimin e rekomandimeve, konkretisht:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr 154/2014, datë 27.01.2014’ Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga ana e Bashkisë Cërrik është hartuar Plan Veprimi mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Raportit të Auditimit të KLSH-së me shkresën nr 1409/1 prot., datë 16.06.2023 KLSH-së, **brenda 20 ditëve.**

Plan Veprimi ka përfshirë të gjitha masat organizative, masat për shpërblim dëmi, masat për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve, masat administrative dhe masat disiplinore të renditura sipas nivelit të riskut. Janë percaktuar strukturat përgjegjëse që do merren me realizimin e rekomandimeve sipas afateve kohorë të percaktuar. Plan Veprimi i është dërguar Këshillit Bashkiak dhe 10 (dhjetë) strukturave përgjegjëse, Drejtori, Ndërmarje,

⁶ Lista e debitorëve për gjobat e IMT për periudhën 2020-2022 në aneksin nr. 8.

Inspektoriate e Sektorë që të bëjnë analizën e punës së tyre me qëllim përmirësimin e punëve në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Bazuar në nenin 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **NUK** është dërguar Zbatimi i Plan Veprimit dhe Raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, **brenda afatit 6 mujor** nga marrja e e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH.

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, realizimi është si më poshtë:

- Nga **14 masa organizative**, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa, janë në proces zbatimi 6 masa, **janë pjesërisht zbatuar 3 masa dhe nuk janë zbatuar 3 masa.**

- Nga **7 masa për dëme ekonomike** me vlerë 1,460 mijë lekë, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë në proces zbatimi 6 masa me vlerë 1,091 mijë lekë (proces gjyqësor) dhe nuk është zbatuar një masë me vlerë **369 mijë lekë.**

- Nga **9 masa për eliminimin e efekteve** negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të tyre, pranuar 100% nga subjekti> nga të pranuarat janë zbatuar 5 masa, janë në proces 2 masa dhe **nuk është zbatuar një masë.**

- **Për masat disiplinore.** Në plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, për punonjësit e Shërbimit Civil dhënie e masave disiplinore “Vërejtje” për 6 (gjashtë) punonjës, e zbatuar.

Më hollësisht zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së paraqitet si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Cërrik **14 masa organizative.**

1.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponenteve të MFK-se konstatohet se:
-Nuk është hartuar "Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore", për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA.

-Në informacionin e sjellë nga Burimet Njerëzore në vitin 2022 janë kryer 56 trajnime për 11 punonjës të Bashkisë Cërrik.

-Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.

-Në lidhje me MFK nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).

- Bashkia Cërrik nuk ka miratuar “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, e cila duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të MFK dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”, pikën 5.3.

- Procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në mos zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16. datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të MFK dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”.

- Në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 27, në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të MFK në njësitë publike” pika 2/2,4, nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të GMS për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për përgatitjen e buxhetit vjetor dhe programit buxhetor afatmesëm. Bashkia Cërrik nuk ka miratuar plan pune vjetorë lidhur me funksionimin e GSM.

- Në Bashkinë Cërrik, Drejtoria e Financave përdor programin Excel. Duke qënë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave dhe kjo kryhet nga Drejtoria e Financave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

- Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të GMS për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me MFK, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për përgatitjen e buxhetit vjetor dhe programit buxhetor afatmesëm.

- Bashkia Cërrik nuk ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e GMS.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Cërrik me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK të marrë masat si vijon:

-Të hartojë planin e trajnimeve;

-Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të GMS për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-Të miratojë “Planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;

-Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”.

Nga verifikimi rezultoi se: *Nga dokumentacioni i paraqitur nga bashkia, rezultoi se është hartuar plani i trajnimeve për punonjësit e Bashkisë Cërrik, me temat e trajnimit dhe me datat përkatëse të tyre.*

Statu: Pjesërisht e zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditit të Brendshëm për vitin 2022 nuk ka patur përgjegjësi, vetëm 2 punonjës si inspektorë audit të brendshëm në strukturë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 11 dhe të VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, për “Miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik” pika 3.

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, lejet e ndërtimit, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, nenet nr. 5 dhe 6 të ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Nga ana e Njesisë së Auditimit Bashkia Cërrik për periudhën e auditimit nuk është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me program tematik të veçantë, por është bërë verifikimi i rekomandimeve në auditimin e radhës, gjë që vjen në kundërshtim me Manualin e auditimit të miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25. 10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, pikën 4.1.13.2, Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Cërrik të marrë masa për plotësimin e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, dhe të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njesisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njesisë publike.

Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Cërrik me Urdhërin nr. 10, datë 12.01.2024 “Për miratimin e strukturës Organizative të Bashkisë Cërrik për vitin 2024, ka marrë masa për ristrukturimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm nga njësi me vetëm 2 punonjës si inspektorë*

auditi të brendshëm në njësi me 3 punonjës, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori (i certifikuar audit) dhe 2 specialistë. (Bashkëlidhur Urdhëri nr. 10, datë 12.01.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Çërrik për vitin 2024).

Statusi: Proces.

3. Gjetje nga auditimi: Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 130,495 mijë lekë, ndërsa realizimi 125,230 mijë lekë, ose në masën 95.96%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri me kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 225,658 mijë leke dhe është realizuar në vlerën 193,024 mijë lekë, ose në masën 85,54 %. Ky mosrealizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Çërrik në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën “a” të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Gjithashtu rezultoi se gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022. Veprimet e mësipërme janë në përputhje me nenin 46- Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtorja e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferencë midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga auditimi u konstatua se janë marrë disa nga masat për zbatimin e rekomandimit.

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Çërrik në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 181,333,663 mijë lekë (nga kjo 36,236,536 lekë, detyrime të FSHZH), Detyrimi i Bashkisë është 145,097,127 lekë e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 71,072,877 mijë lekë, nga e cila është likuiduar vlera 84,750,410 mijë lekë, ose 119.24% e vlerës së planifikuar. Po për efekte të shtimit të detyrimeve gjatë vitit 2022, kjo ulje e detyrimeve nga pagesat nuk reflektohet në gjendjen e detyrimeve në datën 31.12.2022. Vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2022), është ulur (145,097,127-121,557,012), me 23,540,115 lekë, ose në masën prej 16.23%. Në mënyrë të detajuar lista analitike e detyrimeve të prapambetura paraqitet në aneksin nr. 5 pika 2.4 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Për sa më sipër rezultoi se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2022.

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura si dhe të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Nga verifikimi rezultoi se: *Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit janë marrë masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatitit 30 ditor, në vazhdimësi.*

Statusi: Në proces

5. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se: Struktura e DAV nuk ka në përbërje të saj Sektorin e Masave Shtrenguese si nje strukturë e rëndësishme në Bashkinë Cërrik, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve ëe paarkëtuara (debitor), për 3,583 subjekte familjar dhe biznesi në vlerën 39,724 mijë lekë, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërore në vlerë 7.936 mijë lekë për 142 subjekte dhe abonente familjare në vlerë 31,798 mijë lekë për 3,441 abonent. Alternim i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit Terren është i papërshtatshëm, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë me vete dhe afate të percaktuara. Gjithashtu konstatohet se për periudhën objekt auditimi 2022 Drejtoria e të Ardhurave Vendore ka funksionuar pa drejtor çka sjell mosarkëtimin e të ardhurave, kjo për mungesë stafi, në kundërshtim me pikën “s” të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 - 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime, si dhe Rregullore e Brendshme miratuar me shkresën nr. 168/1 prot., datë 29.04.2022.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit te DAV Bashkia Cërrik me specialit të fushës dhe përshtatja e struktures sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

Nga verifikimi rezultoi se: *Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik është masë e përcaktuar për shkak të mungesës së Burimeve Njerëzore.*

Statusi: Pa zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimore dhe mbajtjen e akt rakordimeve me ta. Të ardhurat nga agjentët tatimore (Drejtoria Rajonale Tatimore, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Cërrik, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve te përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të bashkisë Cërrik dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Elbasan. Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se OE “Ujësjetllës Kanalizime Cërrik” Sha, nuk është caktuar si agjent tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me agjentin tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorinë e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.
- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,

“Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat kombëtare”.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Cërrik, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj si dhe të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mblidhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Nga verifikimi rezultoi se: *Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik është masë e pa zbatuar.*

Statusi: Pa zbatuar.

6.2. Rekomandimi: Bashkia Cërrik, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e OE “Ujësjetllës Kanalizime Cërrik” Sha, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

Nga verifikimi rezultoi se: *Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik është masë e pa zbatuar.*

Statusi: Pa zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 7 prona sipas tabelës së sipërcituar si dhe përpara vitit 2020 janë certifikuar 65 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llog. (212) pasuri e paluajtshme (sasi e vlerë) pjesa e konsiderueshme e tyre prej 4403 prona (trajtuar analitikisht) nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të pasqyrës së pozicionit financiar. Nga 65 prona të cilat janë certifikuar 34 prona janë prona të transferuara nga Ish komunat sot NJA dhe 31 prona janë prona të cilat janë certifikuar për periudhën 2017-2019 dhe 7 prona janë certifikuar për periudhën 2020-2022 sipas aneksit nr. 1 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori i aseteve, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Cërrik në Drejtorinë Rajoneve të ASHK Elbasan, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 38 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asete të Bashkisë Cërrik. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 38 prona të certifikuar në ASHK Elbasan, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Cërrik sipas aneksit nr. 1 pika 3 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Nga verifikimi rezultoi se: *Nga auditimi rezultoi se është ngritur komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit për 38 prona të certifikuar në ASHK Elbasan.*

Statusi: Në proces

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i tre rrugeve”, “Sistemim asfaltim i rrugës Kamunah”, “Ndërtim ujësjetllësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Desar”, “Rehabilitim/Përforcim banesash ekzistuese”, “Rikonstruksion i rrugës së Capallarëve dhe vreshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, fshati Licaj, Nj.A. Shalës”, zhvilluar në periudhën 2020-2022, janë vendosur kritere

të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elemente të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DT, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5, neni 27, neni 61 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, me pikën 4 të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe neni 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

8.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Cërrik të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta në DT. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriteret e veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.

Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Cërrik ka marrë masa në lidhje me anëtarët e njësisë së prokurimit të cilët kanë hartuar kriteret e veçanta në DT. Njësia e prokurimit në të ardhmen do të vendosë kriteret në përputhje me legjislacionin e PP.*

Statusi: Në proces.

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 5 raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:

1. - Në procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i tre rrugëve”, me vlerë të fondit limit 24,835, 898 leke pa Tvsh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE “G.” Shpk & “E.” Shpk, me ofertë 24,698,141 lekë pa Tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DT, por është kualifikuar dhe shpallur fitues.

2. - Në procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Kamunah”, Bashkia Cërrik, me vlerë të fondit limit 28,333,333 lekë pa Tvsh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues OE “V. H.” Shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 28,183,787 lekë pa Tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DT.

3. - Në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas”, Bashkia Cërrik, me vlerë të fondit limit 283,457,911 lekë pa Tvsh, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “V. K.” Shpk & “F.” Shpk & “E.” Shpk me ofertë 281,115,515 lekë pa Tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

4. - Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitim/Përforcim banesash ekzistuese”, Bashkia Cërrik, me vlerë të fondit limit 26,920,399 lekë pa Tvsh, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “Z.” Shpk, me ofertë 26,920,399 lekë pa Tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

5. - Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i rrugës së Capallarëve dhe vreshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, fshati Licaj, NjA. Shalës”, Bashkia Cërrik, me vlerë të fondit limit 49,091,672 lekë pa Tvsh, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “Z.” Shpk, me ofertë 49,052,481.5 lekë pa Tvsh, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, gërma “ç”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, gërma “a” dhe ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 92, pika 3.

9.1.Rekomandim: Titullari i AK, Bashkia Cërrik, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk

plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Nga verifikimi rezultoi se: *Lidhur me rekomandimin e lënë nga grupi i mëparshëm u konstatua se është ngritur komisioni disiplinor për personat përgjegjës për fillim i procedimit disiplinor për punonjësit, me Vendimin nr. 2252/1 prot., datë 16.10.2023.*

Statusi: Zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave për dhënie të lejeve të ndërtimit u konstatuan mangësi në miratimin e disa lejeve si vijon:

- Çështja me nr. 211 prot., datë 21.04.2020, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Shtesë kati, objekt banimi dhe shërbimesh 2 kat + bodrum”, rruga “Rinia” Lagja nr. 2 Cërrik.
- Çështja me nr. 225 prot., datë 24.07.2020, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Ndërtim thertore për bagëti” fshati Gosmim, NjA. Gostim, Bashkia Cërrik.
- Çështja me nr. 2326 prot., datë 04.06.2020, sipas aplikimit në sistemin e_ leje me objekt: “Fabrikë prodhim vaji ulliri”.
- Çështja me nr. 3690 prot., datë 24.12.2020, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Kompleks agro - bujqësor (magazinim-frigorifer)”.
- Çështja me nr. 4993 prot., datë 13.12.2021, sipas aplikimit në sistemin e leje me objekt: “Ndërtim i magazinës 1 kat”.
- Çështja me nr. 1642 prot., datë 19.05.2021, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Banesë 1 kat” fshati Gostim, NjA. Gostim, Bashkia Cërrik.
- Çështja me nr. 1728 prot., datë 26.05.2021, sipas aplikimit në sistemin e leje me objekt: “Rikonstrukcion i ndërtesës 1 kat” fshati Malasej, NjA Gostim, Bashkia Cërrik.
- Çështja me nr. 3849 prot., datë 01.09.2021, sipas aplikimit në sistemin e leje me objekt: “Magazinë për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore” fshati Gjyrale, NjA Gostim, Bashkia Cërrik.
- Çështja me nr. 431 prot., datë 08.02.2022, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Magazinë e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore” fshati Çartaloz, NjA Gostime, Bashkia Cërrik.
- Çështja me nr. 1309/1 prot., datë 17.05.2022, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri” fshati Gjyrale, NjA Gostim, Bashkia Cërrik.
- Çështja me nr. 3024 prot., datë 25.10.2022, sipas aplikimit në sistemin e_leje me objekt: “Fabrikë për prodhim vaji nga ulliri” Cërrik-Ferme, Bashkia Cërrik.

Sa më sipër rezultoi se në dosjet e lejeve mungon dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, specifikisht të pesë pikat si më poshtë konstatohet që nuk procedohen në kërkesën për plotësim të tyre nga subjektet përfitues të lejeve janë konstatuar mangësi në pikën b) Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në nje zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta; pikën e) Deklarata e projektuesit të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së cilës konfirmohet përputhshmeria e projektit me lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit, në fuqi, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në RSH, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare; pikën ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes ëe ndërtimit; pikën v) Projektin e eficiencës energjitike, në rastet kur është e detyrueshme me ligj; pikën g) Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësiwe profesionale; pikën i) Problematika në punimet e hedhjes së hartave nga sektori i GIS Kadastrës së Bashkisë Cërrik, duke mos përcaktuar qartë kufijtë e pronës objekt zhvillimi, duke mos përcaktuar saktë gjendjen faktike të terrenit me objektet informale si dhe me poseduesit e ligjshëm dhe të paligjshëm mbi pronat objekt zhvillimi e dhënie leje ndërtimi

për to, për pasoje duke çuar në mozbatim të kriterëve, distancave dhe evidence të pronarëve, të cilat bien në kundërshtim me Nenin 10, pika “c” dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjeve për pronën; pika e) planin e rievimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar; dhe në kundërshtim me Nenin 16, pika “d” të dhënat identifikuese të pronarit të tokës, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; pika “i” Referuar sistemit e-Leje rezulton për lejet e sipërcituara, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe IMTV me përfaqësues Z. F. U., Z. A. D., Znj. S. F. në zbatim të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar rezulton që nuk ka mbajtur Akt Kontrolli i Piketimit të Objektivit me subjektin zhvillues, nuk ka një mbikëqyrës të punimeve inxhinierin përkatës dhe nuk kemi firme zbatuese të punimeve të ndërtimit.

Veprimet dhe mosveprimet e sipërcituar janë në kundërshtim me Ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar, i cili nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit duke mos krijuar kushte të përshtatshme, të drejta dhe shanse të barabarta për banim. Gjithashtu mosrespektim të ligjit dhe moszbatim të tij në nivel procedural duke sjell parregullsi juridike në çdo akt të prodhuar nga institucioni.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratimit të lejeve të ndërtimit të mbahen aktet e kontrollit sipas percaktimeve ligjore.

Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Cërrik me Observacionin me nr. 1130/1 prot., datë 17.05.2023, Drejtoria e Planifikimit në Bashkinë Cërrik ka shkarkuar nga sistemi e-leje-kryefaqja-dosjet “Çështje të përfunduara” aplikimet për çështjet me nr. 211 prot., datë 21.04.2020, me nr. 225 prot., datë 24.07.2020, me nr. 2326 prot., datë 04.06.2020, me nr. 3690 prot., datë 24.12.2020, me nr. 4993 prot., datë 13.12.2021, me nr. 1642 prot., datë 19.05.2021, me nr. 1728 prot., datë 26.05.2021, me nr. 3849 prot., datë 01.09.2021, me nr. 1309/1 prot., datë 17.05.2022, me nr. 3024 prot., datë 25.10.2022, dhe është shprehur në lidhje me pikat “b”, “e”, “ë”, “v”, “g”, “I”.*

Statusi: Zbatuar.

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se IMTV Bashkia Cërrik janë konstatuar mangësi konkretisht:

- Nuk ka një plan pune vjetor për të gjithë harkun kohor të viteve objekt auditimi, vërehet se kanë të percaktuar një plan pune vetëm për muajin Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2022 ndërsa përse i përket periudhës tjetër para nuk rezulton asnjë shkresë apo memo mbi planin e punës.

- Në asnjë moment nuk ka kryer një korrespondencë me institucione të tjera, ndalemi këtu në korrespondencën e domosdoshme me Agjencinë Shetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, respektivisht Sektori i Legalizimeve pranë kësaj drejtorie për të kërkuar një shkresë apo konfirmim nëse këta subjekte që i nënshtrohen prishjes, gjobës etj nga IMT, Bashkia Cërrik kanë vetëdeklarim për ndërtim pa leje, nëse ky vetëdeklarim është në sistemin e tyre, nëse ka raste përjashtimore të vetëdeklarimeve duke u bazuar në ortofoton fotografimin ajror në vite në referim të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për percaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”. Sektori i IMTV Bashkia Cërrik nuk funksionon në parametrat tekniko-ligjor të duhur duke filluar nga burimet njerëzore rezultojnë në kundërshtim me nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 i ndryshuar. Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik- “Kryeinspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku/kombëtar dhe inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik

Kombëtar duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit. Inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku.

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve njerëzore të marrë masa për plotësimin e strukturës së IMT, Bashkia Cërrik, sipas përcaktimeve ligjore.

Nga verifikimi rezultoi se: *Struktura e IMT Cërrik, përbëhet nga 3 punonjës ku një prej tyre ka shkollimin e duhur juridik, gjithashtu janë në pritje të ardhjes së burimeve njerëzore të reja. Problematikat e tilla për mospërputhjen sipas përcaktimeve ligjore të BNJ ka qënë shkaku i mungesës së Burimeve Njerëzore.*

Statusi: Në proces

11.2. Rekomandimi: Sektori i IMT, Bashkia Cërrik, të merren masa në organizimin dhe efektivitetin e punës duke ndjekur një procedurë pune të inventarizuar dhe arshivuar, ku përcakton ndarjen e punës dhe zhvillimin e saj gjatë vitit kohor hedhur në një plan të miratuar nga përgjegjës sektori dhe titullari i bashkisë si dhe të marrë masa që në zbatim të procedurave ligjore të zhvillojë dhe dokumentojë korrespondencë me institucione e tjera.

Nga verifikimi rezultoi se: *Nga dokumentacioni i audituar rezultoi se IMT Cërrik ka marrë masa për organizimin dhe ndajren e punës sipas planit të miratuar nga përgjegjësi.*

Statusi: Zbatuar.

12. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV” i ndryshuar, IMT bashkia Cërrik, ka marrë 17 (shtatëmbëdhjetë) vendime për prishje objektesh pa leje (sipas tabelës së mëposhtme), vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara.

-Në 17 (shtatëmbëdhjetë) raste rezulton se është mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal prishje, por nuk është marrë asnjë mase tjetër nga ana e IMT bashkia Cërrik për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar.

12.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi ndaj personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar berjen e kallëzimit penal ndaj shkelësve.

Nga verifikimi rezultoi se: *Në planin e masave të mara nga Bashkia Cërrik është masë e pa zbatuar.*

Statusi: Pa zbatuar.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i fundit i kryer në Bashkinë Cërrik, nga KLSH janë rekomanduar masa për përmirësimin e gjendjes, të cilat janë dërguar në subjekt me shkresën nr. 58/7 prot., datë 16.05.2022. Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e tyre, si vijon:

- Janë rekomanduar 15 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 6 prej tyre, 7 masa janë në proces zbatimi dhe 2 masa organizative nuk janë zbatuar.

- Janë rekomanduar 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, dhe janë në proces zbatimi 6 masa.

- Masa disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Cërrik t'i kerkoje Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e

përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse, rekomandim i cili nuk është zbatuar.

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik të marrë të gjitha masat për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara, dhe përsheptimin e zbatimit të rekomandimeve proces zbatimi të lena nga KLSH në raportin e auditimit të fundit sipas shkresës nr. 58/7 prot., datë 16.05.2022, të përshkruara në mënyrë të detajuar në këtë projekt raport auditimi, pika “Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në auditimin e fundit” si vijon.

Për dy masa organizative të cilat janë konsideruar të pazbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

13.2. Rekomandimi: Bashkia Cërrik me qëllim zbatimin e plotë të komponenteve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Të hartojë planin e trajnimeve;
- Të organizojë trajnime në grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e menaxhimit të riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit
- Të aplikojë programe elektronike të licensuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të grupit të Punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”
- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;
- Të raportojë periodikisht lidhur me kryerjen e procesit të monitorimit.

Nga verifikimi rezultoi se: *Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se, lidhur me MFK, Bashkia Cërrik ka hartuar planin e trajnimeve, nuk ka dokumentuar zhvillimin e çdo mbledhjeje të GMS si dhe nuk është raportuar periodikisht lidhur me kryerjes e procesin e monitorimit.*

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

13.3 Rekomandimi: Bashkia Cërrik të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifatat vendore të Bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Cërrik me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë me datë 11.10.2023 “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor në Bashkinë Cërrik” ka ngritur Komisionin Disiplinor i cili me Vendimin me nr. 2252/1 prot., datë 16.10.2023. Është hartuar plani i trajnimeve për punonjësit e Bashkisë Cërrik me temat e trajnimit dhe me datat përkatëse të tyre. Është ngritur urdhër i brendshëm për ngritjen e grupit të menaxhimit të riskut, urdhër për menaxhimin dhe koordinimin e riskut në Bashkinë Cërrik, urdhër i brendshëm për ngritjen e ekipit të menaxhimit të programeve, urdhër i brendshëm për kordinatorin e riskut për vitin 2023, është hartuar plani i veprimt për menaxhimin financiar dhe kontrollin, është hartuar regjistri i riskut për të gjitha drejtoritë, është hartuar harta e proceseve nga Drejtoria e Financës, është hartuar plani i punës për vitin 2023.*

Statusi: Në proces.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i fundit i kryer në Bashkinë Cërrik, nga KLSH janë rekomanduar masa për përmirësimin e gjendjes, të cilat janë dërguar në subjekt me shkresën nr. 568/38 prot., datë 27.07.2022. Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e tyre, si vijon:

- Janë rekomanduar 3 masa organizative për të cilat Drejtoria e Financës ka kryer veprime për zbatimin e rekomandimeve, por duke qënë se nuk janë mbyllur pasqyrat financiare të vitit 2022 janë konsideruar të pazbatuara.

Per 3 masa organizative të cilat janë konsideruar të pazbatuara, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon;

14.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llog. 211 “Pyje, Plantacione”, ku nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe pronave publike të kryeje zberthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to ndër vite, për të verifikuar saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Nga verifikimi rezultoi se: *Nga auditimi rezultoi se është ngritur grupi i punës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve llog. 210 dhe llog. 211, si dhe janë bërë sistemimet e nevojshme në kontabilitet.*

Statusi: Zbatuar.

14.2 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronës Publike, Bashkia Cërrik, të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëparshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe të realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikimi e tyre të ekzistencës fizike.

Nga verifikimi rezultoi se: *Nga auditimi rezultoi se ekziston një regjistër historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike, ku pasqyrohet vlera e akumuluar e amortizimit si dhe vlera e mbetur.*

Statusi: Në proces.

14.3 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Cërrik, të marrë masa për sistemimin e llog. 202 “Studime e projektme”, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në dobi të llogarive të aktiveve afatgjata materiale vlerën 5,989,972 lekë për vitin 2021 e cila u përket objekteve të përfunduara para mbylljes së vitit ushtrimor 2021 dhe 5,989,972 lekë, si dhe të bëhet sistemimi kontabël në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit.

Nga verifikimi rezultoi se: *Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrik është masë e realizuar.*

Statusi: Zbatuar.

B. Masa për shpërblimin e dëmit.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontrates me objekt: “Sistemim, asfaltim rruga Kamunah”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 33,820,544.40 lekë me Tvsh, fituar nga OE “V. H.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 102,316 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 343 prot., datë 15.04.2021, të lidhur mes AK Bashkia Cërrik dhe OE “V. H.” Shpk.

1.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 102,316 lekë pa Tvsh nga OE “V. H.” Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1343 prot., datë 15.04.2021, me objekt: “Sistemim, asfaltim rruga Kamunah”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit të njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Cërrik ka ngritur kërkesë padi me nr. 462 prot., datë 13.02.2024 për arkëtimin e vlerës prej 102,316 lekë nga OE “V. H.” Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1343 prot., datë 15.04.2021, me objekt: “Sistemim, asfaltim rruga Kamunah”, për llogari të Bashkisë Cërrik.*

Statusi: Në proces.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Qyrkan”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 26,092,473.60 lekë, fituar nga OE “V. H.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 271,632 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1834 prot., datë 14.07.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “V. H.” Shpk.

2.1-Rekomandimi:- Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 271,632 lekë pa Tvsh nga OE “V. H.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1834 prot., datë 14.07.2020, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Qyrkan“, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe të njësisë vendore, si pasojë e likujdimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Cërrik ka ngritur kërkesë padi me nr.461 prot., datë 13.02.2024 për arkëtimin e vlerës prej 271,632 lekë nga OE “V. H.” Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1834 prot., datë 14.07.2020, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Qyrkan” për llogari të Bashkisë Cërrik.*

Statusi: Në proces.

3. Gjetje nga auditimi: Nga Auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rehabilitimi i kanaleve vaditës”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 40,786,652 lekë, fituar nga BOE “M.” Shpk & “Sh.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 104,610 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2661 prot., datë 08.10.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe BOE “M.” Shpk & Sh. “ Shpk (më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 të faqe 113 130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 104,610 lekë pa Tvsh nga BOE” M.” Shpk & “Sh.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2661 prot., datë 08.10.2020, me objekt: “Rehabilitimi i kanaleve vaditës”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likujdimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Cërrik ka ngritur kërkesë padi me nr. 460 prot., datë 13.02.2024 për arkëtimin e vlerës prej 104,610 lekë nga BOE “M.” Shpk & Sh.” Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2661 prot., datë 08.10.2020, me objekt: “Rehabilitimi i kanaleve vaditës” për llogari të Bashkisë Cërrik.*

Statusi: Në proces.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstruksion rruga Licaj”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 23,934,289 lekë, fituar nga OE “A.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 129,152 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3720 prot., datë 31.12.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “A.” Shpk.

4.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 129,152 lekë pa Tvsh nga OE “A.” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3720 prot., datë 31.12.2020, me objekt: “Rikonstruksion rruga Licaj”, bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likujdimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Cërrik ka ngritur kërkesë padi me nr. 458 prot., datë 13.02.2024 për arkëtimin e vlerës prej 129,152 lekë nga OE “A.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7120 prot., datë 31.12.2020, me objekt: “Rikonstruksion rruga Licaj” për llogari të Bashkisë Cërrik. (bashkëlidhur kërkesë padia me nr 458 prot., datë 13.02.2024).*

Statusi: Në proces.

5. Gjetje nga auditimi: Nga Auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim i tre rrugeve” bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 29,637,769 lekë fituar nga BOE “G.” Shpk & “E.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 369,779 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1390 prot., datë 20.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe BOE “G.” Shpk & “E.” Shpk.

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 369,779 lekë pa Tvsh nga BOE “G.” Shpk & “E.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1390 prot., datë 20.04.2021, me objekt: “Sistemim, asfaltim i tre rrugeve”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likujdimin të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Cërrik ka ngritur kërkesë padi me nr. 457 prot., datë 13.02.2024 për arkëtimin e vlerës prej 369,779 lekë nga BOE “G.” Shpk & “E.” Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1390 prot., datë 20.04.2021, me objekt: “Sistemim, asfaltim i tre rrugëve” për llogari të Bashkisë Cërrik.*

Statusi: Në proces.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstruksion objekti 2k dhe ndryshim destinacioni nga magazinë në banesa sociale”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 13,634,256 lekë, fituar nga OE “Z.” Shpk, rezultuan diferenca në volume të pakryera në fakt në vlerën 113,360 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2416 prot datë 16.09.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “Z.” shpk.

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 113360 lekë pa tvsh nga OE “Z.” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2416 prot., datë 16.09.2020, me objekt “Rikonstruksion objekti 2k dhe ndryshim destinacioni nga magazinë në banesa sociale”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likujdimin të punimeve të pakryer.,

Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Cërrik ka ngritur kërkesë padi me nr. 459 prot., datë 13.02.2024 për arkëtimin e vlerës prej 113,360 lekë nga OE “Z.” Shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2416 prot., datë 16.09.2020, me objekt: “Rikonstruksion objekti 2k dhe ndryshim destinacioni nga magazinë në banesa sociale” për llogari të Bashkisë Cërrik.*

Statusi: Në proces.

7. Gjetje nga auditimi: Nga Auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjA Mollas”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me Tvsh) 337,342,218 lekë, fituar nga BOE “V. K.” Shpk & “F.” Shpk & “E.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 369,280 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2816 prot., datë 21.10.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe BOE “V.” Shpk & “F.” Shpk & “E.” Shpk.

7.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 369,280 lekë pa Tvsh nga BOE “V. K.” Shpk & “F.” Shpk & “E.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2816 prot., datë 21.10.2020, me objekt: “Ndërtim ujësjellësi për fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar, NjQ Mollas” Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likujdimin të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: *Në llogarinë bankare të Bashkisë Cërrik është arkëtuar vlera prej 369,280 lekë nga BOE “V. K.” Shpk & “F.” Shpk & “E.” Shpk për zhdëmtime (punë e pakryer) ndërtim ujësjellësi Mollas.*

Statusi: Zbatuar.

C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet të fondeve publike.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Çërrik për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 426,000 leke për 1 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Në fund të vitit 2022 ka një vendim për dëmshpërblim page në vlerën 2,232,378 lekë, i cili është planifikuar në buxhetin e vitit 2023.

Gjithashtu konstatohet se në 1 raste në vlerën 426,000 lekë për likuidimet e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhërat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësi vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Çërrik të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera me qëllim uljen e efekteve negative në buxhet.

Nga verifikimi rezultoi se: *Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se është hartuar regjistri elektronik i të gjitha çështjeve gjyqësore nga viti 2020 deri me 2024.*

Statusi: Zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore që taksapaguesit kanë ndaj Bashkisë Çërrik në datën 31.12.2022 janë në vlerën 39,724 mijë lekë, nga e cila: subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërorë në vlerë 7,936 mijë lekë për 142 subjekte dhe abonentë familjarë në vlerë 31,798 mijë lekë për 3,441 abonent, vlerë kjo e cila përbën detyrim të pa arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Çërrik. Rezulton se vetëm në vitin 2022 borxhi tatimor i krijuar është në vlerën totale 20,584 mijë lekë, i përbërë nga 5,892 mijë lekë për 130 subjekte private dhe 14,692 lekë nga taksapaguesit familjarë. Bashkia Çërrik nuk ka aplikuar masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 e 93.

DTTV për vitin 2022 ka dërguar në Drejtorinë e Finances informacion lidhur me debitorët progresiv.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore Bashkia Çërrik, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorë, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **39,724 mijë lekë**, si më poshtë vijon:

- a. - T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.
- b. - Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
- c. - Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me

qëllim konfiskimin në fund të çdo ditë të një shumë jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. - Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. - Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Cërrik për mos kalimin e subjekteve debitore me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. - Të hapen regjistrat e debitoreve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Cërrik me shkresat nr. 33 prot., datë 01.02.2022, nr. 35 prot., datë 01.02.2022, nr.488 prot., datë 06.04.2022, nr. 490 prot., datë 07.04.2022, nr. 491 prot., datë 07.04.2022, nr.492 prot., datë 07.04.2022, nr. 493 prot., datë 08.04.2022, nr. 494 prot., datë 11.04.2022, nr. 495 prot., datë 11.04.2022, nr. 496 prot., datë 11.04.2022, nr. 497 prot., datë 13.04.2022, nr.498 prot., datë 11.04.2022, nr. 499 prot., datë 13.04.2022, nr. 500 prot., datë 13.04.2022, nr.501 prot., datë 13.04.2022, nr. 502 prot., datë 14.04.2022, nr. 503 prot., datë 14.04.2022, nr.504 prot., datë 14.04.2022, nr. 505 prot., datë 14.04.2022, nr. 506 prot., datë 14.04.2022, nr.507 prot., datë 14.04.2022, nr.508 prot., datë 14.04.2022, nr. 509 prot., datë 14.04.2022, nr.510 prot., datë 14.04.2022, nr. 511 prot., datë 14.04.2022, nr. 513 prot., datë 15.04.2022, nr.514 prot., datë 15.04.2022, nr. 515 prot., datë 15.04.2022, nr. 517 prot., datë 15.04.2022, nr.518 prot., datë 15.04.2022, nr. 519 prot., datë 15.04.2022, nr. 520 prot., datë 15.04.2022, nr.521 prot., datë 15.04.2022, nr. 522 prot., datë 15.04.2022, nr. 523 prot., datë 19.04.2022, nr.524 prot., datë 19.04.2022, nr. 525 prot., datë 19.04.2022, nr. 526 prot., datë 19.04.2022, nr.527 prot., datë 19.04.2022, nr. 528 prot., datë 19.04.2022, nr. 529 prot., datë 19.04.2022, nr.530 prot., datë 19.04.2022, nr. 531 prot., datë 20.04.2022, nr. 532 prot., datë 20.04.2022, nr.533 prot., datë 20.04.2022, nr. 534 prot., datë 20.04.2022, nr. 535 prot., datë 20.04.2022, nr.536 prot., datë 20.04.2022, nr. 537 prot., datë 21.04.2022, nr. 538 prot., datë 21.04.2022, nr.539 prot., datë 21.04.2022, nr. 540 prot., datë 21.04.2022, nr. 541 prot., datë 21.04.2022, nr.542 prot., datë 21.04.2022, nr. 543 prot., datë 21.04.2022, nr. 544 prot., datë 21.04.2022, nr.545 prot., datë 21.04.2022, nr. 548 prot., datë 12.05.2022, nr. 549 prot., datë 12.05.2022, nr.550 prot., datë 12.05.2022, nr. 552 prot., datë 18.05.2022, nr. 554 prot., datë 19.05.2022, nr.554 prot., datë 18.05.2022, nr. 555 prot., datë 19.05.2022, nr. 556 prot., datë 19.05.2022, nr.557 prot., datë 19.05.2022, nr. 558 prot., datë 19.05.2022, nr. 559 prot., datë 19.05.2022, nr.560 prot., datë 20.05.2022, nr. 561 prot., datë 23.05.2022, nr. 562 prot., datë 23.05.2022, nr.563 prot., datë 23.05.2022, nr. 564 prot., datë 23.05.2022, nr. 565 prot., datë 24.05.2022, nr. 566 prot., datë 24.05.2022, nr. 568 prot., datë 24.05.2022, nr. 569 prot., datë 26.05.2022, ka dërguar njoftim në bankat e nivelit të dytë për urdhër bllokimit e llogarive bankare/ llogarive depozitë. Bashkia Cërrik me shkresën nr. 2833/1 prot., datë 14.10.2022, ka dërguar njoftim ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor për vendosjen e barrës siguroese dhe hipotekore.

Është hartuar, në mënyrë tabelare, të dhënat mbi numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet dhe që kanë mbyllur aktivitetin në B.C. Për subjektet që i kanë shlyer detyrimet me shkresat me nr. 1525 prot., datë 06.05.2022, nr. 1080 prot., datë 26.04.2023, nr. 1442 prot., datë 19.06.2023, dhe shkresën e datës 07.09.2023, është kërkuar zhbllokimi i llogarive bankare dhe llogarive depozitë.

Eshte hartuar regjistri elektronik i gjendjes debitore për sektorin e pronave me qira për të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Cërrik.

Statusi: Proces.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Cërrik në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për

pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e Aluiznit Cërrik. Janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Cërrik.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2022, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezultoi se detyrimi për këtë takse është në vlerën 15,537,274 lekë për 360 persona e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Cërrik (sipas listës të administruar në CD). Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Cërrik nuk ka të evidentuar subjektet të cilat janë pajisur me leje legalizimi nga Aluizni përpara vitit 2017 si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Cërrik jetë drejtuar ASHK Dega Elbasan, për vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprimet dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 27 pika “d”, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit Urban në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje për vitin 2022 në vlerën 5,572,735 lekë ndaj 97 personave dhe përpara vitit 2021 në vlerën 9,964,539 lekë për 263 persona si dhe t’i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Elbasan, vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Cërrik me shkresën nr. 2836/1 prot., datë 11.10.2022 dhe nr. 182 prot., datë 17.01.2023 i ka dërguar Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, Drejtorisë së Financës dhe e të Ardhurave Vendore, Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore kërkesë për bashkëpunim për të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve të reja.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit Urban në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje për vitin 2022 në vlerën 5,572,735 lekë ndaj 97 personave dhe përpara vitit 2021 në vlerën 9,964,539 lekë për 263 persona.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Cërrik me shkresën nr. 2836/1 prot., datë 11.10.2022 dhe nr. 182 prot., datë 17.01.2023 i ka dërguar Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, Drejtorisë së Financës dhe e të Ardhurave Vendore, Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore kërkesë për bashkëpunim për të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve të reja. Me shkresën nr. 2894 prot., datë 13.10.2022 dhe nr. 181 prot., datë 17.01.2023 i ka dërguar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Elbasan, kërkesë për bashkëpunim për bllokimin e veprimeve për dhënie e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Statusi: Në proces.

4. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Cërrik dhe në Njesitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 15 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, sipas aneksit 4 pika 2.6 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit. Nga auditimi i kësaj kategorie të

bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 2 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas percaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe kanë paguar detyrimet në vlerë 2,000,000 lekë si dhe janë pajisur me autorizim 1 dhe 2 vjeçar 13 subjekte të cilët kanë paguar detyrimet në vlerë 6,040,000 lekë. Sa më sipër rezultojnë se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka vepruar në kundërshtim me Kreun II pika 11 e VKB nr. 83 datë 28.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; gërma “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, date 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; gërma “b” dhe pika 9 dhe 15. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se subjektet e pajisura me autorizim 1 vjeçar ka bërë likuidimin e detyrimeve sipas autorizimit. Referuar licencave përkatëse subjektet janë debitore në vlerën 5,460,000 lekë vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Cërrrik. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me Kreun II pika 11 e VKB nr. 83 datë 28.12.2021 “Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” si dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika I; gërma “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, date 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; gërma “b” dhe pika 9 dhe 15.

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjeke të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së patakshuar prej 5,460,000 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se: *Drejtoria e të ardhurave vendore e Bashkisë Cërrrik, me shkresën nr. 884 prot., datë 18.09.2023, i është drejtuar policisë bashkiake kërkesë për bashkëpunim, për realizimin e të ardhurave të planifikuara për aktivitetet me pakicë të karburanteve, vajra lubrifikantë dhe gaz të lëngshëm, kontroll mbi licencën dhe autorizimin, letër kujtesë për afatin 5-së ditor për pagesë në rastet e autorizimit të skaduar, deri në bllokimin e aktivitetit në pompat dalëse në rast të shkeljes së afatit. Gjithashtu është hartuar regjistri elektronik i lishencave 5 vjeçare dhe autorizimet për subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitetin në të gjithë Njësitë Administrative të Bashkisë Cërrrik.*

Statusi: Zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Lindin ndaj Bashkisë Cërrrik për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë në vlerën 45,270 lekë. Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerezore nuk ka dërguar informacion periodik në DTTV lidhur me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bënte ngarkesën përkatëse të tyre për periudhën e kontratës.

Mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik të listuar në tabelën e mësipërme është në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30. 10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 12, pika 6 “Taksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë bashkisë ose komunës përkatëse. Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikate regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”, VKB nr. 338/1, datë 20.12.2019 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimi i tyre në Bashkinë Cërrrik, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative, për vitin 2020”, VKB nr. 118, datë 24.12.2020 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore administrimi i tyre në Bashkinë Cërrrik për vitin 2022”.

5.1.Rekomandimi: Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Tatimit Taksave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bëjë llogaritjen e detyrimeve që lindin për periudhën e ushtrimit të aktivitetit. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë të gjitha masat për pagesën e

rregullt të taksave dhe tarifave nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Cërrik.

Nga verifikimi rezultoi se: *Është hartuar regjistri elektronik i operatorëve ekonomikë që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Cërrik me gjeneralitetet e tyre, objektin e kontratës në të cilën është shpallur fituese, vlera, afati i kontratës dhe llojet dhe vlerën e tarifave që subjektet duhet të paguaj.*

Statusi: Zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Në kuadër të auditimit të të ardhurave të Bashkisë Cërrik u auditua realizimi i të ardhurave nga asetet e bashkisë të dhëna me qira. Në këtë aspekt u auditua vetëm zbatimi i kushteve të kontratave lidhur me pagesat në afat të detyrimeve të qirasë vjetore për sipërfaqen e marrë me qira dhe jo kushtet e hartimit të kontratave.

Bashkia Cërrik në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre gjatë periudhës 2019-2022 janë lidhur 71 kontrata për dhënie me qira të aseteve në Fond Pyjor që ka në pronësi. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 9-10 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, për aktivitet agropylltari etj.

Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave rezulton se nga 71 subjekte në vlerën 3,580,038 lekë, kanë paraqitur kërkesë për prishje të kontratës 3 subjekte dhe heqjen nga fondi pyjor 2 subjekte në vlerën 358,505 lekë duke ushtruar aktivitet 66 subjekte në vlerën 2,916,271 lekë të cilët kanë paguar detyrimin sipas kontratës.

Nga 3 subjektet që kanë paraqitur kërkesë për prishje të kontratës rezulton se 2 subjekte nuk kanë paguar detyrimet kontraktuale për vitin 2022 në vlerën 55,050 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Cërrik.

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej 55,050 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se: *Drejtoria e të ardhurave vendore e Bashkisë Cërrik, me shkresën nr. 100 prot., datë 22.11.2021, ka njoftuar subjektet për detyrimet e qirasë për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullisor publik dhe në datë 08.01.2024 është arkëtuar tarifa e pataksuar së bashku me kamatvonesat në vlerën totale prej 59,430 lekë.*

Statusi: Zbatuar.

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve dhe dokumentacionit lidhur me asetet e dhëna me qira, rezulton se Bashkia Cërrik (ish komunat) ka lidhur ndër vite kontrata për toka bujqësore të pa ndara dhe të abandonuara referuar kuadrit ligjor për tokat bujqësore si, ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, ligjin nr. 7850, datë 29.07. 1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826 deri 841 të tij, ligjin nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” dhe VKM nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt token bujqësore. Referuar bazës së të dhënave të paraqitur grupit të auditimit u konstatua se në total janë lidhur 597 kontrata nga Njësitë Administrative Mollas, Shalës dhe Klos (ish komunat). Lidhur me zbatimin e detyrimeve të kontratave për pagesën e qirase vjetore u konstatua se janë 170 qiramarrës që nuk kanë paguar detyrimet vjetore të qirasë ndër vite që arrijnë në vlerën 15,640, 768 lekë. Nga strukturat e bashkisë lidhur me këto kontrata janë bërë verifikime referuar dhe ankesave të qiramarrësve dhe rezulton se këto kontrata janë lidhur edhe për toka që i takojnë fondit pyjor dhe kullisor apo për të njëjtën sipërfaqe është lidhur më shumë se një kontratë. Në vijimësi i janë drejtuar bashkisë për prishje të kontratës 35 qiramarrës të cilët nuk kanë paguar detyrimet e qirasë. Bashkia nga ana e saj edhe pse ka marrë këto kërkesa si dhe ka konstatuar problematika lidhur me hartimin e një pjese të kontratave ende nuk ka gjetur një zgjidhje të kësaj problematike. Nga auditimi rezultone me probleme në pagesën e qirasë 170 kontrata të tjera të lidhura nga ish komunat në vlerë totale të detyrimit 15,640,768 lekë si

rezultat i kërkesave për ndërpreje nga ana e qiramarrëse apo konstatimeve të strukturave të bashkisë që sipërfaqe të dhëna me qira si tokë bujqësore i takojnë fondit pyjor dhe kullosor apo për të njëjtën sipërfaqe është lidhur më shumë se një kontratë.

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrrik të marre masa që të ngrejë një komision për të verifikuar ligjshmërinë dhe zbatimin e të gjitha kontratave që janë lidhur nga ish komunat (sot Njësitë Administrative) me qëllim zgjidhen përfundimtare të problemeve që janë konstatuar në vijimësi nga këto kontrata..

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me zbatimin e detyrimeve të kontratave për pagesën e qirasë vjetore për qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet vjetore të qirasë ndër vite ku vazhdojnë të mbledhen këto detyrime të prapambetura dhe disa prej tyre janë arketuar. Është hartuar regjistri elektronik për listën e pagesave për asetet e Bashkisë Cërrrik të dhëna me qira për fondin pyjor/kullosor, qira bujqësore dhe qira objekti për të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Cërrrik me të gjitha pagesat dhe detyrimet.

Statusi: Zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Sa më sipër rezulton se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Cërrrik nuk është njoftuar zyrës juridike për vazhdimin e procedurave për arkëtimin e gjobave të vendosura. Nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkia Cërrrik për periudhën objekt auditimi janë vendosur 12 gjoba në vlerën 4,800,000 lekë nga të cilat nuk është arkëtuar asnjë lekë si dhe për periudhën përpara vitit 2022 janë vendosur gjithsej 24 në vlera 8,880,000 lekë, të cilat janë shpallur titull ekzekutiv, por që nuk ka filluar procesi i kërimit të tyre duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 13,680,000 lekë.

Rezulton se për të gjitha praktikantët IMT-ja, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës, nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Cërrrik në vlerën prej 13,680,000 lekë, në kundërshtim me neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime; neni 15- (Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni) (Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1. 11.2007, neni 2) (Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr. 10324, datë 23.9.2010, neni 3); - nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundervajtjet administrative”.

8.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv duke llogaritur edhe kamatë vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar në vlerën 13,680,000 lekë sipas aneksit nr. 1 pika 6 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Nga verifikimi rezultoi se: Në planin e masave të marra nga Bashkia Cërrrik është masë e pa zbatuar.

Statusi: Pa zbatuar.

D. Masa Disiplinore

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Cërrrik 1 masë disiplinore.

Të detajuara si më poshtë:

1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbashtetje të shkronjës “c” neni 15 - Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën “g”, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për

vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojme Kryetarit të Bashkisë Cërrik, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit, si më poshtë:

1. Znj. D. L. me detyrë Specialiste në Drejorinë Juridike, Burimeve Njerëzore e Informimit me Publikun.

2. Znj. I. Ç. me detyrë Përgjegjëse Sektori në Drejorinë Juridike, Burimeve Njerëzore e Informimit me Publikun.

3. Z. A. D. me detyrë Specialist në Drejorinë e Planifikimit e Zhvillimit.

Për shkeljet e mëposhtme: Në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjere të OE ne procedurat e prokurimit dhe konkurrencen ndermjet OE, apo sherbejne edhe si pengese per konkurrencen e hapur, veprim ne mosperputhje me kuadrin rregullator ne fuqi ne prokurimin publik, konkretisht, me neni 46 "Kualifikimi ofertuesve" te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar; neni 15; 22 te ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, neni 26 “Kontrata per pune publike”, pika (5); neni 61 " Hartimi dhe publikimi i dokumenteve te tenderit", pika (2), paragrafi (2).

4. Z. H. K. me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Pronave Publike.

5. Znj. M. Xh. me detyrë Drejtor në Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore e Informimit me Publikun.

6. Znj. R. J. me detyrë Specialiste në Drejtorine Juridike, Burimeve Njerëzore e Informimit me Publikun.

Për shkeljet e mëposhtme: Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të ofertës e cila për devijime të vogla nuk plotësojnë kriteret në kërkesat kualifikuese, ndërsa duhej të ishin skualifikuar dhe KVO duhej ti kishte rekomanduar titullarit anulimin e procedurave të prokurimit, për arsye se asnjë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës nuk plotëson kriteret e vendosura në DT, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) “Anulimi një procedure prokurimi”, pika 1, gërma “ë”; neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1; neni 53 “Shqyrtimi ofertave”, pika 3 dhe 5, gërma a;c; neni 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 3; neni 67 “Klasifikimi ofertave”; neni 68 “Raporti përmbledhës”;Kreu VIII “Kushte të përgjithshme për zbatim”; neni 73 “Mungesa e konkurrencës”, pika 1 e VKM nr. 914, datë 29. 12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik”, i ndryshuar.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Cërrik me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë datë 11.10.2023 “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor në Bashkinë Cërrik” ka ngritur Komisionin Disiplinor i cili me Vendimin me nr. 2252/1 prot., datë 16.10.2023, ka shqyrtuar çështjen e ngritur e cila konsiston në shqyrtimin e gjetjeve nga auditimi i KLSH-së të konstatuar në raportin përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin financiar dhe përputhshmërinë.

Statusi: Zbatuar.

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	19	19	5	3	7	4
Masa për 3E	9	9	6	-	2	1
Masa Disiplinore	1	1	1	-	-	-
Masa për Shpërbllim Dëmi.	7	7	1	-	6	-

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se, nuk është bërë mjaftueshëm në lidhje me:

“Mjedisin e kontrollit”:

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësive publike, për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korigjuese.

- Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar; Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe nuk ka marrë vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut; Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

“Menaxhimin e Riskut”:

- Bashkia Cërrik nuk ka hartuar një strategji plotë risku, duke e unifikuar atë me regjistrin e riskut, pasi objektivat dhe planet e veprimit janë të mangëta. Mungojnë planet e veprimit për menaxhimin e riskut dhe nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.

- Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. - Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, ku të përcaktohen nivelet e tolerancës së riskut.

“Aktivitetet e Kontrollit”:

Titullari i Bashkisë Cërrik për vitin 2023 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, si dhe nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT në sektorë të ndryshëm dhe hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) për ruajtjen e tij në raste të jashtëzakonshme.

“Informimin dhe komunikimin”:

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj, pasi mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të MFK, si dhe mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të MFK.

“Monitorimi”:

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti, e cila lidhet me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efijencës e të efektivitetit.

- Auditimi i brendshëm si pjesë e monitorimit të zbatimit të sistemeve të MFK në të gjitha njësitë dhe strukturat, nuk ka kryer mjaftueshëm funksionin e saj.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, Kreu II, neni 8/a, neni 10,16, Kreu III, neni 20,21/2,24/1, me *“Manualin për MFK”* i miratuar me Urdhër të MF nr. 108, datë 17.11.2016, Kap. III, pikat 3.1,3.2,3.3, 3.5, Kap. IV, Kap. V, Anekset, me Udhëzimin e MF nr.16, datë 20.07.2016 *‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike’*, pika 3.2.1,4,5.2.7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Cërrik, të marrin masa për: (i) Hartimin e një plan veprimi për menaxhimin financiar, hartimin e një strategjie të plotë të riskut, dhe hartimin e procedurave për mashtrimin. (ii) Të sigurojë raporte periodike mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm shoqëruar me një plan menaxhimi për veprime korigjuese. (iii) Të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit për çdo proces pune, të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e GMS dhe EMP, si dhe të dokumentohet puna e tyre. (iv) Të përcaktohen rregullave të monitorimit

dhe plan veprimit për ecurinë e sistemit të MFK dhe në bazë të saj të sigurohet informim dhe raportime të menaxherëve për përmbushjen e objektivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2023 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 2 auditues, kur duhet të përbëhet nga jo më pak se 3 punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Konstatohet se njëri nga audituesit nuk është në përputhje me kuadrin ligjorë pasi nuk ka eksperiencë të auditimit dhe nuk ka kryer kurse trajtimi. Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të.

Nga auditimi i 6 dosjeve të auditimit nga NJAB, Cërrik rezultoi se:

- Në Planet Strategjike mungojnë objektivat, nuk është bërë përshkrimi i numrit të subjekteve që NJAB ka detyrimin për auditim si dhe identifikimin e fushave dhe sistemeve prioritet. Ndërsa në Planin vjetor mungonin rubrikat: zhvillimet aktuale të NJAB, prioritetet e auditimit për vitin, objektivat kryesore për vitin dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë. Realizimi i planit për vitin 2023 paraqitet në masën 71%, ku për mosrealizimin e auditimeve të planifikuara nuk është bërë rishikimi i planit dhe konfirmimi i tij nga titullari.

- Në raportimin e progresit të rekomandimeve NJAB nëpërmjet raporteve vjetore të dërguara zyrtarisht në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm është dhënë statusi i rekomandimeve, pa shpjeguar mënyrën se si u administrua dhe u përpunua informacioni, që mbështet përfundimin mbi nivelin e pranimit të rekomandimeve nga subjektet e audituara në masën 100% dhe nivelit të zbatimit të tyre në masën 54% në vitin 2023, të dhëna këto që në dosjet e shqyrtuara dhe raportet e auditimeve nuk dalin të qarta këto të dhëna.

- Në të gjitha dosjet e auditimit mungon projekt drafti i programit të auditimit në fazën përgatitore të hartimit të programit të angazhimit me Formatet e miratuara dhe testet përkatëse; Programet e angazhimit në të gjitha rubrikat nuk është hartuar sipas Formatit 8 të miratua. Nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të MFK:”, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme. Raportet nuk janë në përputhje me formatin e raportimit dhe nuk janë koncize dhe të sakta në përmbajtjen e tyre. Nuk dokumentohej procesi i ndarjes së detyrave, sipas drejtimeve të auditimit për secilin anëtar të grupit të punës. Në gjetjet dhe rekomandimet përkatëse nuk janë reflektuar lidhjet organike gjetje-konkluzion dhe rekomandime, pasi nuk janë të qarta dhe të sakta. Për rekomandimet e adresuara nuk është përcaktuar afati i zbatimit të tyre si dhe nuk është përcaktuar niveli i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët); Mungon plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve. Në dosje mungon “Memo” drejtuar Titullarit të Bashkisë mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet. Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera nuk janë realizuar në formë të thelluar sistemet objekt auditimi, mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve, në sistemin e pagesave, transaksioneve financiare dhe raportimit të pasqyrave financiare etj. Mungon Programi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të NJAB i miratuar nga titullari dhe procedura e vlerësimit të brendshëm të cilësisë për çdo program angazhimi nuk kryhej.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenet 11,12/d, 19 dhe 20, me MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020, Kapitulli II pika 2.4.1 dhe 2.4.2 “Auditimi financiar”; Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1/11,12; kapitulli VI pika 6.1; Kapitulli VII, pika 7.1.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Bashkinë Cërrik të marrin masa për plotësimin e strukturës së Sektorit të Auditimit me rekrutime cilësore dhe të kujdesen për certifikimin dhe trajnimin e tyre.

2.2. Rekomandimi: NJAB të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB dhe të ngrihet Komiteti i Auditimit. Të hartohen saktë dhe në mënyrë të plotë planet strategjike, raportimet e veprimtarisë, programet e angazhimeve, raportet e auditimit në të gjitha

rubrikat e tyre, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënien e opinionit për to, si dhe formulimin e saktë të, konkret e të plotë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Në fund të auditimit të hartohen memo informuese për titullarin me konkluzionet dhe sistemet e vlerësuara me risk. Të programohet dhe të realizohet auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lënë nga auditimet e KLSH dhe NJAB, si dhe të kryhen angazhime auditimi në fushat të vlerësuara me risk. NJAB të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit monitorimit dhe të vetëvlerësimit periodik.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Cërrrik ka diferenca me vlerën e planifikuar. Referuar treguesve të buxhetit për vitin 2023, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën 489,143 mijë lekë, ndërsa realizimi 459,607 mijë lekë, ose në masën 93.96%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 181,103 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 180,607 mijë lekë, ose në masën 99.72%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 97.54%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 146,531 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 127,207 mijë lekë, ose në masën 86,8%. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 33-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe të Ardhurave dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Cërrrik, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi realizimet faktike të viteve ushtrimore dhe në parashikime. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigojë edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave nuk ka kryer një planifikim i saktë i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore ku t’i referohet kërkesave reale të institucionit pasi:

- Nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

- Në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifatat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 33-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa që:

- Gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, të kryejë parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifatat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

- Për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifat vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto prej 9,542,342 lekë dhe me kosto historike në vlerën 43,082,009 lekë. Referuar analizës së gjendjes në vlerë bruto prej 43,082,009 lekë i përket 48 projekteve, të cilat janë:

- 11 projekte në vlerën bruto prej 7,627,769 lekë nuk janë zbatuar në mungesë të kryerjes së investimit.

- 24 projekte në vlerën bruto 31,241,880 lekë, ku sipas informacionit të Drejtorisë së Financës dhe Pronave investimet në zbatim të tyre janë në proces, për të cilat nuk ka një analizë të qartë të tyre nëse aktivet, të cilat u përkasin këtyre projekt-studimeve janë kapitalizuar apo jo për të vazhduar më tej me bashkimin e vlerës projektit me vlerën e aktiveve përkatëse që janë kapitalizuar.

- 12 projekte në vlerën bruto prej 4,212,360 lekë pretendohet se janë amortizuar, por në fakt amortizimi është përllogaritur për çdo vit në grup aktivesh dhe jo aktiv për çdo aktiv, duke sjelle mungesë të dhënash, nëse është amortizuar në vlerë të plotë apo pjesor dhe në çfarë vlere të mbetur është çdo aktiv pjesë e gjendjes së llog. 202 “*Studime dhe kërkime*” në vlerë neto 9,542,342 lekë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” Kreu II “*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” pika 16/b.d, Kreu III. Aneksi 1, pika 2, Klasa 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike për vlerat e projekteve gjendje të llog. 202 “*Studime dhe kërkime*”, të kryejë analizën e projekteve sipas investimeve nëpërmjet të shqyrtimit të dokumentacionit financiar dhe tekniko-ligjor të tyre, llogaritjen e saktë të amortizimit aktiv për aktiv dhe të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

6. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën neto 703,280,674 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike, në vlerën 1,841,815,935lekë. Bazuar në VKM nr.302, datë 11.05.2023 “*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura*” dhe marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjiellës Kanalizime Elbasan, Ujësjiellës Kanalizime sha Cërrik i është bashkëngjitur Ujësjiellës Kanalizime Elbasan. Këshilli i Bashkisë Cërrik me VKB nr.91, datë 27.12.2023 “*Për transferimin kapital të asetëve të Bashkisë Cërrik*” ka miratuar kalimin pa pagesë nga Bashkia Cërrik në Shoqërinë e Ujësjiellës kanalizimeve Elbasan objektet e mëposhtme:

1. Rrjetin e linjave KUZ të Bashkisë Cërrik, kosto historike me vlerë 171,301,008 lekë dhe me vlerë neto 54,176,546 lekë.

2. Rrjetin e ujësjiellësit të bashkisë Cërrik me kosto historike në vlerën 387,054,468 lekë dhe vlerë neto 122,411,886 lekë.

Referuar analizës të gjendjes së llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” rezulton se, nuk është zbritur vlere e investimeve të kryera në ujësjiellës, që duhej të transferoheshin tek “*Ujësjiellës Kanalizime Cërrik*” Sha, për 33 objekte në vlerën 974,489,659 lekë (*përfshirë investime në ujësjiellës e rrjetin shpërndarës, KUZ, depo dhe pompa uji*) në kundërshtim me VKM nr. 153, datë 03.04.1993 “*Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore, të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore*” i ndryshuar, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë

09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Bashkinë Cërrik dhe Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të kryejë procedurat ligjore për transferimin tek “Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” Sha të AAGJM që i përkasin gjendjes së llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” të ish-Ujësjetllës Kanalizime Sha Cërrik, dhe më pas të kryhen veprimet sistemuese kontabël.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

7. Gjetje nga auditimi: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) të klasës 21 për vitin 2023 është në vlerën 3,211,522,798 lekë, ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet e aktiveve gjatë vitit 2023 për shtesat dhe pakësimin për çdo lloj grup aktiv. Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 43,500,252 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 11,169,913 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,065,772,500 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,841,815,935 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 72,046,780 lekë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2023 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Mungon regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik” kapitulli III, pika 30, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitet e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 79,366,846 lekë, ku nga auditimi rezulton se, kjo gjendje paraqet pjesëmarrjen në investime kapitale të Bashkisë Cërrik nëpërmjet zotërimit të aksioneve në masën 8% në vlerën 280,000 lekë në Shoqërinë e përbashkët tregtare “Eco-Elb” Sha, në masën 100% në vlerën 79,086,846 lekë në Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime, Cërrik” Sha, por mungon pjesëmarrja në masën 40% në vlerën 100,000 lekë në Shoqërinë së përbashkët “Sport Klub Futbollit “T.” Sha, për të cilën duhet të ishin kryer veprimet e kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” në kredi të llogarisë 1011, “Shtesa të fondit bazë”.

- Me VKM nr. 302, datë 11.05.2023 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura” dhe marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të “Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” Sha, “Ujësjetllës Kanalizime Cërrik” Sha, i është bashkëngjitur “Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” Sha, si rezultat nuk janë kryer veprimet sistemuese në kontabilitet në lidhje me investimet kapitale.

- Nga Bashkia Cërrik nuk kanë filluar ende procedurat për kalimin në shitje të aksioneve në Shoqërinë “Sport Klubit të Futbollit “T.” Sha, edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore (nenit 22 të ligjit 79/2017, datë 29.07.2020 “Për sportin” të ndryshuar me 105/2020, datë 29.07.2020). Në të dhënat e regjistrimit tregtar të Shoqërisë “Sport Klub Futbollit “T.” Sha, rezulton se Bashkia Cërrik është zotëruese e 40% të aksioneve të saj. Këto veprime janë

në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 31. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Nga strukturat drejtuese të Bashkisë Cërrik të kryhen procedurat e shitjes së aksioneve të Bashkisë Cërrik në Shoqërinë “Sport Klubit të Futbollit “T.” Sha.

Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të kryej veprimet sistemuese kontabël për investimet kapitale në ish-Shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Cërrik” Sha dhe në Shoqërinë “Sport Klubit të Futbollit “T.” Sha në llogaritë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” e llog. 1011, “Shtesa të fondit bazë”.

Deri me datë 31.12.2024

9. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2023 me urdhër-shpenzime në **32** raste faturash me vlerë 68,473,784 lekë, mbi afatin ligjor 30 ditor të pagesave nga data e faturave për shpenzime mallra e shërbime/ investime të mbërritura në Bashkinë Cërrik.

Pjesa e kësaj gjetje (9) duhet të riformulohet në funksion të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Udhëzimin e MFE nr. 35, datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” si më poshtë:

- Gjithashtu nga auditimi rezultoi se totali i detyrimeve të pa likuiduara në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë në vlerën 135,064 mijë lekë (29.4%) kurse shpenzimet vjetore faktike të vitit 2023 janë në vlerën 459,607 mijë lekë. Detyrimet financiare të konstatuara dhe të pa paguara të Bashkisë Cërrik janë 29.4% të shpenzimeve vjetore faktike në muajin pasues dhe tejkalojnë 20% të shpenzimeve. Në këto kushte bashkia konsiderohet në “vështirësi financiare”, pasi vonesat në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta konstatohen edhe në muajin pasues dhe tejkalojnë nivelin prej 20% dhe vlera e stokut është rritur progresivisht mbi nivelin prej 25% të shpenzimeve vjetore faktike.

Sa më lart në kundërshtim me ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 55, 56 dhe Udhëzimin e MFE nr. 35, datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 33, (Tabela 1) Rastet sipas gjendjes financiare të njësitë të vetëqeverisjes vendore dhe pikat 86-123.

Për sa më sipër rezultoi se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: - Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike Bashkia Cërrik, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijohet kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.

9.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të hartojë një plan specifik zbatimi për daljen nga gjendja e vështirësisë financiare duke ja paraqitur Këshillit Bashkiak. Të marrë masat për rritjen e të ardhurave, shkurtimin e shpenzimeve dhe mundësitë potenciale të aseteve në dispozicion duke u ndjekur periodikisht nga personat përgjegjës me qëllim që këshilli bashkiak të jetë në gjendje të kontrollojë dhe monitorojë instrumentet e propozuara për menaxhimin e situatës së vështirësive financiare të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të Sektori i Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Publike rezulton se, janë 4475 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Cërrrik (Qendër), listat përfundimtare të të cilave janë të miratuara me VKM-ët përkatëse, ndërsa për 2469 prona të 4 Njësive Administrative si *Mollas, Gostimë, Shalës* janë në fazën e miratimit të listave paraprake dhe *Klos* në fazën fillestare. Nga këto prona janë hipotekuar 7 prona dhe janë në proces hipotekimi 38 prona të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë përditësimi i të dhënave të inventarit të këtyre pronave.

Në mungesë të inventarizimit, përditësimit dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

Mos kryerja e procedurave për mos përditësimin e listave paraprake dhe fillestare të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM për 4 NJA *Mollas, Gostimë, Shalës dhe Klos*, më pas paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e të dhënave të listë-inventarëve të pronave, mos regjistrimi në ASHK në favor të Bashkisë i pjesës më të madhe të këtyre pronave të listuar, si dhe mos vlerësimi i tyre janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18,22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” dhe VKM-së nr. 669, datë 07.08.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 58-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Bashkia Cërrrik nëpërmjet strukturave përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave për njësitë administrative; *Mollas, Gostimë, Shalës* dhe *Klos*, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim të pa hipotekuar të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit për blerjet e vogla për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023 u konstatuan mangësi që lidhen me zhvillimin e tyre, si vijon”.

1. Në të gjitha rastet e testuar, konstatohet mungesa e kërkesës nga sektori përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi;

2. Në të gjitha rastet e testuar, për mallra dhe shërbime, në hartimin e fondit limit nuk janë përcaktuar treguesit e çmimeve gjatë testimit të tregut;

3. Në të gjitha rastet e testuar, rezulton se është vendosur fondi limit në urdhrin e prokurimit;

4. Në 8 raste në ftesën për ofertë është vendosur si kriter kërkesa që OE të disponojnë licencë për objektin e prokurimit. Lidhur me këtë kërkesë, rezulton e pa plotë, duke mos përcaktuar se çfarë dokumenti duhet të kërkohet për të përcaktuar llojin e licencës së kërkuar.

- Në 6 raste, ka rezultuar se dokumentacioni i paraqitur nga OE ka mungesë të dokumenteve sipas ftesës për ofertë.

Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim Neni 41, pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 7

dhe 8, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 80-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Bashkia Cërrik, Drejtoria Financiare dhe Sektori i Prokurimeve, në zhvillimin e procedurave me blerje të vogla, të marrë masat e mëposhtme:

-Të dokumentohen nevojat dhe kërkesat e institucionit që lidhen me nevojat për mallra dhe shërbime;

-Të dokumentohet përlllogaritja e fondit limit duke vendosur edhe treguesit e çmimeve;

-Të shmangen kriteret e pa plota, duke përcaktuar qartë dokumentin që kërkohet në ftesën për ofertë;

-Në rastet kur Operatorët Ekonomikë, nuk përmbushin kërkesat sipas Ftesës për Ofertë, të bëhet s’kualifikimi i tyre për mos përmbushje të kriterëve;

- Drejtoria e Financës në Bashkinë Cërrik, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave brenda afatit ligjor 30 ditor.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në 8 raste personat përgjegjës që administrojnë procesin në e-leje, i kanë miratuar ato në mos përmbushje të dokumentacionit të rregullt sektorial për ndërtimin.

- Në 6 raste mungon mendimi nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit që lidhet me miratimin e VNM-ve.

- Në 2 raste preventivat janë të pa plotë duke mos përfshirë zërat e prishjes së objekteve ekzistues.

- Në 1 rast leja e ndërtimit nuk është shoqëruar me lejen e zhvillimit.

- Në 1 rast mungojnë projektet e ngrohje – ftohjes.

- Në 1 rast kemi shkelje të intensitetit duke e tejkaluar atë. Në 1 rast konstatohet polica e sigurimit për projektuesit jashtë afatit të vlefshmërisë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, neni 10, pika 1, germa “ç”, neni 15, pika 1/1, germa “iii”, pika 1 germat “g”, “dh”, h”, neni 38 pika 2, Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” Shtojca II: pika 10 “Prodhime infrastrukturore” (a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 139-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit, të marrë masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin sektorial për projektet ndërtimore, në të kundërt të mos miratohet asnjë leje ndërtimi nuk plotëson të gjitha kondicionet urbane. Të mos vijohet miratimi për leje ndërtimi për objektet për të cilat është e nevojshme miratimi me VNM-ve, pa bashkëvepruar me Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për veprimtarinë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, rezultoi se stafi i rekrutuar përfshirë Kryeinspektorin dhe 1 inspektor nuk kanë arsimin e duhur, duke mos dhënë garanci për një kontroll cilësor dhe efektiv të territorit. Është aplikuar vendosja e masës së gjobës për objektet pa leje, por rezulton se ajo nuk është me përlllogaritje sipas vlerës së punimeve pa leje. Rezulton se në asnjë rast nuk është nxjerrë vendimi i pezullimit për ndërtimet pa leje. Rezulton se janë nxjerrë 4 vendime për prishjen e ndërtimeve pa leje, por nuk është kryer ekzekutimi i këtyre vendimeve. Në një rast për ndërtim çatie nuk është marrë masa për vendimin e prishjes së ndërtimit. Në asnjë rast për vitin 2023, nuk janë mbajtur aktet e kontrollit për objektet të cilat janë me leje ndërtimit, kjo edhe për shkak se stafi i IMTV nuk ka punonjës me profilin përkatës që lidhet me inxhinierinë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” neni 4, neni 5 germa (a, d, ç), Ligji Nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin

e territorit”, neni 51, neni 52 pika 1 germa “e”, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 139-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrrik, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në IMT, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit. Të synohet që stafi i kualifikuar të jetë me drejtim inxhinierie.

13.2 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Bashkia cërrrik të marrë masa si:

- Mbatjen e akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.
- Aplikimin e masës së gjobës për ndërtimet pa leje sipas vlerës së punimeve.
- Nxjerrjen e vendimeve të pezullimit për çdo rast kur konstatohen punimet pa leje.
- Ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje, dhe në rast se nuk disponon kapacitetet e nevojshme, të kërkojë bashkëpunimin e IKMT.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të Rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Cërrrik, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 208/10 prot., datë 18.07.2023, (prot Bashkia Cërrrik me shkresën nr. 1427/6, datë 19.07.2023), nga bashkia janë marrë një sërë masash dhe përgatitur programe me afate dhe persona për zbatimin e rekomandimeve, konkretisht:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.01.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga ana e Bashkisë Cërrrik është hartuar Plan Veprimi mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Raportit të Auditimit të KLSH-së me shkresën nr. 1409/1 prot., datë 16.06.2023 KLSH-së, **brenda 20 ditëve.**

Bazuar në nenin 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **NUK** është dërguar Zbatimi i Plan Veprimit dhe Raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, **brenda afatit 6 mujor** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH.

Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, realizimi është si më poshtë:

- Nga **14 masa organizative**, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa, janë në proces zbatimi 6 masa, **janë pjesërisht zbatuar 3 masa dhe nuk janë zbatuar 3 masa.**
- Nga **7 masa për dëme ekonomike** me vlerë 1,460 mijë lekë, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë në proces zbatimi 6 masa me vlerë 1,091 mijë lekë (proces gjyqësor) dhe nuk është zbatuar një masë me vlerë **369 mijë lekë.**
- Nga **9 masa për eliminim e efekteve** negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efencë dhe efektivitet të tyre, pranuar 100% nga subjekti, nga të pranuarat janë zbatuar 5 masa, janë në proces 2 masa dhe **nuk është zbatuar një masë.**
- **Për masat disiplinore.** Në plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, për punonjësit e Shërbimit Civil dhënie e masave disiplinore “Vërejtje” për 6 (gjashtë) punonjës, e zbatuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 139-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.2. Rekomandim: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa Organizative

1.1. Rekomandimi: Bashkia Cërrrik me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK të marrë masat si vijon:

- Të hartojë planin e trajnimeve;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të GMS për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Të miratojë “Planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”;
- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit e Riskut”.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtorja e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me

qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik në bashkëpunim me Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për plotësimin e stafit të DAV Bashkia Cërrik me specialist të fushës dhe përshtatja e strukturës sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Cërrik, të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimore, sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj si dhe të krijojë bazën të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat të cilat mbliken nga agjentët tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

6.2. Rekomandimi: Bashkia Cërrik, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e OE “Ujësjellës Kanalizime Cërrik” Sha, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjisllacionit në fuqi, me synim për mirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

12.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi ndaj personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndaj shkelësve.

13.2. Rekomandimi: Bashkia Cërrik me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Të hartojë planin e trajnimeve;
- Të organizojë trajnime në grupin e Menaxhimit Strategjik në fushën e menaxhimit të riskut dhe atë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit
- Të aplikojë programe elektronike të licensuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar;
- Të dokumentojë zhvillimin e mbledhjeve të grupit të Punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Të miratojë planin vjetor të punës për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”
- Të miratojë “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”;
- Të raportojë periodikisht lidhur me kryerjen e procesit të monitorimit.

B. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.

8.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masa dhe të kërkojë në Gjykatë të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv duke llogaritur edhe kamatë vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar në vlerën 13,680,000 lekë.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Çapallarëve dhe Veshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, fshati Licaj”, Njësia Administrative Shalës”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës 58,862,977.80 lekë me TVSh, realizuar nga OE “Z.” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 139,125 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3519 prot., datë 20.12. 2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “Z.” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 132-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 139,125 lekë pa TVSh nga OE “Z.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3519 prot., datë 20.12.2022, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Çapallarëve dhe Veshtit, fshati Shalës dhe i rrugës Lazarec, fshati Licaj”, Njësia Administrative Shalës”, Bashkia Cërrik, vlerë që

përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.9.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës 39,032,808 lekë me TVSh, realizuar nga OE “V. H.” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **157,906 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 354 prot., datë 03.02. 2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “V. H.” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 132-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtorja e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **157,906 lekë pa TVSh** nga OE “V. H.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 354 prot., datë 03.02. 2023, me objekt: “Rikonstruksion i rrugës fshati Dasar”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.9.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej”, Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës 57,999,999.60 lekë me TVSh, realizuar nga BOE “M.” & “Sh.” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **161,280 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 203 prot., datë 19.01.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “V. H.” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 132-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtorja e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **161,280 lekë pa TVSh** nga BOE “M.” & “Sh.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 203 prot., date 19.01.2023, me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Cërrik dhe Malasej”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.9.2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Njësinë Administrative Gostimë”, Bashkia Cërrik me vlerë të kontratës 40,401,971.90 lekë me TVSh, realizuar nga OE “A.” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **128,842 pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 354 prot., datë 03.02. 2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “A.” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 132-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtorja e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **128,842 lekë pa TVSh** nga OE “A.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 13 prot., date 06.01. 2023, me objekt: “Rikonstruksion rrugësh në Njësinë Administrative Gostimë”, Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.9.2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “Rikonstruktion i rrugës së Delijve dhe Xhamisë së fshatit Selvijas” Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës 39,032,808 lekë me TVSh, realizuar nga OE “B.” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **114,432 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 341 prot., datë 26.09. 2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik dhe OE “B.” ShPK, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 132-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Pronave Publike të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **114,432 lekë pa TVSh** nga OE “B.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 341 prot., date 26.09. 2022, me objekt: “Rikonstruktion i rrugës së Delijve dhe Xhamisë së fshatit Selvijas” Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.9.2024

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga Bashkia Cërrik nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve tatimore të pa paguara për vlerën **178,598,620 lekë**, nga e cila:

- **vlera 72,954,642 lekë**, e pa kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2023, dhe konsiderohet si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë dhe përbëhet nga: - *vlera 2,000,000 lekë, detyrimi për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve dhe - vlera 70,954,642 lekë, detyrimeve për taksës së tokës bujqësore.*

- **vlera prej 105,643,978 lekë**, e kontabilizuar në pasqyrat financiare të vitit 2023, dhe njihet nga bashkia si detyrim për arkëtim, nga e cila: - *vlera e detyrimeve tatimore nga abonentët familjar në vlerën 53,752,516 lekë, kjo për 21576 abonentë, nga e cila kontabilizuar vlera 37,524,105 lekë; - vlera e detyrimeve tatimore nga subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe institucionet shtetërore në vlerën 16,921,095 lekë; - vlera për TNI nga ndërtimet informale pre 19,650,367 lekë, kjo për 722 perona; - vlera nga mos arkëtimi i gjobave nga IKMT prej 15,320,000 lekë.*

Referuar të dhënave nga DTTV Bashkia cërrik për vlerën totale të borxhit tatimore e cila paraqitet në shumën **175,549,380 lekë**, debitorët e taksës së tokës bujqësore zë 44.2% të totalit;

Këto veprime janë në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 33-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat për bizneset, institucione dhe familjare prej **178,598,620 lekë**, si dhe kontabilizimin e vlerës së pa kontabilizuar prej **72,954,642 lekë** në pasqyrat financiare viti 2024 në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Brenda datës 31.12.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejes së ndërtimit të zhvilluesit B. S. dhe Rr. S., Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë është llogaritur gabim.

Vlera e TNI-së së llogaritur sipas legjislacionit, duhet të jetë 293,029 lekë dhe jo 210,516 lekë, sa është llogaritur nga punonjësit e Bashkisë Cërrik sipas autorizimit për pagesë lëshuar për subjektin zhvillues. Në përlllogaritje e kryer rezulton se është marrë për bazë një preventiv i pa plotë në vlerën 10,525,813, ndërkohë që preventivi i plotë për gjithë objektin është më i lartë dhe konkretisht

14,651,461 lekë, mbi të cilin duhej kryer edhe përlllogaritja e TNI.

Sa më sipër, konstatohet një diferencë prej **82,513 lekë**, e pa llogaritur në mënyrë të saktë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Çërrik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 139-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave, të marrin masa për njoftim detyrimin ndaj subjektit zhvillues B. S. dhe Rr. S., për të bërë të mundur arkëtimin e shumës **82,513 lekë** si rezultat i përlllogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlerë e cila përbën të ardhur të pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Çërrik.

Brenda datës 30.9.2024

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i **8** procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Çërrik për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, me fond limit 271,875 mijë lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e kriterëve jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- Në 8 procedura nga 8 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 271,875 mijë lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kriteret të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

- Në 7 procedura nga 8 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 232,433 mijë lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Çërrik, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT. Kualifikimi i 7 OE pa plotësuar kriteret e vendosura në DST përbën përdorim të fondeve publike pa eficientë në vlerën 232,433 mijë lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", neni 39, "Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike"; neni 34 "Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit", neni 40, "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave", neni 41, "Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve", neni 76, "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 77 "Kërkesat për kualifikim", neni 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", pika 3; neni 98, "Anulimi i një procedure prokurimi", pika 1, germa a) dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), neni 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", pikat 1 dhe 6; neni 36 "Specifikimet teknike", neni 39, "Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike", pika 5; neni 45 "Kriteret për shpalljen e ofertës fituese", pika 1; neni 67, "Klasifikimi i ofertave" neni 78, pika 4, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"; neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", paragrafi i fundit; neni 85 "Lidhja e kontratës", pika 2, etj

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Çërrik) të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Cërrik, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a -“Vërejtje” neni 58 shkronja (a), për 3 punonjës, si më poshtë:

1. **Z. Ç. Sh.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyje-Kullotave dhe Kullimit e Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. **Zj. M. Ll.** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Publike. Për mangësitë e konstatuara në kundërshtim me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” për:

- Mos kryerje të procedurave për transferimin përfundimtar të pronave për Njësitë Administrative: Mollas, Gostimë, Shalës dhe Klos, duke mos kryer përditësimin e listave paraprake të inventarëve pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe mos hipotekimi i pasurive të paluajtshme të transferuara.

3. **Z. K. B.**, me pozicion Përgjegjës Sektori, për problemet e konstatuara në lidhje me mbledhjen e të ardhurave të bashkisë, për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

G.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masa Disiplinore” dhe kontratës individuale, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Cërrik, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse “Vërejtje” për 2 punonjës, si më poshtë:

1. **Z. F. U.**, Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për mangësitë e konstatuara në miratimin e lejeve në kundërshtim me legjislacionin sektorial, dhe përlllogaritja e gabuar e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë; (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 2.5 faqe 139-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2. **Z. F. Q.**, Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, për mangësitë e konstatuara në kontrollin e territorit, zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe mos ndjekja e procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e gjobave; (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 2.5 faqe 139-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

D.3. Për të gjithë punonjësit e tjerë të trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditimit, **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Cërrrik**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Bulqizë, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

- 1. G. K.**
- 2. I. SH.**
- 3. K. F.**
- 4. Sh. H.**

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

K. GJ.

